

PËRGJEGJËSIA CIVILE NGA SHKAKTIMI I DËMIT JO PASUROR

**ALEKSANDËR MUSKAJ
KANDIDAT PËR GRADËN SHKENCORE “DOKTOR I SHKENCAVE”**

Objektivi i kësaj përpjekje studimore është ndikimi në doktrinën e institutit të përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit jo pasuror, duke u konsideruar si ndihmesë e përkushtuar, për konkretizimin e karakteristikave të dëmit jo pasuror, por edhe në identifikimin e elementëve të tjerë, të cilët përbëjnë përgjegjësinë civile nga shkaktimi i dëmit jo pasuror. Elementë të tillë si subjektet, ana objektive, ana subjektive, lidhja shkakësore, të domosdoshëm për verifikimin e dëmit jo pasuror, ndikojnë në mënyrë thelbësore në arritjen e përcaktimit të dëmit.

Karakteristikat e dëmit jo pasuror, rrjedhojë e kundërligjshmërisë së sjelljes në shoqëri, ndaj të tretëve, janë trajtuar jo vetëm nën vështrimin e përgjithshëm mbi formën dhe përmbajtjen e dëmit jo pasuror, por me vëmendjen e duhur mbi kushtet e përgjithshme në lidhje me praninë e elementëve përbërës të përgjegjësisë së rrjedhur nga shkaktimi i dëmit jo pasuror.

Në legjislacionin e deritanishëm hapësirat për të ndërhyrë janë të shumta, në veçanti në lidhje me procedurat e gjyqimit, materializmin e parimeve në një proces ligjor edhe në elementë të tillë si barra e provës, përmbushja e detyrimit etj.

Në punim vlerësohet si domosdoshmëri një përqaasje, edhe në rrugë institucionale, e praktikave dhe legjislacionit vendas, me mentalitetin dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. Jurisprudenca e GJEDNJ-së nuk duhet të përbëjë shkak vetëm për rishikimin e vendimit gjyqësor civil. Ajo duhet të zërë vend në mentalitetin tonë gjyqësor dhe në infrastrukturën ligjore, si burim ligji.

The objective of this research effort is the impact on the doctrine of the institution of the non-pecuniary damage, being considered as dedicated contribution to the concretization of the characteristics of non-pecuniary damage, but also to identify other elements, which constitute the civil responsibilities of non-pecuniary damage. Elements such as entities, the objective, subjective, causal connection, necessary for the verification of non-pecuniary damage, affect essential in reaching the determination of injury.

Characteristics of non-pecuniary damage, due to the lawlessness of social behavior, to third parties, are treated not only under general views about the form and content of non-pecuniary damage, but with proper attention on the general conditions relating to the presence of elements liability component derived from the infliction of non-pecuniary damage.

The premises to intervene in the current legislation are numerous, especially in connection with court proceedings, materialization of the principles in a legal process, in elements such as the burden of proof, fulfillment of the obligation etc..

In this study-work considered a necessity approach, institutional ways, practices and legislation, with the mentality and the jurisprudence of the ECHR. Jurisprudence of the ECHR should not be due solely to civilian judicial review of the decision. It should take place in our judicial mentality and legal infrastructure, as a source of law.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I TË DREJTËS CIVILE**

TIRANË 2013

PËRGJEGJËSIA CIVILE

NGA SHKAKTIMI I DËMIT JO PASUROR

ALEKSANDËR MUSKAJ

KANDIDAT PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE

“DOKTOR I SHKENCAVE”

**UDHËHEQËS SHKENCOR
PROF. DR. ARDIAN NUNI**

PËRMBAJTJA E TEMËS

	<i>Faqe</i>
Hyrje.....	5
1. Objektivi i Temës.....	7
2. Fragmente të zhvillimit historik të shpërblimit të dëmit.	9
Kodi Civil i vitit 1929	
Ligji Nr.2359, datë 15.11.1956 “Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet”.	
3. Rrethana dhe kushte të shkakimit të dëmit. Baza ligjore	15
4. Kuptimi i përgjithshëm i dëmit jo pasuror.	19
5. Forma e shfaqjes së dëmit jo pasuror. Karakteristika të anës materiale.....	22
6. Dallimi i përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit jo pasuror dhe Verifikimi i dëmit. ..	25
7. Shkaktimi dëmit.....	28
8. Faji.	36
Faji si baza e përgjegjësisë civile.....	36
Kuptimi dhe llojet e fajit në fushën e të drejtës civile.	37
Përgjegjësia pa faj.....	38
9. Lidhja shkakësore.....	41
10. Teoritë kryesore mbi karakteristikat e lidhjes shkakësore.....	43
11. Shpërblimi i dëmit i krahasuar me doktrinën perëndimore (France, Itali)	50
Dëmi moral në formën e cenimit të nderit	51
12. Lloje të dëmit kundër shëndetit, nën dritën e praktikës gjyqësore.....	63
13. Dëmtimi i shëndetit.....	69
Pretium doloris	70
Dëmi ndaj kënaqësive të ofruara nga jeta	70

Dëmi estetik	70
Dëmi në sferën afektive (pretium affectionis) -	70
Fyerja e kujtimit të një të vdekuri	73
Fjala e mbajtur në parlament.....	74
14. Lloje të tjera të dëmit jopasuror.....	86
Demi i shkakuar nga ndërhyrja në jetën private.	86
Përgjegjësia për dëmin e shkakuar nga persona të tjerë.	90
15. Përgjegjësia për dëmin e shkakuar, në raste të veçanta.	98
Veprimtari e rrezikshme.	98
Mjedisi.	99
Përgjegjësia për publikimet mashtruese.....	100
Ngritja e një padie të padrejtë.	101
Dëmi jo pasuror i shkakuar në fushata zgjedhore.....	105
16. Dëmi jopasuror dhe praktika e Gjykatës së Lartë	110
17. Shpërblimi i dëmit.....	113
18. Mënyra e shpërblimit të dëmit në varësi të llojit të tij.	116
Shpërblimi i dëmit jo pasuror.	116
Shpërblimi i dëmit me rastin e shkakimit të vdekjes.....	118
19. Padia për shpërblimin e dëmit.....	123
Parashkrimi	123
Konkluzione dhe rekomandime.....	127

Hyrje

Sa herë diskutohet mbi përgjegjësinë civile, me të drejtë, juristët i referohen aty për aty, fillimisht përgjegjësisë që rrjedh nga shkaktimi i dëmit, duke përfshirë në të të gjithë burimet e kësaj përgjegjësie, marrëdhënie juridike kontraktore apo jo kontraktore. Diskutimi shtrihet mandej në elementet e përgjegjësisë dhe dallimin e saj nga institute të tjerë të ngjashëm me të.

Edhe ndërmarrja ime do të shtrihet pikërisht në këtë fushë. Për shkak të gjerësisë së saj dhe tërheqjeve personale ndaj shkaktimit të dëmit jo pasuror, tema do të disiplinohet, në veçanti, në pikëpamjet, doktrinat dhe praktikatat në lidhje **me dëmin jo pasuror**.

“Dëmi jo pasuror”, në termat e një punimi shkencor, përfshin kërkime që i përkasin një fushë shumë delikate, të pashkelur pothuajse tërësisht dhe, për këtë shkak po aq interesante, të së drejtës civile. Tërheqja ndaj këtij objekti është rrjedhojë e mishërimit në të, thuajse të të gjithë parimeve të së drejtës civile. Është rrjedhojë e vështirësive për të njohur, kuptuar dhe zbatuar elementet e posaçëm të kësaj pjesë të së drejtës.

Pretendimet e mia në formimin teorik, gjejnë në këtë fushë, lëndë për të eksploruar, për të kundërshtuar, për të krijuar, së fundi, për të shfaqur opinione vlerësuese.

Përgjegjësia civile nga shkaktimi i dëmit, u materializua fillimisht me norma juridike në të drejtën romake. Kërkimi i dëmit u përfaqësuar nga “*padia aquiliane*”. Ecuria e tij nuk gjeti forma të qëndrueshme, përveç se në erën e Napolonit, pikërisht në Kodin Civil kur, jo vetëm në këtë fushë, arrihet përshtatja me zhvillimet e shoqërisë, e të drejtës civile në përgjithësi dhe e përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit në veçanti.

Kodi Napolonit shërbeu si themel i të drejtës civile për legjislacionin, jurisprudencën dhe doktrinën. Përgjatë viteve, përpjekjet e juristeve dhe të ligjvënësve kanë ndryshuar vetëm shfaqjen e instituteve, duke lënë pothuajse të pacenuara parimet.

Objekt i përpjekjeve të mëvonshme nuk janë ndryshimi i parimeve të gjithë pranuar, por përshtatja e tyre me karakteristikat e veçanta të zhvillimit shoqëror, të së drejtës civile në veçanti, me vend kryesor në këtë zhvillim.

Ndryshimi i sistemit politik solli frymë dhe botëkuptim të ri në legjislacionin e vendeve të Evropës lindore, për rrjedhojë dhe në Shqipëri. Instituti i shkaktimit të dëmit, me përkufizime të politizuara dhe të përcipta filloi të ndryshojë, duke u përshtatur me të drejtën dhe trashëgiminë doktrinare të vendeve evropiane kontinentale ose, në një vlerësim më kombëtar, u rikthye në përkufizimet e të drejtës civile të rregulluara në Kodin Civil të vitit 1929.

1. Objektivi i Temës

Cilido që do të përfshihej në një trajtim shkencor të përgjegjësisë civile nga shkaktimi i dëmit, do të ishte i detyruar të trajtonte në mënyrë të përgjithshme, paraprakisht, kuptimin e detyrimeve në përgjithësi, dallimin midis përgjegjësisë civile dhe asaj penale apo dallimin midis përgjegjësisë civile kontraktore dhe përgjegjësisë civile jashtë-kontraktore, etj.

Detyrimi, duke qenë drejtë personale gjithmonë ka në themelet e tij, marrëdhënien që krijohet midis debitorit dhe kreditorit.

Natyra e saj, përcakton dhe emërtimet e ndryshme, pasive apo aktive. Kodi Civil njih si burime të detyrimit kontratat dhe ligjin. Në vijimësinë e trajtimit tonë, do ti përkushtohemi, në përgjithësi detyrimit jashtë-kontraktor dhe, në veçanti, detyrimit që buron nga shkaktimi i dëmit.

Sikurse është treguar në titull, objekt i studimit do të jetë vetëm përgjegjësia civile që buron nga shkaktimi i dëmit jopasuror.

Kur shkaktohet një dëm, përgjegjësia vlerësohet nga këndvështrime të ndryshme. Së pari, nga ana e brendshme, kur subjekti në ndërgjegje e vuan veprimin e dëmshëm dhe kjo ka të bëjë me përgjegjësinë morale; së dyti, kur sjellja i është nënshtruar gjykimit, me pasoja përgjegjësinë penale apo përgjegjësia civile. Kjo e fundit dallohet sipas burimit nga i cili ka lindur.

Përgjegjësia civile realizohet si përgjegjësi “kontraktore”, kur dëmi i shkaktuar rezulton nga mospërbushja e detyrimeve kontraktore. Debitori duhet të shpërblejë dëmin që rezulton nga mungesa e përmbushjes së detyrimeve objekt i kontratës. Duke mos nënvleftësuar përdorimin e

shembujve, do të mjaftohem vetëm, duke kujtuar pasojat që vijnë nga mos furnizimi në një kontratë për furnizimin me produkte ushqimorë, apo vonesat në këtë furnizim.

Ndërsa përgjegjësia civile jashtë kontraktore (gjithmonë nga shkaktimi i dëmit) ekziston kur dëmi i është shkaktuar një subjekti me të cilin nuk ekzistojnë marrëdhënie kontraktore ose, jo për shkak të mospërbushjes së detyrimeve kontraktore.

Në rrethanat e përditshme, i njëjti fakt mund të jetë burim i përgjegjësisë së dyfishtë, penale dhe civile njëkohësisht dhe, për këtë arsye jo rrallë, detyrohemi të dallojmë dhe ndajmë përgjegjësinë penale nga përgjegjësia civile. Dallimi midis tyre është, ndoshta, detyra më e lehtë, pasi karakteristikat e të dy përgjegjësive pavarësisht së janë thujtë të njëjta, realizojnë dhe mbrojnë norma dhe marrëdhënie të ndryshme juridike.

Qëllimet, objektivat nuk janë të njëjta për të dy llojet e përgjegjësisë. Përgjegjësia penale ka si objekt mbrojtjen e shoqërisë nga veprimet e kundërligjshme që cenojnë rendin publik. Përgjegjësia civile ka si objekt të vetëm, të paktën në parim, shpërblimin e dëmeve të shkaktuara nga një person i caktuar, fizik ose juridik një personi tjetër.

E drejta penale përcakton si element të domosdoshëm dhe të përhershëm të përgjegjësisë penale, fajin e autorit të veprës penale, ndërsa në rastet e përgjegjësisë civile, përfshihet edhe përgjegjësia pa faj.

Në të drejtën penale përgjegjësia është gjithmonë personale. Personi që ka kryer një vepër penale do të përgjigjet personalisht për të dhe, po personalisht do ta vuajë dhe dënimin përkatës.

Ndërsa, në të drejtën civile, përveç rregullit të përgjithshëm sipas të cilit çdokush që shkakton një dëm përgjigjet për të, ekzistojnë edhe raste kur një person mund të ngarkohet me detyrimin për shpërblimin e një dëmi që nuk e ka shkaktuar personalisht. Pra përgjegjësia civile mund të lindë edhe për dëmin e shkaktuar nga të tjerët.

2. Fragmente të zhvillimit historik të shpërblimit të dëmit.

Vështrimin historik të institutit të shkakimit të dëmit do ta kufizojmë, duke e trajtuar në mënyrë të përgjithshme, nga krijimi i shtetit të ri shqiptar në vitin 1912, deri në vitin 1994, vit në të cilin hyri në fuqi Kodi Civil aktual.

Në prag të vitit 1912 rregullimet ligjore, midis të cilave e drejta e detyrimeve në përgjithësi dhe përgjegjësia nga shkaktimi i dëmit në veçanti, ishin të organizuara në Kodin Civil Otoman (Mexheleja). Gjendja e legjislacionit ishte në kontradikte të dallueshme me zhvillimet shoqërore, siç ishte, në vitin 1929 prodhoi Kodin Civil të shtetit shqiptar. Hartimi i tij u bë nën frymën moderne të së drejtës civile franceze dhe italiane.

Kodi Civil i vitit 1929 i rregullon detyrimet në titullin e dytë të librit të katërt të tij.

Në të parashikohen si burime të detyrimeve: kontrata, premtimi i njëanshëm, gjerimi i punëve, pagimi i pa detyruar, begatimi pa shkak si dhe veprimet e paligjshme.

Në nenin 1149/1 të Kodit Civil, jepet kuptimi i përgjegjësisë që rrjedh nga veprimet e paligjshme, duke iu referuar elementëve të domosdoshëm të përgjegjësisë civile jashtë kontraktore dëmi, faji dhe lidhja shkakësore: *“Çdo faj që i shkakton tjetrit një dam, obligon damtuesin me shpërblye këtë.”*

Dallohet qartë që Kodi Civil parashikon si bazë të përgjegjësisë, që rrjedh nga veprimet e paligjshme, fajin e autorit të dëmit. Faji duhet të provohet nga i dëmtuari. Në rast se ky nuk është në gjendje të provojë se personi që ka shkakuar dëmin ka vepruar me faj, nuk mund të pretendojë shpërblimin e tij.

Përveç parimit të përgjithshëm sipas të cilit dëmi i shkakuar duhet shpërblyer, Kodi Civil parashikonte gjithashtu edhe rastet e shkarkimit, apo kufizimit të kësaj përgjegjësie në raste të caktuara.

Neni 1149/ II i Kodit Civil parashikonte: *“Këtë obligim (për shpërblimin e dëmit) e ka edhe ai, që, duke kapërcye në ushtrimin e një të drejtë të vet, kufijtë e caktuem prej mirëbesimit ose prej qëllimit për të cilin i asht njoftë ajo e drejtë, i shkakton tjetrit një dam.”*

Nga vlerësimi i dispozitës realizohet, që personi i cili ka shkaktuar një dëm në ushtrim të një të drejtë të tij të ligjshme, nuk ngarkohet me përgjegjësi civile. Kjo, përderisa ai, nuk tejkalon kufijtë e lejuar për ushtrimin e të drejtës së ligjshme. Kalimi i këtyre kufijve është i kundërligjshëm dhe si rrjedhim passjell përgjegjësinë për autorin e dëmit.

Kodi Civil i vitit 1929 detyron çdo person me zotësi juridike për të vepruar, që në mënyrë të paligjshme ka shkaktuar një dëm, të shpërblejë dëmin. Megjithatë Kodi parashikon se edhe një person i pazoti për të vepruar mund të ngarkohet me përgjegjësi, në rastet kur ai ka qenë në gjendje të vlerësojë veprimet e veta. *“I pazoti asht përgjegjës për veprimet e tij të paligjshme, në qoftë se ka veprue me fuqinë mendore çmuese.”*

Është rasti që të vijohet vetëm, duke përmendur rastet e tjera të rregulluara nga Kodi Civil 1929, pa hyrë në analizë të hollësishme të tyre.

Në Kod gjejnë rregullim të posaçëm “Përgjegjësia për veprimet e personave që mësojnë një mjeshtëri”, “Përgjegjësia për veprimet e paligjshme të shërbëtorëve dhe punëtorëve”, “Përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga kafshët”, “Përgjegjësia për faktet e ardhura nga sende”, “Përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga shembja e ndërtesave”, si dhe “Përgjegjësia për detyrimet që rrjedhin nga veprimet e paligjshme të shkaktuara nga shumë persona”.

Neni 1160 i Kodit Civil përcakton mënyrën e shpërblimit të dëmit. Detyrimi që rrjedh nga veprimi i paligjshëm përfshin shpërblimin e dëmeve që kanë ardhur nga ky veprim. Dëmet mund të jenë materiale dhe morale dhe njihet mundësia e riparimit të dëmit material dhe të dëmit moral.

Ligji Nr.2359, datë 15.11.1956 “Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet”.

Në veçanti në ligj ishte parashikuar shpërblimi i dëmit në rastin e shkakimit të vdekjes, plagosjes, në rast cenimi të nderit e dinjitetit të personit apo familjes së tij, në rastin e dhunimit të personit apo banesës, si dhe në rastin e cenimit të jetës private.

Për herë të parë në legjislacionin material parashikohen rastet e shpërblimit të dëmit moral, dëmi i shkakuar si pasojë e vuajtjeve shpirtërorë nga vdekja e një personi të afërt.

Ligji Nr.2359, datë 15.11.1956 “Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet” ishte përpjekje për të bërë zëvendësimin e legjislacionit me norma të reja, që i përkisnin një regjimi të ndryshëm politik dhe ekonomik. Ligji rregulloi marrëdhëniet e detyrimeve deri në vitin 1981, kur doli Kodi Civil, i cili përmbledhi në të edhe pjesën e përgjithshme të marrëdhënieve juridiko-civile.

Rregullimi i përgjegjësisë që rrjedh nga shkaktimi i dëmit në ligjin “Mbi veprimet juridike dhe detyrimet”, LVJD, krahasuar me Kodin Civil të vitit 1929, pranon vetëm dëmin pasuror, duke mohuar shpërblimin e dëmit moral.

Në nenin 472 të ligjit materializohet parimi i përgjegjësisë që rrjedh nga shkaktimi i dëmit:

“Personi që me faj (me dashje ose nga pakujdesia) i shkakton dëm në mënyrë të paligjshme, një tjetri në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkakuar. Personi që ka shkakuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj.”

Elementet e përgjegjësisë që rrjedh nga shkaktimi i dëmit dhe baza e përgjegjësisë civile dallohen në ekzistencën e dëmit, paligjshmërinë e veprimit, lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit dhe pasojës së ardhur, si dhe fajin e autorit të dëmit, që përbën dhe bazën e kësaj përgjegjësie.

Kusht i domosdoshëm për lindjen e përgjegjësisë civile sipas LVJD-së është ekzistenca e dëmit. Me dëm në përgjithësi, kuptohet si dëmi material ashtu edhe dëmi jo material. Dëmi material i cili shkakton pakësim të të mirave të të dëmtuarit mund të shpërblehet në të holla. Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për dëmin jo material, siç mund të jetë dëmi që i shkaktohet personit në jetën, shëndetin, nderin dhe dinjitetin e tij, i cili sipas LVJD nuk mund të vlerësohet në të holla¹.

Për këtë arsye LVJD nuk pranon shpërblimin e dëmit jo material apo ndryshe të dëmit moral. Në rast se është shkakuar një dëm në të mirat jo materiale, siç mund të jetë shkaktimi i vdekjes së një personi, do të shpërblehen vetëm dëmet pasurore që mund të jenë shkakuar.

¹ Andon Sallabanda – “E drejta e detyrimeve”, Tiranë 1962

Lindja e përgjegjësisë civile për shpërblimin e dëmit, kërkon që dëmi të jetë shkaktuar në mënyrë të paligjshme. Kundërligjshmëria përbën një kategori objektive dhe ka të bëjë me faktin, se veprimi që ka shkaktuar dëmin vjen në kundërshtim me normat e së drejtës objektive. Në fakt personi që ka shkaktuar dëmin, duke kryer një veprim në kundërshtim me të drejtën objektive, ka cenuar në rastin konkret një të drejtë subjektive e të dallueshme të të dëmtuarit, për shembull në rastin e vjedhjes së një sendi është cenuar e drejta subjektive e pronësisë së të dëmtuarit.

Dëmi i shkaktuar në mënyrë të paligjshme mund të vijë si pasojë e një veprimi apo një mosveprimi të kundërligjshëm.

Veprimi konsiderohej i kundërligjshëm nëse ishte i ndaluar nga ligji. Për sa i përket mosveprimin konsiderohej rasti, kur autori i dëmit ishte i detyruar të vepronte, kishte pasur mundësi të vepronte dhe nuk kishte vepruar. Detyrimi dhe mundësia për të vepruar duhej të konkurronin së bashku.

Kundërligjshmëria që ka shkaktuar dëmin, është kusht për përgjegjësinë për shpërblimin e tij. Për këtë arsye, LVJD ka parashikuar rastet, kur një person, ndonëse ka shkaktuar një dëm, nuk përgjigjet civilisht, për shkak se mungon karakteri i kundërligjshëm i dëmit të ardhur. Gjithashtu sipas LVJD-së (neni 474/1) personi që ka shkaktuar një dëm në gjendjen e mbrojtjes së nevojshme, përjashtohet nga përgjegjësia për shpërblimin e tij, duke përjashtuar në këtë mënyrë karakterin e kundërligjshëm të këtij dëmi.

Në vijim, në rastin e nevojës ekstreme, personi që ka shkaktuar një dëm në këto kushte, nuk është përjashtuar nga përgjegjësia për shpërblimin e tij, pra ai detyrohet të shpërblejë këtë dëm. (neni 474/2). Megjithatë lihej gjykata që të vlerësonte rast pas rasti rrethanat e shkaktimit të dëmit dhe të shkarkonte plotësisht apo pjesërisht autorin nga detyrimi për dëmshpërblim.

Lidhja shkakësore midis veprimin të kundërligjshëm dhe pasojës së ardhur (dëmit) ishte një element i rëndësishëm që kushtëzonte përgjegjësinë civile nga shkaktimi i dëmit. Sipas nenit 472 të LVJD-së veprimi i kundërligjshëm duhej të ishte shkaku i dëmit dhe vetë dëmi, pasoja e këtij veprimi. Lidhja shkakësore duhej të ekzistonte edhe kur dëmi ishte rezultat i një mosveprimi, domethënë midis këtij dhe rezultatit që duhej të ish penguar po që se ai do të kishte vepruar. Lidhur me trajtimin e lidhjes shkakësore, kjo është trajtuar dhe ka zënë vend të rëndësishëm në doktrinën e kohës.

Në detyrimet që lindnin nga shkaktimi i dëmit, siç parashikohet dhe në nenin 472 të ligjit, në dallim me Kodin Civil të vitit 1929, pranohet prezumimi i fajësisë. Kjo është rrjedhojë e drejtpërdrejtë pranimit të fajësisë si element i përgjegjësisë. I dëmtuari nuk është i detyruar të vërtetojë fajësinë e autorit të dëmit, për arsye se ky prezumohet fajtor. Paragrafi II në dispozitën e mësipërme, parashikon se personi i cili ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Kjo do të thotë që barra e provës i takonte autorit të dëmit, të vërtetonte se nuk kishte pasur faj në ardhjen e këtij dëmi.

Megjithatë pavarësisht se si rregull i përgjithshëm bazë për përgjegjësinë civile që rrjedh nga shkaktimi i dëmit ishte faji i autorit të tij, ligji në disa raste ka pranuar edhe përgjegjësinë pa faj, siç është rasti i shkakimit të dëmit nga një veprimtari që përbën burim rreziku të shtuar.

Ashtu sikurse në legjislacionin e mëparshëm, edhe në LVJD parashikohet përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga të miturit nën dhe, mbi 14 vjeç. Parashikohet gjithashtu përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga personi pa zotësi për të vepruar, apo përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga organi i personit juridik, nga nëpunësit dhe nga punëtorët.

Përgjegjësia e personit juridik shtetëror për dëmin e shkaktuar nga personat zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave të administrimit shtetëror, përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga një veprimtari, burim rreziku i shtuar, apo përgjegjësia solidare gjeten trajtime fillestare në ligj.

Në nenin 484 të LVJD-së, parashikohet **shpërblimi i dëmit** në këtë rregullim: *“Për shpërblimin e dëmit, gjykata sipas rrethanave të çështjes, mund të vendose detyrimin e personit që ka shkaktuar dëmin ose me ekzekutimin në natyrë ose me shpërblimin e humbjeve, duke përfshirë në këtë, kur është rasti, edhe fitimin e munguar”*.

Sipas rregullimit ligjor, shpërblimi i dëmit përbëhet nga humbjet dhe fitimi i munguar, duke zbatuar parimin e shpërblimit të plotë të dëmit. Megjithatë, në nenin 486/1 të LVJD-së, parashikohet një përjashtim nga ky parim. Ky ka të bëjë me faktin se sasia e shpërblimit të dëmit do të caktohet, duke pasur parasysh gjendjen pasurore të të dëmtuarit dhe atë të autorit të dëmit, me përjashtim të rastit kur i dëmtuar është një organizatë shtetërore, kooperativiste ose shoqërore.

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në rastin e vdekjes apo të dëmtimit të shëndetit, gjen rregullimin në nenin 490 të LVJD, në të cilin parashikohet se kur personi i dëmtuar përfiton nga sigurimet shoqërore, atëherë dëmi do të shpërblehet nga organi i sigurimeve shoqërore. Kur i dëmtuari nuk ka përfituar të gjithë shpërblimin nga sigurimet shoqërore, ai ka të drejtë të

kërkojë nga personi përgjegjës për dëmin pjesën e mbetur. Nga ana tjetër, vetë sigurimet shoqërore shtetërore kanë të drejtë të kërkojë nga autori i dëmit kthimin e asaj çka i kanë paguar të dëmtuarit.

Në rastin e shkaktimit të vdekjes, neni 489 i LVJD-së ka parashikuar personat të cilët kanë të drejtë të kërkojnë shpërblimin e dëmit. *“Kur shkaktohet vdekja shpërblehet dëmi që kanë pësuar personat e mitur dhe të paaftë për punë, të cilët kanë qenë në ngarkim të të vdekurit plotësisht ose pjesërisht si dhe personat që kishin të drejtën e ushqimit prej tij.”*

Rezulton që kusht për t’u shpërblyer personat e mitur dhe të paaftë për punë, është gjendja e tyre në ngarkim të të vdekurit në kohën e vdekjes. Ndërsa personat që kishin të drejtën e ushqimit nga i vdekuri, kanë të drejtë të shpërblehen për dëmin e shkaktuar, pavarësisht nga fakti nëse ata kanë qenë apo jo në ngarkim të të vdekurit.

LVJD parashikon dhe përgjegjësinë në rastin e dëmtimit të shëndetit të personit. Dëmet që mund të vijnë janë ato që kanë të bëjnë me shpenzimet për mjekim dhe të tjera të shkaktuara nga humbja ose pakësimi i aftësisë për punë. Këto janë edhe dëmet që duhet të shpërblejë autori i tij. Shpërblimi i dëmit, i caktuar si pasojë e pakësimit të aftësisë për punë mund të ndryshojë me kalimin e kohës mbi bazën e kërkesës së të dëmtuarit.

Pas shkaktimit në mënyrë të paligjshme të një dëmi, personi i dëmtuar legjitimohej të ngrinte **padinë për shpërblimin e këtij dëmi**.

Ligji parashikonte rregullin e përgjithshëm së parashkrimi i padisë fillon nga çasti që lind e drejta e padisë, Kurse për detyrimet që ekzekutohen me kërkesën e kreditorit parashkrimi fillon që kur lind detyrimi.

Në ndryshim nga ky rregull i përgjithshëm, afati i parashkrimit të padisë, që rrjedh nga shkaktimi i dëmit, fillon nga dita që i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte, për dëmin dhe për autorin e tij.

Fillimi i afatit lidhej kështu, me ardhjen në dijeni të dëmit të shkaktuar dhe të subjektit që e kishte shkaktuar. Vetëm në këtë moment i dëmtuari mund të ngrejë padinë për shpërblimin e dëmit.

3. Rrethana dhe kushte të shkakimit të dëmit. Baza ligjore

Është koha për të trajtuar dhe analizuar karakteristika të përgjithshme të kushteve të përgjegjësive që rrjedh nga shkaktimi i një dëmi.

Dëmi. Përgjegjësia civile që rrjedh nga shkaktimi i dëmit, nuk mund të kuptohet pa këtë të fundit. Ekzistenca e dëmit, si kusht për lindjen e përgjegjësive, përcakton në të njëjtën kohë dhe karakteristikat e kësaj përgjegjësie, llojin e dëmit të shkaktuar dhe mënyrat dhe mundësitë e reagimit për kërkimin e shpërblimit apo zëvendësimit të tij.

Neni 608/1 i Kodit Civil parashikon: *“Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.”.*

Nisur nga natyra e së drejtës së dhunuar, dëmi mund të jetë: Dëm pasuror ose material (patrimonial) dhe dëm jo pasuror ose moral (extrapatrimonial).

Me dëm pasuror do të kuptohet dëmi i ardhur si pasojë e cenimit të një të drejtë, e cila përfaqësohet nga një vlerë tregu, gjithmonë e vlerësueshme në të holla. Ky lloj dëmi dallohet nga ai që mund t’i shkaktohet personit në fizikun e tij sepse dhimbja e shkaktuar nga dëmtimi trupor nuk është vlerë materiale tregu. Të tilla konsiderohen dhe shpenzimet mjekësore dhe farmaceutike, paaftësinë në punë etj.

Dëmet pasurore janë të shumëllojshme dhe në terma të përgjithshme mund të përfaqësohen nga dëmtimi apo shkatërrimi i një sendi. Mund të konsiderohen të tilla dhe humbjet ekonomike si

rezultat i një veprimtarie të paligjshme në forma të ndryshme, apo rrjedhojë e konkurrencës së pandershme etj.

Në nenin 640/1 të Kodit Civil përkufizohet kuptimi material i dëmit pasuror: “Dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar.” Në këtë mënyrë dëmi pasuror konceptohet në një aspekt të dyfishtë: humbjet e pësuar (*damnum emergens*) dhe fitimi i munguar (*lucrum cessans*).

Me termin humbje e pësuar, duhet kuptuar varfërimi ekonomik, pakësimi i të mirave materiale dhe monetare² i shkaktuar nga fakti dëmprurës, si: dëmtimi i një sendi, shkatërrimi i një ndërtese, shpenzimet si rezultat i një aksidenti, humbja e një të drejtë etj.

Në fitimin e munguar përfshihen të gjitha përfitimet të cilat sjellja e të tretit përgjegjës, i ka ndaluar të realizohen.

Në praktikën e Gjykatës së Lartë rastet janë të shumta, kur fitimi i munguar konsiderohet si dëm pasuror.

“Në çdo rast kur pala debitore refuzon përmbushjen e detyrimit ajo merr përsipër rrezikun që në të ardhmen të paguajë edhe fitimin e munguar që do të rezultojë nga mospërmbushja në afat e detyrimit....., duke qenë se në rastin në shqyrtim nuk ka kamata të përcaktuara të përcaktuara me ligj... shumta e dëmit të shkaktuar përcaktohet me eksperte....., duke pasur parasysh shumtat e interesave që paguanin bankat në atë kohe për depozitat. Ky është një kriter i zbatuar nga gjykatat edhe për raste të tjera”³.

Dëmi pasuror mund të jetë aktual apo dëm i ardhshëm, i sigurtë apo i mundshëm.

*Dëmi aktual dhe dëmi i ardhshëm*⁴. Dëmi aktual, domethënë i realizuar, nga vetë natyra e tij aktuale është plotësisht i shpërblyeshëm. Ky është një dëm i sigurt, mjaft të jetë i provuar dhe si rrjedhim duhet të shpërblehet shkaktimi i tij.

² Thimjo Kondi – “Drejtësia” Nr.3/1989

³ Vendim Nr.999, datë 24.10.2002, faqe 28, volumni 10 – 2002 “Vendime të Gjykatës së Lartë”

⁴ “Obligations et la responsabilite civil” 1998

Dëmi i ardhshëm, ndryshon nga koncepti i pritshëm. Edhe dëmi i ardhshëm është, në shumicën e rasteve i shpërblyeshëm. Kujtoj rastet e aksidenteve me pasojë paaftësinë për punë, kur dëmi përfaqësohet dhe nga shpenzimet e ardhshme për mjekim, shpenzimet spitalore, të riaftësimin dhe të nevojave të tjera.

Në të tilla raste dëmi i ardhshëm detyron personin përgjegjës ta dëmshpërblejë atë, për shkak se ky është një dëm që ekziston në sajë të veprimit që e ka shkaktuar atë, dhe është rrjedhim natyral i gjendjes post aksidentale të të dëmtuarit. Ndryshe është rasti kur dëmi i ardhshëm nuk është veçse një pritje, kësaj radhe e tipit eventual (të mundshëm), e karakterit të rastit dhe jo më të sigurt.

Dëmi i sigurtë dhe dëmi eventual. Dëmi mund të çojë në lindjen e përgjegjësisë për shpërblimin e tij, vetëm nëse humbja ekonomike e pësuar është e sigurt. Kjo është në radhë të parë një çështje e të provuarit dhe barra e kësaj provë i takon të dëmtuarit që kërkon dëmshpërblimin.

Duke qenë se në këtë rast bëhet fjalë për një dëm tashmë të realizuar, kjo provë është relativisht e lehtë me anën e një ekspertimi të vendosur nga gjykata. Kur çështja shtrohet lidhur me një dëm të ardhshëm, ajo është më e ndërlikuar. Sigurisht që edhe në këtë rast i dëmtuari duhet të provojë sërish humbjen e pësuar dhe fitimin e munguar si rezultat i shkakimit të dëmit pasuror të pretenduar. Kur kjo provë është e plotë, dëmi i ardhshëm do të shpërblehet.

Por ka raste kur situata nuk është dhe aq e qartë. Në rastin e një aksidenti të mundshëm, nuk mund të pretendohet se viktimi mund të kishte vdekur nga një shkak natyror, për shembull pak kohë më vonë, apo si rezultat i një aksidenti tjetër, apo mund të kish humbur vendin e punës etj. Është e qartë se një siguri absolute nuk mund të ekzistojë në këtë drejtim dhe as në atë të kundërt, duke bërë të pamundur që, në këto raste, të llogaritet me saktësi dëmi i shkaktuar.

Duke marrë shkas nga natyra e dëmit, dëmi i shkaktuar nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës, i përfaqëson të dy natyrat e dëmit. Në praktikë, pa u vlerësuar këto karakteristika, këmbëngulet në ekzistencën e elementëve të dëmit:

“Në bazë të nenit 27/1 të Kodit të Punës punëmarrësi përgjigjet për dëmin e shkaktuar punëdhënësit...Kjo përgjegjësi civile nënkupton realizimin e katër kushteve ekzistencën e dëmit, shkeljen nga ana e punëmarrësit të detyrimit, ekzistencën e lidhjes shkakësore midis dëmit dhe

veprimeve si dhe ekzistencën e fajit (ne formën e dashjes ose pakujdesisë)..Te gjithë këta elementë duhet të ekzistojnë dhe të jenë të lidhur me njeri - tjetrin.”⁵

⁵ Vendim nr.302, date 10.02.2004, faqe 160, volumi 2 – 2004 “Vendime të Gjykatës së lartë”.

4. Kuptimi i përgjithshëm i dëmit jo pasuror.

Karakteristikat e dëmit jo pasuror, dallohen si rrjedhoja të kundërligjshmërisë së sjelljes në shoqëri, ndaj të tretëve. Vështrim i përgjithshëm mbi formën dhe përmbajtjen e dëmit jo pasuror është tërheqja kryesore në këtë punim. Kushtet e përgjithshme në lidhje me praninë e elementëve përbërës të përgjegjësisë së rrjedhur nga shkaktimi i dëmit jo pasuror, janë thuajse të njëjtë me ato që verifikohen në përgjegjësinë për dëmin pasuror.

Për të bërë sa më të afërt kuptimin e zbatueshmërisë në realitetet të ligjit, përvijimet mbi dëmin jo pasuror do të udhëhiqen nga pikëpamje të materializuara në ngjarje juridike. Duke përfituar nga kjo pikënisje, po përdor si ngjarje juridike, mbi bazën e të cilave do të krijohen më tej opinionet vlerësuese, rrethanat e faktit që vijojnë:

“Në një banesë, për shkak të ndërprerjes së vazhdueshme të energjisë elektrike dhe prurjeve tej normativave të voltazhit kishte rënë zjarr. Gjatë përpjekjeve për mënjanoz shkaku e zjarrit, kontaktin me tensionin të shuar zjarrin, zjarrfikësi “X” humbi jetën. Nuk rezultoi që zjarrfikësi të ishte i siguruar për jetën.”

Pyetjet që do të ndihmojnë koherencën e shfaqjes së opinionëve janë:

A ndodhemi para shkaktimit të dëmit në këtë rast ?

Në së po, çfarë dëmi është shkaktuar ?

Cili subjekt e ka shkaktuar ?

Cilët janë elementet e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar ?

Si do të llogaritet dëmi dhe mënyra e caktimit të shpërblimit ?

Situatat doktrinare dhe juridike do të orientonin përgjigje të tilla:

Jemi përpara një dëmi të dyfishtë, pasuror dhe jo pasuror. Ky dëm përfaqësohet, ai pasuror nga pakësimi i pasurisë me djegien e banesës dhe, ai jo pasuror, nga humbja e jetës.

Në ngjarjen juridike të treguar gjendet e pasqyruar lidhja shkakësore midis veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit që kishte në administrim furnizimin me tension të lartë dhe ardhjes së pasojës, humbjes së jetës nga kontakti me tensionin e lartë.

Duke treguar ekzistencën e lidhjes shkakësore i kemi dhënë ndërkohë përgjigje faktit në se ka apo jo përgjegjësi dhe cili subjekt do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar.

Llogaritja e dëmit, duket pjesa me e thjeshtë: Në të përfshihen shpenzimet e varrimit etj. Me fjalën “e tjerë” do të merremi më hollësisht më vonë, kur të analizojmë llogaritjen e dëmit të shkaktuar.

Me paramendim trajtova si shembull një nga rastet e largëta të përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit kundër shëndetit, atëherë kur dëmi ka ardhur nga ushtrimi i veprimtarisë me burim rreziku të shtuar, duke pranuar vlerësim aksiomatik të rastit kur dëmi shkaktohet me faj të drejtpërdrejtë. Mjaft që të provohet faji dhe lidhja shkakësore me pasojën e ardhur.

Pasi, me dashje, kam veçuar nga moria e ngjarjeve të përditshme, një ngjarje të veçantë juridike, me lidhje të dobëta midis elementeve të përgjegjësisë, që e bëjnë të vështirë cilësimin juridik të rrethanës së faktit, dhe jam përpjekur t’i jap përgjigje disa nga pyetjeve të shtruar për zgjidhje, le të merremi me trajtimin në pikëpamje teorike juridike.

Në shumë legjislacione titulli që rregullon shkaktimin e dëmit dhe përgjegjësinë përkufizohet si “Fakt i kundërligjshëm” (Kodi Civil Italian, Titulli 9) apo “Veprime të paligjshme” (Kodi Civil i Zogut – seksioni 6) etj.

Rregullimet që i bëhen përgjegjësisë në parime janë thuajse të njëjta. Ndryshimet dallohen në rregullimin e anës materiale të posaçme. Ndërsa në Kodin Civil Italian mjaftohet vetëm me përkufizimin që “..dëmi jo pasuror duhet të shpërblehet...” (Neni 2059), në Kodin Civil francez

pranohet përgjegjësia e përzier (Neni 1032 i Kodit Civil), në Kodin tonë Civil tentohet, natyrisht në mënyrë të gabuar që, dëmi jo pasuror të trajtohet kryesisht si dëm kundër shëndetit.

Duke qenë një temë e parratur nga autorë vendas do të jemi të privuar nga debati me punime të dalluara në këtë drejtim. E vetmja mundësi na ngelet të zhvendosim vëmendjen në krahasime me trashëgiminë tonë legjislative, me legjislacione bashkëkohor si dhe teoritë e praktikën më të fundit të objektit.

Karakteri historik i zhvillimit të dëmit jo pasuror merr vlera të veçanta, për të njohur trashëgiminë ligjore dhe teorike, nivelet bashkëkohore dhe perspektivat e institutit të njohjes. Të dhëna të reja doktrinare krahasuese mbi kuptimin e përgjithshëm do të jenë objekt i vëmendjes në këtë studim.

Termi i sotëm “dëm i shkaktuar shëndetit” apo “dëm jo pasuror” (që është koncept më i gjerë), u përshtat për herë të parë si institut ligjor në të drejtën zakonore, duke zënë hapësira në “Sheriat” apo “Kanunin e Lek Dukagjinit”. Pavarësisht nga emërtime dialektore të ndryshme, bëhej fjalë për dëmin që i shkakohej shëndetit dhe moralit.

Me përjashtim të veprimeve që synonin jetën e personit, në krahasim me dëmet e tjera, dëmi jo pasuror ishte thuajse gjithmonë më i rëndësishmi. Vlerësimi i dëmit dhe mënyra e shpagimit, në rastet kur nuk parashikohej posaçërisht në të drejtën zakonore, bëhej nga përfaqësuesit më të moshuar dhe të nderuar të komunitetit.

Jo rrallë shkaktimi i dëmi jo pasuror barazohej me veprën penale, herë si objekt i saj, herë si pasojë. Megjithatë gjykatësit ishin të kujdesshëm të mos i jepnin për çdo rast formën dhe përmbajtjen e dënimit.

Në historinë e së drejtës tonë civile, mbijetesa e dëmit jo pasuror, si koncept dhe institut ligjor, i ngjan asaj të Krishtit, me një ndryshim të vogël, ky koncept u rikthye në të drejtën tonë jo pas 40 ditësh, por pas 40 vjetësh, .

Në përgatitjen dhe themelimin e Kodit të Ri Civil, duke tejkaluar përkthimet e dobëta, u konsumuan nocione të tepërta dhe u lejuan mangësi, që herë pas herë e bëjnë të paqartë dhe të pazbatueshëm rregullimin e dëmit jo pasuror, kuptimin dhe zbatimin e këtij instituti. Sidoqoftë më mirë shumë apo pak, se sa asgjë.

5. Forma e shfaqjes së dëmit jo pasuror. Karakteristika të anës materiale

Në analizën e posaçme të elementëve përbërës të dëmit jo pasuror, forma e dëmit jo pasuror është shfaqja e parë, rrjedhojë e konsumimit të elementëve të përgjegjësive civile. Kuptimi i karakterit material të dëmit jo pasuror merr rëndësi të veçantë. Mënyra e llogaritjes së tij është një nga elementët më të diskutueshëm në doktrinën dhe praktikën gjyqësore.

Për të gjithë është e qartë, që dëmi jo pasuror nuk përfaqësohet vetëm nga dëmi kundër shëndetit dhe fakti që do ti përmbahemi vetëm këtij të fundit, nuk duhet të vlerësohet si ometim.

Megjithatë duhet të qëndrojmë gjatë në sqarimin e konceptit dëm jo pasuror dhe dëm kundër shëndetit, sidomos në konceptin “dëmtim i shëndetit”, duke u përpjekur të qartësojmë se a janë e njëjta gjë apo janë koncepte që në përmbajtje të tyre përfshijnë njeri-tjetrin.

Neni 625 i Kodit Civil rregullon përgjegjësinë për dëmin jo pasuror në këtë mënyrë:

“Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur:

- a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cenuar në nderin e personalitetit të tij;*
- b) është fyer kujtimi i një të vdekuri....”*

Dispozita e përmendur e kufizon dëmin jo pasuror në dëmtim të shëndetit, të personalitetit dhe, në mënyrë të posaçme, të kujtimit të një të vdekuri.

Duke u shprehur në kundërshti me ligjin, opinioni dhe vlerësimi im është që dëmi jopasuror i përcaktuar në dispozitën e përmendur nuk është i plotë, për më tepër është i pasaktë sidomos kur, dëmtimin e shëndetit e trajton vetëm si dëm jo pasuror ose kur cenimin e nderit dhe personalitetit e kufizon vetëm në dëm jo pasuror.

Sipas doktrinës civile, përgjegjësia për dëmin kundër shëndetit shpreh detyrimin e sistemit juridik në mbrojtje të personit, që sigurohet jo vetëm në profilin e paprekshmërisë fizike, por edhe të paprekshmërisë morale. E thënë ndryshe, mbrojtja e posaçme që realizohet me rregullimin e përgjegjësive së dëmit kundër shëndetit, synon jo vetëm mbrojtjen fizike të njeriut, por edhe të të drejtave të tij në lidhje me etiken, personalitetin etj. Në këtë këndvështrim, dëmi kundër shëndetit është quajtur nga doktrina bashkëkohore edhe “Dëmi biologjik” (që nënkupton dhe përfshin mbrojtjen e tërësisë fizike e psikike të personit).

Një pjesë e jurisprudencës bashkëkohore e ndan, në koncept dhe vlerësim, dëmin biologjik nga dëmi moral, duke e karakterizuar dëmin biologjik si “..shqetësim psikologjik të lidhur me vuajtjen fizike dhe dhimbjen morale..” ndërsa në dëmin moral, atë që përbën dëmin biologjik, e identifikon me shkakun e dëmit moral, shkak “..i cili përcakton efektivisht ndryshimet në psikikën e njeriut të cilat ndikojnë negativisht në normalitetin e jetës së personit..”

Në përfundim jurisprudenca e përmendur arrin në konkluzionin që dëmi biologjik dhe dëmi moral nuk përputhen, i pari riparon dëmtimin personal dhe shoqëror, ndërsa i dyti, vuajtjen e përkohshme si rrjedhojë e faktit të kundërligjshëm ose e ekzistencës së shkakut (dëmit biologjik).

Duke konkluduar në këtë vlerësim, dëmi biologjik përbëhet nga një përzierje e dëmit pasuror me atë jopasuror, të pranishëm thuajse në të gjitha rastet e dëmtimeve fizike dhe të shpërblyeshëm në mënyrë të pavarur.

Përcaktimet e dispozitës bazë të dëmit jopasuror janë burim pasigurie në teori dhe praktike. Shkaku është se teoria, ligji dhe jurisprudenca e trajtojnë përgjegjësinë nga shkaktimi i dëmit në përgjithësi dhe përgjegjësinë në dëmin kundër shëndetit në veçanti, si dëme jashtëkontraktor, ndërsa jemi të ndërgjegjshëm që, dhe dëmtimet që mbrohen dhe rregullohen nga kontratat e sigurimit, kontratat e punës, në fund të fundit, janë të drejtuara kundër shëndetit.

Kjo mospërputhje midis dispozitës materiale dhe rregullimit kushtetues, që e mbron jetën dhe shëndetin pa kufizime institucionale juridike, përbën një nga inkoherencat e ligjit civil.

Pavarësisht nga rregullimet e posaçme të dëmit kundër shëndetit në marrëdhëniet kontraktore, dëmtimi i shëndetit është i njëjte, por mbrojtja që i realizohet individit me kontratën, në volum, është me e vogël se mbrojtja e rregulluar nga përgjegjësia për shkaktimin e dëmit të shëndetit.

Megjithëse do të flasim me hollësi më vonë, për shpërblimin e dëmit kundër shëndetit, duke i konsideruar opinione hyrëse pak fjale për konceptin e dëmit biologjik, termat e këtij koncepti, konstatimin dhe vlerësimin e tij.

Është pranuar ndërkohë nga teoria dhe jurisprudenca, me terma kategorikë, që dëmi biologjik duhet të shpërblehet, në rrugë të përgjithshme si një dëm i padrejtë, deri në kapërcim të kufijve të parashikuar nga neni 641 i Kodit Civil.

Kjo për shkak së dëmi kundër shëndetit duhet të konsiderohet, duke anuar nga dëmi material, si dëm që, në vetvete, i shpreh pasojat në pasurinë e subjekteve fizike. Në thelb, duke u drejtuar kundër njeriut, përfaqëson në mënyrë ekskluzive dëmtim të interesave morale, kulturore, shoqërore, fizike, duke qenë gjithmonë i shpërblyeshëm materialisht.

6. Dallimi i përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit jo pasuror dhe Verifikimi i dëmit.

Dallimi i përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit jo pasuror dhe Verifikimi i dëmit është hapi i parë që duhet të realizohet në situatat gjyqësore.

Rrugët normale dhe me të përdorshme të verifikimit të dëmit kundër shëndetit janë:

Bisedimi midis palëve. (Përpjekjet për të zgjidhur konfliktin me pajtim),
Procesi administrativ,
Procesi penal,
Procesi Civil (Me përjashtim të objektit të shkaktimit të dëmit të pretenduar).

Në të gjitha këto mundësi dallohet dhe kërkohet prania e kornizës procedurale. Konstatimi i dëmit kundër shëndetit, përgjatë të katër mundësive të përmendura, konsiderohet i vlefshëm dhe shërben gjithmonë si shkak i objektit të padisë.

Menjëherë pasi është verifikuar dëmi kundër shëndetit: Humbja e jetës, dëmtimi i shëndetit nga kushtet e paraburgimit etj., krijohet shkak për të kërkuar shpërblimin e tij dhe, subjektit të dëmtuar apo përfaqësuesit të tij ligjor, nuk u ngelet gjë tjetër veçse të paraqesin padinë.

Përpara gjykatës lind një problematikë e tërë që mund të reduktohet në këto çështje:

Përshtatja e bazës ligjore (Neni 16 i Kodit të Procedurës Civile),

Vërtetimi i kundërligjshmërisë në rastet kur faji është element i përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit apo, i mungesës së forcës madhore në rastet e përgjegjësisë pa faj.

Gjetja e lidhjes shkakësore midis veprimit apo mosveprimit të kundërligjshëm dhe pasojës,

Vlerësimi i dëmit të shkaktuar dhe masës së shpërblimit.

Në lidhje me çështjen e parë, që ishte përcaktimi i bazës ligjore. Praktika gjyqësore na ka treguar që veprohet pak a shumë kështu:

Në rrethana të zakonshme procedurale gjyqtari udhëhiqet nga neni 16 i Kodit të Procedurës Civile: "...Gjykata bën cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët", duke vijuar me përcaktimin e bazës ligjore të padisë, nenin 641 të Kodit Civil.

Shembujt që do të vijojnë tregojnë që kjo punë nuk është kaq e thjeshtë sa po tregohet apo sa, duket, përkundërti kërkon njohje të thellë të ligjit dhe të gjitha cilësitë e një gjyqtari të aftë profesionalisht për të kryer detyrën.

Neni 640 i Kodit Civil parashikon: "Dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar..."

Ndërsa neni 641 i Kodit Civil, duket sikur merret me shpërblimin e dëmit jo pasuror, duke barazuar humbjen me pakësimin e aftësisë për punë si dhe me shpenzimet për mjekim etj:

"Personi që i ka shkaktuar tjetrit një dëm në shëndetin e tij detyrohet ta shpërblejë dëmin, duke pasur parasysh humbjen ose pakësimin e aftësisë për punë..., shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij, si dhe shpenzime të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar"

Disa nene me sipër, pikërisht në nenin 625 të Kodit Civil, përmendim edhe njëherë përmbajtjen e tij, përcaktohet:

"Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur:

- a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cenuar në nderin e personalitetit të tij;
- b) është fyer kujtimi i një të vdekuri...."

Paqartësia dhe inkoherenca në dispozitat e fundit, na detyrojnë të rikthehemi një çast në vlerësimin e konceptit dëm kundër shëndetit, duke u përpjekur të dallojmë në se ka apo jo elementë të dëmit pasuror.

Situata të tilla kur, janë të siguruara pjesë të ndryshme të trupit apo shëndeti (duart në rastin e një pianisti, këmbët në rastin e një atleti etj.) ka dëmtime të shëndetit, jo për faj të të dëmtuarve apo të forcave madhore, krijojnë vështirësi në përjasjen e doktrinës dhe ligjit, me cilësimin juridik të faktit.

Çfarë dëmi është shkaktuar: Pasuror apo jo pasuror? Dëm material kundër një të drejtë subjektive, asaj të “pronësisë” mbi sigurimin e veçantë të këmbëve apo duarve, apo dëm jo pasuror, drejtuar kundër shëndetit apo, së fundi, dëm moral për shkak të frustacionit që u krijua nga dështimi i shfaqjeve apo i garës.

Unë do të parashtojë këto pikëpyetje mbi këtë lloj dëmi:

Në rast se kemi dëm pasuror kush është fitimi i munguar ose, në rast se kemi dëmtim të shëndetit cilat janë shpenzimet për rikthimin e aftësisë për punë. Si do të shpërblehej dëmi moral ?

Unë nuk jam plotësisht dakord me përgjigjen e dhënë nga jurisprudenca jonë në lidhje me pyetjen e parë, që fitimi i munguar përfaqësohet nga përqindja e depozitës së kursimeve, ndërsa pyetja e dytë realisht është e diskutueshme të këtë një përgjigje përfundimtare, kategorike. Pyetjes në lidhje me shpërblimin e dëmit moral do ti japim përgjigje përfundimtare të bazuar në ligjin vendas dhe jurisprudencën evropiane.

7. Shkaktimi dëmit

Kundërligjshmëria e dëmit.

Neni 608 i Kodit Civil, i cili jep kuptimin e përgjegjësisë civile nga shkaktimi i dëmit, kërkon patjetër ekzistencën e një dëmi të paligjshëm.

Pjesëmarrja në jetën sociale, përbën gjithashtu dhe një burim incidentesh të papëlqyeshme e me pasoja të padëshirueshme.

Atëherë nëse kushtet e tjera të përgjegjësisë civile janë të plotësuara, mund të themi se në të gjitha këto raste bëhet fjalë për dëm të shpërblyeshëm në kuptim të nenit 608 të Kodit Civil.

Vetë dispozita e mësipërme në fakt, në paragrafin e dytë të saj, përkufizon kuptimin e dëmit të paligjshëm si vijon:

“...Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.”.

Dallohet qëndrimi novator në krahasim me legjislacionin e mëparshëm, që parashikonte së dëmi duhej të shkaktohej në mënyrë të paligjshme, por pa e pasqyruar në fakt në ligj.

Në këtë mënyrë i ngelej jurisprudencës dhe doktrinës të sqaronin dhe interpretonin ligjin në këtë drejtim. Nga dispozita e cituar kuptohet se një dëm do të konsiderohet i paligjshëm, nëse ka

ardhur si pasojë e veprimit ose mosveprimit, i cili ka shkelur apo cenuar të drejtat dhe interesat e një të treti, kur këto të fundit mbrohen nga rendi juridik, ose nga zakonet e mira.

Shkelja ose cenimi i të drejtave a interesave që mbrohen nga rendi juridik. Në këtë rast është e thjeshtë të kuptohet karakteri i paligjshëm i një dëmi. Kështu në lidhje me këtë, doktrina ka pranuar se kundërligjshmëria në këtë rast konsiston në faktin se veprimi (mosveprimi) vjen në kundërshtim me të drejtën objektive.

Gjithashtu dëmi, duke cenuar një marrëdhënie juridike konkrete, çon në shkeljen e të drejtës subjektive të personit të dëmtuar, e drejtë kjo që i është garantuar nga ligji (nga normat juridike objektive).⁶

Shkelja ose cenimi i të drejtave dhe interesave që mbrohen nga zakonet e mira. Në rastin kur ardhja e një dëmi do të ishte pasojë e një veprimi (mosveprimi) që vjen në kundërshtim me ligjin atëherë gjithçka do të ishte e thjeshtë. I dëmtuari do t'i drejtohej gjykatës me një kërkesë ku do të tregonte veç të tjerash të drejtën dhe interesin sipas tij të shkelur apo cenuar dhe normën juridike që i garantonte këtë të drejtë. Me plotësimin edhe të kushteve të tjera, ky person do të legjitimohej të kërkonte shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Sidoqoftë, neni 608/2 i Kodit Civil ngarkon me përgjegjësi civile edhe personin që ka shkaktuar një dëm, duke shkelur apo cenuar të drejtat dhe interesat e një të treti të mbrojtura këto nga zakonet e mira.

Zakoni përbën një mënyrë të vepruari në një shoqëri të caktuar. Siç dihet e drejta fillimisht është bazuar mbi zakonet (e drejta zakonore), duke iu referuar jo thjesht praktikës së përditshme, por njëfarë tradite që përgjithësisht ka sjellë paqen dhe ka ruajtur mirëkuptimin midis individëve të shoqërisë.

Zakonet shoqërore në këtë mënyrë përbëjnë formën e parë të së drejtës të bazuar mbi traditën apo të drejtën zakonore që sot do t'i referoheshim ndoshta si “moral i përbashkët” i materializuar në zakonet dhe paragjykimet e një shoqërie. Atëherë nëse është ky moral i përbashkët për të cilin bën fjalë neni 608 i Kodit Civil, kur i referohet “zakoneve të mira”, do të lindte pyetja se në cilat

⁶ “E drejta e detyrimeve”, pjesa e përgjithshme, Tiranë 1962 - Andon Sallabanda

raste dhe mbi ç'kritere do të konsideronim se një veprim (mosveprim) i caktuar cenon një të drejtë, interes të mbrojtur nga këto zakone të mira, pra nga morali.

Përgjigja është e vështirë, duke pasur parasysh se jo rrallë ka divergjenca mes të drejtës dhe moralit. Sigurisht mendoj se rregullat e sistemit ligjor do të prevalojnë në rast kolizioni të së drejtës dhe moralit. Ajo çka mund të them me siguri është që interesi që pretendohet të jetë shkelur, gjithsesi nuk duhet të ketë një karakter imoral, që të konsiderohet se është shkelur një e drejtë që mbrohet nga zakonet e mira.

Është detyrë e jurisprudencës që të "listojë" në të ardhmen interesat që mbrohen nga zakonet e mira, sidomos Gjykata e Lartë që do të bëjë unifikimin e praktikave të ndryshme.

Veprimi ose mosveprimi që ka shkakuar dëmin.

Siç u tha edhe më sipër paligjshmëria konsiston në papajtueshmërinë e veprimit ose mosveprimit me rendin juridik a zakonet e mira. Në këtë mënyrë ajo nuk ka të bëjë me anën subjektive, pra me fajësinë e autorit të dëmit. Si rrjedhim nuk ka rëndësi fakti nëse ky i fundit e dinte apo jo se me veprimin apo mosveprimin e tij po cenonte një dispozitë të caktuar ligjore.

Ky qëndrim është pranuar nga doktrina⁷ me argumentimin se një person i zakonshëm nuk mund të ketë informacion për gjithë legjislacionin dhe mjafton të dijë që veprimi i tij të konsiderohet i qortueshëm nga shoqëria. Pra, në këtë mënyrë prezumohet dijenia e ligjit.

Si kategori objektive dëmi mund të shkaktohet si rezultat i një veprimi ose mosveprimi të paligjshëm. Shkaktimi i dëmit nga një veprim i paligjshëm ndodh atëherë kur veprimi i autorit të dëmit vjen në kundërshtim me ligjin a zakonet e mira.

Gjithashtu dëmi mund të shkaktohet edhe nga një mosveprim i paligjshëm (neni 609/2). I tillë do të jetë rasti kur personi përgjegjës ka pasur detyrimin objektiv për të vepruar dhe në fakt nuk ka vepruar.

⁷ Dr. Marjana Semini, E drejta e detyrimeve dhe e kontratave, pjesa e përgjithshme, Tiranë 1998

Fakte justifikuese dhe përjashtimi nga përgjegjësia civile.

Ka raste kur megjithëse një personi i është shkaktuar një dëm, autori i tij nuk do të detyrohet të shpërblejë atë, për faktin se ky dëm nuk konsiderohet i paligjshëm për shkak të disa rrethanave të cilat suprimojnë karakterin e paligjshëm të tij. Vetë ligji e lejon autorin e dëmit të veprojë në një mënyrë të caktuar dhe nëse gjatë veprimeve të tij vjen një dëm, ky nuk passjell lindjen e përgjegjësisë civile që rrjedh nga shkaktimi i dëmit. Kategori të tilla që justifikojnë ardhjen e një dëmi janë:

Mbrojtja e nevojshme.

Shkaktimi i një dëmi në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, nuk passjell përgjegjësi civile për autorin e tij, ky dëm nuk është i paligjshëm. Një zgjidhje e tillë është pranuar edhe në të drejtën penale. Kodi Civil e parashikon këtë në nenin 611 të tij sipas të cilit: *“Nuk është përgjegjës ai që i shkakton dëm tjetrit për mbrojtjen e nevojshme të tij ose të një personi tjetër”*. Kjo dispozitë nuk e përkufizon kuptimin e mbrojtjes së nevojshme. Për këtë doktrina dhe jurisprudenca i janë referuar ligjit penal. Natyrisht këtu është fjala vetëm për dëmin pasuror.

Është e drejta e çdo personi që të mbrojtë jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tij apo të një tjetri nga cenimi i padrejtë i tyre.

Në mungesë të forcës publike çdokush mund të mbrohet me mjetet të cilat disponon nga një dëm i tillë i paligjshëm ndaj vetës apo një të treti.

Që të konsiderohet “e nevojshme”, mbrojtja duhet të plotësojë disa kushte ashtu si edhe sulmi. Kështu ky i fundit duhet të jetë i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit. Një sulm do konsiderohet i padrejtë, kur ai synon të cenojë të drejtat dhe interesat e ligjshme të një personi dhe vetë sulmi vjen në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu sulmi duhet të jetë i vërtetë, pra duhet të ekzistojë objektivisht dhe jo të jetë fryt i imagjinatës së mbrojtësit.

Kusht i tretë për ekzistencën e një sulmi është se ai duhet të jetë i çastit. I tillë do të jetë sulmi që është në realizim e sipër apo, duket qartë se ai po fillon. Pra, nuk jemi para një sulmi të tillë as kur ai ka përfunduar tashmë, as kur flitet për një sulm të ardhshëm për të cilin mund të merren masa parandaluese.

Për sa i përket mbrojtjes, duhet që kjo të drejtohet vetëm ndaj autorit të sulmit të padrejtë, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e ligjshme të tij apo të një të treti si dhe çka është më e

rëndësishme duhet të jetë në proporcion me sulmin. Si do të zgjidhet atëherë çështja në rastin e kapërcimit të kufijve të mbrojtjes së nevojshme? Mendoj së përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga mbrojtësi duhet të ndahet mes këtij dhe sulmuesit për aq sa është kapërcyer kufiri i mbrojtjes së nevojshme.

Ushtrimi i një të drejtë. Përmbushja e një detyrimi ligjor apo urdhri të një autoriteti kompetent.

Këto janë dy rrethana të tjera në të cilat shkaktimi i një dëmi përjashton përgjegjësinë civile të autorit. Gjithashtu Kodi Penal, neni 21 parashikon se nuk përgjigjet penalisht ai që ka vepruar në këto kushte.

Ushtrimi i një të drejtë.

Për sa i përket kësaj çështjeje mund të thuhet se ai që shkakton një dëm gjatë ushtrimit të një të drejtë subjektive të tij, nuk përgjigjet për dëmin e ardhur. Kështu për shembull, dikush ndërton, brenda të gjitha normave të urbanistikës, një pallat dhe në këtë mënyrë i zë pamjen ndërtimit fqinj, duke ia ulur kështu vlerën këtij të fundit. Në këtë rast nuk mund të flitet për shkaktim të një dëmi të paligjshëm sepse është e drejta e çdo pronari të ndërtojë mbi truallin e tij. Po kështu, pronari i cili pret rrënjët e pemëve që hyjnë në tokën e tij vepron në bazë të së drejtës së tij të ligjshme (neni 155 i Kodit Civil).

Ushtrimi i të drejtave duhet bërë brenda kufijve që cakton ligji, e kundërta do të çonte në ngarkimin me përgjegjësi për shpërblimin e dëmit. Në praktikë kjo nuk mund të jetë kaq e thjeshtë sepse po të shihet mirë shpesh mund të rezultojë së problemi i përgjegjësisë civile nga shkaktimi i dëmit përbën një problem konflikti të drejtash. Nga njëra anë qëndron e drejta për të vepruar e dhënë nga vetë ligji, nga ana tjetër e drejta e secilit për garanci ndaj çdo abuzimi të mundshëm. Gjithë problemi qëndron se si duhen peshuar këto dy të drejta antagoniste në rast kolizionit të tyre.

Disa të drejta lejojnë në vetvete “dëmtimin” e të tjerëve. Kështu e drejta për të ushtruar një aktivitet tregtar në një sistem të nismës së lirë, lejon konkurrencën ndaj një tregtari tjetër, që në njëfarë mënyre e dëmton këtë të fundit. Në këtë rast nuk mund të ndëshkohet tregtari i cili mund të ketë shkaktuar falimentimin e konkurrentit të tij. Nëse kjo do të lejohej nga ligji, do të ndalohej vetë konkurrenca. Po kështu e drejta e kritikës letrare apo artistike lejon të shkruash atë çka mendon për një libër, apo vepër tjetër, të tregosh se cilët janë filmat që duhen apo nuk duhen

parë. Kjo mund të dëmtojë rëndë autorët, por nëse do të ndëshkoheshin kritikët vetëm mbi këtë bazë, do të suprimohej e drejta e kritikës.

Gjithashtu ndodhemi para mungesës së përgjegjësisë civile për dëmin e ardhur, si pasojë e përmbushjes së një detyrimi ligjor apo zbatimit të urdhrit të një autoriteti kompetent. Lidhur me këtë edhe në Kodin Penal, neni 21/1, parashikohet se: *“Nuk ka përgjegjësi penale personi që vepron ...për të përmbushur detyra të caktuara nga ligji ose nga një urdhër i dhënë prej një personi kompetent, veç rastit kur urdhri është haptazi i paligjshëm.”*

Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr. 2236 date 12.7.1999 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 87 date 3.2.2000 ka vendosur, ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe detyrimin e Ministrisë së Financave t'i paguaj shumën 500.000 leke paditësit. Gjykata e lartë, duke krijuar jurisprudencë të qarte në këtë drejtim ka konstatuar:

“Gjykata e apelit, duke ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit, gjykon çështjen në fakt dhe i pranon kërkesën paditësit, duke arsyetuar së paditësi ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit, dhe shuma e kërkuar nga paditësi është e arsyeshme, pasi vërtet nuk ka ndonjë masë për të caktuar shpërblimin e dëmit, por çmon gjykata e apelit, shuma e kërkuar çmohet e drejte. Ky konkluzioni i gjykatës së apelit është i pambështetur në ligj dhe si i tillë duhet të priset.

Paditësi, ashtu siç del nga shqyrtimi i çështjes ka pësuar një dëm jo pasuror, i cili në përgënjeshttrimin që i është bërë nga ana e paditur, duke u botuar në gazeta qendrore dhe lokale është rivendosur dinjiteti i paditësit. Në këtë aspekt vendimi i gjykatës së shkallës së parë është në përputhje me nenin 625 të Kodit Civil”⁸.

Nevoja ekstreme. Nëse do të shkaktohej një dëm në kushtet e nevojës ekstreme, a do të përbënte kjo një rrethanë që do të përjashtonte autorin e dëmit nga detyrimi për dëmshpërblim?

Për këtë Kodi Civil ka parashikuar se: *“Personi që ka shkaktuar dëmin, duke qenë i shtrënguar nga nevoja për të shpëtuar vetën ose të tjerët nga rreziku i atëçastëm i një dëmi të rëndë, rrezik i cili nuk ka qenë shkaktuar dhe as nuk mund të mënjanohej prej tij, detyrohet të shpërblejë dëmin. Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e posaçme të çështjes, mund ta shkarkojë plotësisht ose pjesërisht këtë person nga detyrimi i shpërblimit të dëmit.”.*

⁸ Vendim Nr. 521, datë 29.5.2001 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

Në këtë mënyrë dispozita nuk jep një përgjigje të prerë. Ajo vendos rregullin se një dëm i shkakuar në kushtet e nevojës ekstreme do të shpërblehet nga ai që e ka shkakuar. Ky rregull ka edhe përjashtimin e vet sipas të cilit ekziston mundësia e shkarkimit apo kufizimit të përgjegjësisë dhe kjo është lënë në çmimin e gjykatës, pasi kjo të ketë vlerësuar rrethanat e posaçme të çështjes.

Në mënyrë që të kuptojmë zgjidhjen që ka pranuar legjislacioni ynë, fillimisht le të shohim se çfarë nënkupton nocioni i nevojës ekstreme dhe i dëmit të shkakuar në këtë rast.

Në dallim nga mbrojtja e nevojshme, kuptimin e së cilës e gjejmë në të drejtën penale, Kodi Civil parashikon se kur kemi të bëjmë me një dëm të shkakuar në gjendje të nevojës ekstreme. Sipas nenit 612 të Kodit Civil personi që ka shkakuar dëmin duhet të ketë vepruar me qëllim shmangien e një rreziku të çastit që mund të sjellë një dëm të rëndë për vetën ose të tjerët, por me kusht që ky rrezik të mos jetë shkakuar nga vetë ai dhe që nuk mund të mënjanohet dot me mënyra të tjera. Është e kuptueshme se që të ndodhemi para nevojës ekstreme, dëmi i shkakuar duhet të jetë më i vogël se sa dëmi i cili rrezikonte të vinte.

Përse legjislatori nuk e ka përjashtuar nga përgjegjësia autorin e dëmit në një rast të tillë kur çdo njeri i arsyeshëm do të kishte vepruar në këtë mënyrë? Ndryshe nga rasti i mbrojtjes së nevojshme, dëmi në kushtet e nevojës ekstremë i shkaktohet një të treti, që nuk ka marrë pjesë në krijimin e rrezikut.

Përjashtimi nga përgjegjësia civile do të cenonte interesat e të dëmtuarit pa të drejtë, pasi ai nuk ka asnjë lidhje me faktin që ka sjellë dëmin. Kur personi ka shkakuar një dëm, duke vepruar në mbrojtje të vetës apo të të drejtave të tij, kjo zgjidhje (përgjegjësia e tij) është më se e kuptueshme. Kjo sepse ai ka shmangur një dëm më të madh që i kanosej dhe shpërblimi i dëmit të shkakuar i kushton më pak se sa dëmi që mund t'i vinte.

Nga ana tjetër nuk do të ishte e drejtë nëse dikush do të vepronte për të mbrojtur një person tjetër nga një rrezik i çastit dhe të detyrohej më pas të dëmshpërblente ndonjë dëm të mundshëm, që mund t'i ishte shkakuar një të treti.

Kodi Civil i vitit 1981 parashikonte se gjykata mund t'ia ngarkonte përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit personit të tretë në favor të të cilit kishte vepruar autori i dëmit. Sipas Kodit aktual gjykata nuk mund ta bëjë një gjë të tillë. Megjithatë kjo përbën një rrethanë për ta shkarkuar shkaktuesin e dëmit nga përgjegjësia civile.

Këto ishin rastet kur megjithëse është shkaktuar një dëm, ligji e përjashton autorin nga përgjegjësia për shpërblimin e tij. Kjo sepse nuk plotësohet njëri nga kushtet për lindjen e kësaj përgjegjësie që ishte kundërligjshmëria e dëmit. Le të shohim më poshtë kushtin e tretë të përgjegjësise në rastin e shkakimit të dëmit që është faji.

8. Faji.

Faji si baza e përgjegjësisë civile.

E drejta jonë civile dhe doktrina juridike kanë pranuar si bazë të përgjegjësisë civile fajin e personit përgjegjës për dëmin e shkaktuar. Në këtë mënyrë në rastin e shkaktimit të dëmit, nuk mjafton konstatimi i tre kushteve për të cilat u fol më sipër (dëmi, kundërligjshmëria e tij, lidhja shkakësore).

Për të lindur përgjegjësia civile e autorit të dëmit, duhet që ky të ketë vepruar me faj. Një kusht i tillë i përgjegjësisë parashikohet në Kodin Civil, neni 608/1 si vijon: “ *Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.* ”.

Kodi Civil jo vetëm pranon fajësinë si kusht për përgjegjësinë civile që rrjedh nga shkaktimi i dëmit, por gjithashtu ka vendosur parimin e prezumimit të fajësisë së autorit të dëmit. Sa më sipër del nga neni 608/2: “ *Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj.* ... ”

Duke pranuar këtë parim, i dëmtuari mjafton të provojë dëmin e shkaktuar si rezultat i veprimit të paligjshëm të personit përgjegjës. I mbetet këtij të fundit barra e provës për të vërtetuar së dëmi ka ardhur nga rrethana të cilat ai nuk mund t’i ndalonte, pra që ai nuk ka faj në shkaktimin e dëmit. Si rrjedhim çdokush që ka shkaktuar një dëm do të prezumohet fajtor, përderisa ai nuk provon të kundërtën domethënë që nuk ka faj. Vetëm në këtë rast ai do të përjashtohet nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit.

Në një gjykim civil për shpërblim dëmi, i padituri i ngarkuar me detyrimin për dëmshpërblim, ka apeluar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke paraqitur si një nga shkaqet e ankimit faktin se në gjykimin e shkallës së parë nuk ishte vërtetuar fajësia e tij. Ky pretendim është i gabuar, sepse fajësia e të paditurit prezumohet nga ligji. Barra e provës për të vërtetuar se nuk ka pasur faj, në gjykime të tilla është mbi paditësin.

“Demi biologjik, duke qenë cenim në integritetin fizik dhe/ose psikik të njeriut, është objektivisht i vërtetueshëm. Prandaj, në zbatim të rregullave parimore të neneve 2, 6, 29 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*da mihi factum, dabo tibi ius*), i dëmtuari që kërkon dëmshpërblimin ka barrën e provës të vërtetojë së dëmi ka ndodhur, si dhe lidhjen shkakësore të tij me faktin e paligjshëm.

Përveç kësaj, gjykata kërkon mendimin e specializuar të eksperteve mjeko-ligjore në shërbim të arritjes së përfundimeve përkatëse sipas bindjes se saj të brendshme për vërtetimin ose jo të shkakimit të dëmit biologjik, lidhjes shkakësore juridike të tij me faktin e paligjshëm, si dhe për përcaktimin e llojit dhe shkallës përkatëse të dëmtimit, në përqindje për dëmtimet e përhershme dhe në dite për ato të përkohshme...”⁹.

Kuptimi dhe llojet e fajit në fushën e të drejtës civile.

Kodi Civil parashikon përgjegjësinë e personit që ka shkaktuar dëmin me faj, por nuk e përkufizon kuptimin e fajit si element i anës subjektive të përgjegjësisë. Për këtë, doktrina i është referuar kuptimit që i është dhënë fajit në të drejtën penale.

Faji përfaqëson qëndrimin psikik të autorit të dëmit ndaj veprimit të tij dhe pasojës së ardhur. Ky qëndrim shfaqet në dy aspekte të tij: momentin intelektual dhe momentin volitiv¹⁰. Momenti intelektual ka të bëjë me mundësinë subjektive për të parashikuar ose jo pasojat që mund të vijnë nga një veprim i caktuar. Kurse momenti volitiv lidhet me dashjen ose mosdashjen e këtyre pasojave të parashikuara. Në funksion të këtyre dy momenteve janë përcaktuar edhe format e fajit që janë: 1) dashja dhe 2) pakujdesia.

⁹ Vendim Unifikues Nr.12, datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

¹⁰ “E drejta e detyrimeve dhe e kontratave” Dr. Marjana Semini, Tiranë 1998

Dashja. Vetë dashja si formë e fajit, ndahet në dashje direkte dhe dashje indirekte (eventuale). Kështu themi se një person ka vepruar me dashje direkte kur ai parashikon mundësinë e ardhjes së pasojës së dëmshme, e dëshiron ardhjen e saj dhe vepron me qëllim që kjo pasojë të vijë. Faji në formën e dashjes direkte përbën shkallën më të lartë të fajësisë. Për sa i përket dashjes indirekte, autori i dëmit parashikon ardhjen e pasojës nga veprimi i tij, nuk e dëshiron këtë pasojë, por me vetëdije lejon ardhjen e saj.

Pakujdesia. Pakujdesia si formë e fajit dallon nga dashja dhe shfaqet në dy forma: 1) pakujdesia në formën e vetëbesimit të tepruar dhe 2) pakujdesia në formën e neglizhencës. Kur personi përgjegjës ka parashikuar pasojat që mund të vijnë nga veprimi i tij, nuk i dëshiron ato, madje, duke pasur një besim të tepërt në aftësitë e tij, të mjeteve të cilat përdor apo të të tretët, mendon se mund t'i mënjanojë ato; në këtë rast kemi të bëjmë me pakujdesi në formën e vetëbesimit të tepruar. Ndërsa kur personi nuk i parashikon pasojat që mund të vijnë dhe as nuk i dëshiron ato, por kishte detyrimin objektiv dhe mundësinë subjektive për t'i parashikuar, jemi para pakujdesisë në formën e neglizhencës. Kur personi nuk kishte as detyrimin objektiv dhe as mundësi subjektive të parashikonte pasojat, ai ka vepruar pa faj dhe bëhet fjalë për “dëmin e rastit”, rrethanë kjo që e përjashton personin nga detyrimi për shpërblimin e dëmit, pra nga përgjegjësia civile.

Në rastin e pakujdesisë në formën e neglizhencës, ka lindur problemi lidhur me çështjen e vlerësimit të kujdesit të treguar nga personi përgjegjës, për të parashikuar mundësinë e ardhjes së pasojave të dëmshme.

Doktrina jonë juridike ka pranuar vlerësimin in abstrakto, duke e krahasuar sjelljen e autorit të dëmit më atë të një njeriu normal. Ky qëndrim, duket i drejtë nëse do të pranojmë dhe filozofinë se njeriu është arbitër i vetvetes, dhe si i tillë është i lirë të zgjedhë dhe të veprojë midis së mirës dhe së keqes.

Përgjegjësia pa faj.

Kodi Civil ka vendosur ndër kushtet për lindjen e përgjegjësive civile që rrjedh nga shkaktimi i një dëmi të paligjshëm, fajin e autorit të dëmit. Ky përbën aktualisht dhe bazën e kësaj përgjegjësie.

Parimi i fajësisë qëndron në themel të teorisë tradicionale të shkakimit të dëmit. Në fillimet e saj shpërblimi justifikohet vetëm me qëllimin për ndëshkim të autorit të dëmit, në formën e një dënimi civil. Kështu nëse dikush kishte shkakuar një dëm me faj të tij, do të përgjigjej për shpërblimin e tij sepse ky konsiderohet si ndëshkim dhe frenim për të mos përsëritur në të ardhmen veprime të tilla. Në këtë mënyrë shpërblimi i të dëmtuarit nuk përbente asnjë motiv për ekzistencën e tij. Më pas krahas shpërblimit si sanksion civil filloi t'i kushtohet rëndësi edhe shpërblimit të të dëmtuarit, derisa ky arriti të jetë edhe qëllimi i vetëm i ekzistencës së vetë institutit të shkakimit të dëmit.

Këto ide për bazën e përgjegjësisë civile të lidhur pandashmërisht me fajin e autorit të dëmit, i përkasin shek. XVIII-XIX. Kjo periudhë i takon një shoqërie paraindustriale, në të cilën mjetet e prodhimit kufizoheshin në forcën e krahëve të njeriut, të kafshëve apo të energjisë natyrore si era, uji etj. Në këto kushte gjendja ishte lehtësisht e kontrollueshme nga ana e njeriut. Si rrjedhim edhe përgjegjësia me faj ishte e kuptueshme.

Revolucioni industrial, mundësoi vënien në shërbim të njeriut të energjive me potencial tepër të madh si, energjia termike, kimike, elektrike e atomike. Këto dhe shpejtësitë e mëdha të përftuara prej tyre krijojnë situata të rrezikshme të cilat shumë lehtë mund t'i shpëtojnë kontrollit të njeriut dhe të shkaktojnë dëme të pallogaritshme. Në këtë mënyrë këto aktivitete mbartin gjithmonë rrezikun e ndonjë avarie të mundshme. Sigurisht që teknika ofron bashkë me këto aktivitete edhe shumë masa sigurie, por të cilat shpesh nuk mund të eliminojnë të gjitha rreziqet.

Megjithatë shoqëria nuk mund të heqë dorë nga këto arritje me gjithë ndonjë rrezik të mundshëm që mund të paraqesin ato. Kështu ushtrimi i aktiviteteve të tilla nuk përbën një veprim të paligjshëm. Në këto kushte të flasësh akoma për një përgjegjësi me faj, kjo do të thotë që i dëmtuari të mos shpërblehet dot. Për këtë arsye doktrina ka pranuar gjithnjë e më shumë përgjegjësinë pa faj, ose e thënë ndryshe përgjegjësinë objektive të personit përgjegjës. Në këtë rast mjafton vetëm vërtetimi i lidhjes shkakësore për të lindur përgjegjësia për dëmin e shkakuar¹¹.

Duke qenë se në rrethana të tilla të përmendura më sipër, aktiviteti e përmban rrezikun në vetvete dhe personi që ushtron një aktivitet të tillë nuk mund të përjashtohet nga përgjegjësia as, duke provuar se nuk ka pasur faj në ardhjen e dëmit, ai është i rrezikuar që në çdo moment të mund të

¹¹ Francesco Galgano, E drejta private

lindë për të përgjegjësia për shpërblimin e ndonjë dëmi të ardhur si pasojë e ushtrimit të aktivitetit.

Për këto arsye në fushat ku ekziston më tepër mundësia e një dëmi, ligji ka parashikuar detyrimin e personave që kanë si detyrim të përgjigjen për dëmet e shkaktuara, të bëjnë sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësive së tyre. Përmendim këtu qarkullimin e automjeteve. Të gjithë e dimë se në kohët që jetojmë, me rritjen masive të trafikut nga momenti në moment mund t'i shkaktosh dikujt një dëm edhe sikur të zbatosh të gjitha rregullat e qarkullimit rrugor. Kjo përgjegjësi konsiderohet e tillë, që drejtuesi mjetit do të përgjigjet për dëmet e shkaktuara, pavarësisht nga fajësia e tij. Për këtë arsye është parashikuar sigurimi i detyrueshëm i drejtuesve të mjeteve për përgjegjësinë civile për dëmet e shkaktuara të tretëve. Po kështu, në çdo biletë udhëtimi përfshihet edhe siguracioni i udhëtarëve për dëmet që mund t'u vijnë atyre gjatë udhëtimit.

Për sa i përket rasteve konkrete të përgjegjësive pa faj, sistemi ynë ligjor ka pranuar që me LVJD-në, përgjegjësinë objektive të personit që ushtron një veprimtari e cila përbënte një rrezik për të tjerët. Për sa u përket sistemeve të huaja, ato kanë operuar më së shumti nëpërmjet jurisprudencës dhe interpretimeve prej saj të dispozitave ekzistuese.

Kështu mund të përmendet përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga kafshët apo nga ndërtesat, të cilat megjithëse janë dispozita tepër të hershme, janë interpretuar si raste të përgjegjësive objektive (në Francë dhe në Itali).

Në rregullimet ligjore aktuale, vazhdon ende të mbizotërojë parimi tradicional i përgjegjësive me faj. Gjatë hartimit të Kodit Civil janë futur rishtazi disa dispozita, si edhe janë shtuar raste të reja të përgjegjësive civile. Nëse kemi të bëjmë me raste të përgjegjësive më faj apo të përgjegjësive objektive, mendoj ta trajtoj konkretisht në çdo rast konkret në kapitullin përkatës.

9. Lidhja shkakësore.

Nevoja e konstatimit të lidhjes shkakësore. Për të lindur përgjegjësia civile, nuk mjafton konstatimi i një dëmi dhe kundërligjshmëria e tij. Duhet vendosur gjithashtu ndërmjet tyre një raport shkak-pasojë. Pra, duhet provuar që ky dëm e ka burimin në këtë fakt, domethënë në veprimin e autorit të dëmit. Ky kusht i përgjegjësisë civile është së pari një kërkesë e arsyeshme dhe së dyti është e imponuar nga ligji.

Neni 608 i Kodit Civil detyron çdo person që në mënyrë të paligjshme dhe me faj *shkakton* një dëm, me shpërblimin e tij.

Gjithashtu edhe nene të tjerë 621, 622, 623, 628, 636 përdorin të gjithë foljen *shkakton*. Jo vetëm kaq, por legjislatori, në ndryshim nga rregullimet e mëparshme ligjore, në nenin 609/I të Kodit Civil, ka përcaktuar shprehimisht nevojën e konstatimit të lidhjes shkakësore kur thuhet se: “Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit.”

Evidentimi i lidhjes shkakësore do të ishte relativisht i thjeshtë Nëse dëmi do të kishte lidhje me një shkak të vetëm, lehtësisht të identifikueshëm. Por në shumicën e rasteve një dëm është rezultat i shumë faktorëve, lidhja mes të cilëve është e domosdoshme për ardhjen e pasojës së dëmshme.

Të gjithë këta faktorë shkojnë drejt dëmit final si një zinxhir, një hallkë e të cilit të mungojë, pasoja nuk do të vinte. Atëherë lind pyetja nëse e drejta duhet t’i ketë parasysh të gjithë këta faktorë në përcaktimin e lidhjes shkakësore dhe raportit shkak-pasojë ? Ndoshta përgjigja do të ishte pozitive nëse do të kishte barazi ndërmjet shkaqeve fizike dhe juridike. Por e drejta nuk

mund të marrë në konsideratë çdo shkak që mund të përcaktohet nga një konstatim i thjeshtë, por do të veçojë vetëm ato shkaqe që përbëjnë *shkakun juridik* të dëmit.

Përcaktimi i raportit shkakësor paraqet vështirësi në praktikë, duke përbërë një problem, që teorikisht nuk mund të thuhet se është zgjidhur. Ende ekzistojnë mendime të ndryshme lidhur me këtë çështje. Në fakt është e vërtetë, së për lidhjen shkakësore nuk është dhënë një përkufizim i saktë shkencor, duke ia lënë në këtë mënyrë vlerësimin e saj arsyes, përvojës praktike dhe çmimit të gjykatës.

10. Teoritë kryesore mbi karakteristikat e lidhjes shkakësore.

Në vende të ndryshme të Evropës, studimi i lidhjes shkakësore ka shënuar një nga pikat më të errëta, të cilës ende nuk i është dhënë një përgjigje unike. Në Francë kjo çështje i është lënë më tepër pragmatizmit të jurisprudencës. Janë autorët gjermanë që kanë parashtruar teoritë e tyre e më pas ata të vendeve anglo-saksone. Teoritë lidhur me këtë çështje mund të jenë të shumta, por tre janë sistemet kryesore:

Teoria e ekuivalencës së shkaqeve¹²

Arsyetimi i kësaj teorie është i thjeshtë: çdo fakt në mungesë të të cilit dëmi final nuk do të ishte realizuar, ka të njëjtën vlerë kauzale. Pra, gjithçka që ka paraprirë dëmin ka vlerë ekuivalente. Kjo tezë nuk bën dallimin ndërmjet shkaqeve të ndryshme që kanë çuar deri tek dëmi. Shkaku identifikohet në kushtin *sine qua non*. Për të ditur nëse fakti i përgjigjet këtij kualifikimi, suprimohet nga tërësia e shkaqeve dhe shihet nëse megjithatë dëmi do të vinte. Nëse konstatohet së dëmi nuk do të ishte realizuar, shkaku konsiderohej kauzal.

Nën këtë formë, teoria është e pambrojtur, pa mbështetje. Duhet me çdo mënyrë të eliminohen rrethanat që nuk kanë karakter shkakësor, përderisa ato nuk janë të tilla sa pa to dëmi nuk do të kishte ardhur. Veprimi i një fakti të caktuar, duke u kombinuar me fakte të tjera prodhon fakte të reja e kështu në vazhdim. Gjykata duhet tu japë fund këtyre reaksioneve zinxhir. Nëse nuk do ta

¹² “Manuel Droit Civil” - Pierre Voirin;

bënte këtë, mund të cilësohej si shkak i drejtpërdrejtë ndonjë fakt tepër i largët nga shkakimi i vërtetë, fakt që do të lidhej me pasojën në mënyrë tepër hipotetike. Ky sistem vlerësimi për lidhjen shkakësore mund të ketë ndonjë meritë në një ekonomi paraindustriale, në të cilën ishte më e lehtë të izolohej roli i çdo fakti në shkakimin e dëmit. Zhvillimi dhe mekanizimi i industrisë e bën të pamundur dallimin ndërmjet rolit të forcave mekanike dhe veprimit të individëve të caktuar.

Teoria e shkakut adekuat (i përshtatshëm)¹³

Sipas kësaj teorie nuk do të konsiderohej si shkak i një dëmi, çdo fakt çfarëdo, vetëm nëse ai ka pasur një rol në realizimin e dëmit. Duhet bërë për këtë qëllim një seleksionim ndërmjet këtyre fakteve. Do të merrej parasysh si shkak i drejtpërdrejtë vetëm ai që praktikisht (ka të ngjarë) të mund ta bënte dëmin të mundshëm sipas rrjedhës së zakonshme të gjërave. Do të eliminohen nga lidhja shkakësore faktet që procedojnë dëmin, të cilat nuk do të çonin tek dëmi veçse nën efektin e rrethanave të jashtëzakonshme. Këto nuk janë veçse një rast dhe jo shkak i dëmit. Me një fjalë shkakimi nuk do të jetë adekuat nëse nuk shkakton normalisht pasojat e ardhura.

Megjithëse kjo teori nuk paraqet thjeshtësinë e së parës, duhet thënë se në praktikë përdorimi i saj do të ishte tepër kompleks. Në çdo rast të veçantë duhet të punosh për një rindërtim *post factum* të pararendësve të dëmit për të zgjidhur pasi çdo gjë ka mbaruar, nëse është e mundur që një shkak i caktuar të shfaqet, të paraqitet si shkak esencial. Ajo që ka rëndësi nuk është që pasojat e dëmshme të jenë të parashikueshme, por që shkakimi të jetë i aftë për t'i sjellë ato sipas rrjedhës natyrore të gjërave.

Duke përdorur në mënyrë retrospektive një studim “të arsyeshëm” për përcaktimin e shkakut, rrezikohet të biem në një dyshim, që nuk do përshtatej me të dhënat e shkakut të përshtatshëm. Pra, ekziston rreziku për një parashikim të gabuar e arbitrar. Ajo që duhet pasur parasysh nga kjo teori është se faktet nga të cilat varet realizimi i një dëmi nuk janë juridikisht ekuivalente në vlerë.

¹³ “Manuel Droit Civil” - Pierre Voirin;

Teoria e shkakut më të afërt (causa proxima).¹⁴

Sipas kësaj teorie, nga të gjitha faktet që kanë konkurruar në realizimin e dëmit, do të mbahet parasysh vetëm fakti që kronologjikisht ka qenë i fundit. Kriteri i afërsisë së shkakut, duket shumë i thjeshtë për të qenë i saktë. Përveç se është e thjeshtë, kjo teori, duket edhe e padrejtë. Kjo sepse nuk merr në konsideratë që fakti i fundit mund të jetë një veprim pa faj, por që vetë ky është shkaktuar nga një veprim i fajshëm. Ky veprim i fundit do të mbetet jashtë përgjegjësisë sepse nuk ka qenë i fundit. Si rrjedhim ndërmjet dy veprimeve me faj jo të njëjtë (dashje dhe pakujdesi), do të rrezikohet të ngarkonim të gjithë përgjegjësinë mbi veprimin më pak të fajshëm sepse shkakut më të afërt do të përjashtonte në këtë mënyrë autorin me faj më të rëndë. Kjo gjë do të bëhej me motivin e vetëm se veprimi i tij është më i largët.

Në përfundim, nëse do t'i përmbaheshim kronologjisë së shkaqeve për të përcaktuar shkakun e drejtpërdrejtë, përse të mos e lidhim këtë të fundit me causa remota (shkakut më të largët) ?

Nëse ai ka qenë burimi i parë në zinxhirin e shkaqeve që kanë sjellë dëmin, pse të mos konsiderohet ky shkakut i vërtetë i dëmit? Kjo vërejtje mjafton për të goditur vlerën kauzale të një shkakut të tillë në raport me shkaqet e tjera.

Qëndrimi i doktrinës sonë lidhur me karakteristikat e lidhjes shkakësore.

Për të përcaktuar nëse midis sjelljes së një personi dhe pasojës së dëmshme ekziston lidhja shkakësore, duhen shkëputur faktet nga zinxhiri i fenomeneve të ndryshme. Që të ekzistojë lidhja mes sjelljes së njeriut të shkëputur nga tërësia e fakteve të tjera dhe pasojës së ardhur, kjo sjellje duhet të ketë qenë shkakut determinues për ardhjen e pasojës. Me këtë do të kuptojmë shkakun kryesor e të domosdoshëm pa të cilin nuk do të vinte pasoja.

Për të dalluar nëse një shkak ishte i domosdoshëm apo i rastit do të referoheshim eksperiencës, praktikës. Kështu një fakt i caktuar do të ndodhej në lidhje shkakësore të domosdoshme me pasojën nëse nga praktika dhe eksperiencia është vërtetuar se fakte të tilla sjellin pasojat të tilla¹⁵

¹⁴ “Manuel Droit Civil” - Pierre Voirin

¹⁵ Rustem Gjata - Revista Drejtësia 1972/1

Aktualisht në nenin 609 të Kodit Civil, përcaktohet së dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit të personit. Që dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë I veprimit të personit, kjo duhet kuptuar se midis veprimit dhe pasojës duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore e drejtpërdrejtë dhe kjo është e logjikshme. Por që dëmi të jetë dhe rrjedhojë e menjëhershme e veprimit kjo kërkesë mund të paraqesë vështirësi në disa raste. si për shembull në dëmet e shkaktuara në shëndetin e personit nga ndotjet e ambientit, dëme të cilat nuk shfaqen menjëherë pas ndotjes së shkaktuar.

Për të përcaktuar nëse një dëm është shkaktuar apo jo nga një fakt i caktuar, shpesh lind nevoja e kryerjes së ekspertimit nga persona që mund të zbardhin mekanizmin e shkakimit të dëmit ose, së paku të bëjnë vlerësimin e dëmit.

“Për të arritur në përfundimet e saj gjykata kërkon mendimin e specializuar të eksperteve sipas fushave përkatëse. Nëse caktimi i vlerës së sakte të shpenzimeve për përkujdesje e mjekim rezulton i pamundur apo me kosto të larte, gjykata vendos me bindjen e saj të brendshme, sipas rrethanave të heshtjes..”¹⁶

Konkurrimi i disa shkaqeve në lidhjen shkakësore.

Në një numër të madh rastesh në lidhje shkakësore me dëmin ndodhen shumë shkaqe. Si do të ndikojë ky fakt në të drejtën e të dëmtuarit për dëmshpërblim ? Si do të rregullohen marrëdhëniet ndërmjet personave përgjegjës ?

a.Konkurrimi i veprimit të autorit të dëmit me veprimin e të dëmtuarit.

Ky është një nga rastet kur në ardhjen e dëmit kanë konkurruar disa shkaqe, por e veçanta është se një nga këto shkaqe është veprimi i vetë të dëmtuarit. Cilat do të jenë pasojat lidhur me ndarjen e përgjegjësisë civile dhe me shpërblimin e dëmit ? Përgjigja ndryshon në varësi të faktit se i dëmtuari ka vepruar me ose pa faj. Në rast se i dëmtuari ka vepruar pa faj, atëherë autori i dëmit do të ngarkohet me përgjegjësinë për shpërblimin e të gjithë dëmit. Do të bënte përjashtim kur i dëmtuari do të ngarkohej me përgjegjësi për një nga rastet e përgjegjësisë pa faj. Por në

¹⁶ Vendim Unifikues Nr.12, datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

qoftë se veprimet e të dëmtuarit kanë qenë të fajshme, në këtë rast do të aplikohet e ashtuquajtura *përgjegjësi e përzier*. Në këtë mënyrë masa e shpërblimit të dëmit do të reduktohet në proporcion me kontributin e veprimit të tij në shkaktimin e dëmit.

Lidhur me përgjegjësinë e përzier Kodi Civil, në kapitullin për shkaktimin e dëmit, nuk ka parashikuar një dispozitë të përgjithshme në ndryshim nga i gjithë legjislacioni i mëparshëm përfshirë edhe Kodin Civil të vitit 1928. Vetëm kur flitet për përgjegjësinë që rrjedh nga produktet, në nenin 629 parashikohet përgjegjësia e përzier, kur dëmi është shkaktuar edhe nga i dëmtuari. Në kushtet kur në kapitullin e shkaktimit të dëmit mungon një dispozitë e tillë, do t'i referohemi pjesës së përgjithshme të detyrimeve.¹⁷

Në legjislacionin e mëparshëm civil përcaktohej së përgjegjësia e përzier do të aplikohet vetëm në rastin kur i dëmtuari kishte vepruar me dashje apo pakujdesi të rëndë dhe jo në rastin e pakujdesisë së lehtë. Kjo e fundit e përjashtonte të dëmtuarin nga përgjegjësia dhe i ngarkonte autorit të dëmit detyrimin për shpërblimin total të tij. Aktualisht Kodi Civil nuk bën ndonjë dallim të formës së fajit të të dëmtuarit. Në këtë mënyrë rëndohet pozita e të dëmtuarit, i cili do të shohë të ulur masën e shpërblimit të dëmit edhe për një pakujdesi të lehtë të tij.

b. Konkurrimi i veprimit të të paditurit me veprimin e një të treti.

Rasti i dytë kur shkaqet e dëmit kanë qenë më tepër se një, është ai në të cilin dëmi ka ardhur si pasojë e veprimit të dy a më shumë personave të cilët mund të quhen bashkautorë. Bëhet fjalë për personin e paditur në gjykatë nga i dëmtuari dhe për një të tretë që ka kontribuar në ardhjen e dëmit.

Si duhet zgjidhur në këtë rast shpërblimi i dëmit për të dëmtuarin ? Kodi Civil, neni 626 parashikon se: *“Kur dëmi është shkaktuar nga shumë persona së bashku, këta përgjigjen ndaj të dëmtuarit solidarisht”*. Ekzistenca e përgjegjësive solidarë nuk kërkon ndonjë marrëveshje paraprake midis personave përgjegjës, por vetëm që veprimet e secilit të jenë në lidhje shkakësore me dëmin e ardhur. Në këtë mënyrë, secili nga personat përgjegjës të të njëjtit dëm

¹⁷ Neni 493 i Kodit Civil: *“Kur dëmi i ardhur nga mosekzekutimi i detyrimit është shkaktuar ose është shtuar edhe nga veprimet ose mosveprimet me faj të kreditorit, ose kur ky nuk ka treguar kujdesin e duhur për pakësimin e këtij dëmi, gjykata sipas rastit mund të pakësojë shumën e shpërblimit të dëmit ose të shkarkojë krejtësisht debitorin nga detyrimi për shpërblimin e tij.”*

detyrohet ta shpërblejë atë në total, pa pasur parasysh kontributin e çdonjërit prej tyre në dëmin e shkaktuar. Këtë qëndrim ka mbajtur që herët edhe praktika gjyqësore¹⁸.

Ndarja e përgjegjësisë për bashkautorët përfaqëson vetëm raportet dhe marrëdhëniet reciproke ndërmjet tyre. Kjo nuk ka të bëjë me detyrimin e secilit ndaj palës së dëmtuar. Solidariteti në përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit është një solidaritet ligjor. Kjo zgjidhje e ligjit është në favor të të dëmtuarit, i cili ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e plotë të dëmit nga secili prej autorëve të tij. Kështu i dëmtuari shmang riskun e mospagimit të detyrimit si rezultat i insolvabilitetit të ndonjërit prej personave përgjegjës. Janë këta të fundit që ngarkohen me një risk të tillë.

Për të ilustruar këtë të drejtë të të dëmtuarit po paraqes një rast nga praktika gjyqësore, në të cilën paditësit kanë kërkuar nga i padituri, shpërblim dëmi në bazë të nenit 623 të Kodit Civil.

Gjatë gjykimit në shkallë të parë, gjykata ka konstatuar se së bashku me të paditurin duhej të mbanin përgjegjësi solidarë edhe persona të tjerë, të cilët ajo (gjykata) i ka thirrur si të paditur, duke i ngarkuar në përfundim të gjykimit sipas kontributit përkatës në shkaktimin e dëmit.

Paditësit kanë apeluar vendimin e shkallës së parë, duke pretenduar mes të tjerave se: Gjykata ka zbatuar gabim ligjin, duke përcaktuar personat që do të mbajnë përgjegjësi për dëmin sepse në kemi paditur vetëm X. Gjithashtu gjykata ka gabuar, duke pranuar përgjegjësinë solidarë dhe, duke e ndarë detyrimin proporcionalisht midis gjithë të paditurve pasi kështu dëmton rëndë interesat tona.

Gjykata e Apelit ka konstatuar së përgjegjës i vetëm për shkaktimin e dëmit është i padituri fillestar, kurse të paditurit e tjerë nuk kanë përgjegjësi. Por Gjykata e Apelit nuk është shprehur lidhur me veprimin me iniciativë të gjykatës së shkallës së parë për thirrjen e të paditurve solidarë në përgjegjësinë për shkaktimin e dëmit. Gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar drejt, duke thirrur të paditurit të cilët i ka konsideruar si përgjegjës solidarë. I takon paditësit të zgjedhë në një rast të tillë nëse do të padisë njërin apo të gjithë debitorët solidarë. Në rastin konkret pavarësisht se gjykata ka menduar së përgjegjës për dëmin e shkaktuar kanë qenë edhe persona të tjerë, ajo nuk mund t'i thërriste në gjykim pa pëlqimin e paditësve.

¹⁸ Vendim i Gjykatës së Lartë, Nr.113, datë 31.12.1957. Vendim i Gjykatës së Lartë, datë 16.05.1975.

Në përfundim të gjykimit do të detyrohej personi i paditur me shërbimin e plotë të dëmit, duke ruajtur të drejtën e kthimit ndaj personave përgjegjës solidarë me të. Nëse çështja do të zgjidhej në këtë mënyrë, paditësi nuk do të mendonte se konstatimi i përgjegjësisë solidarë ishte në disfavor të tij, përkundërti kjo është një mundësi më tepër për të siguruar shpërblimin e plotë të dëmit, pavarësisht nga ndonjë insolvabilitet i mundshëm i njërit prej debitorëve.

Padia e kthimit. Le të supozojmë se një nga debitorët solidarë (in solidium), ka paguar të gjithë shpërblimin apo një pjesë më të madhe se ajo, që në fund të fundit detyrohet të paguajë. Në ç'mënyrë do të rregullohen raportet ndërmjet debitorëve solidarë ? Kodi Civil, neni 627/1 parashikon se: *“Personi që ka shpërblyer dëmin ka të drejtë të kërkojë nga secili shkaktar i dëmit pjesën e tij në përpjesëtim me shkallën e fajësisë të secilit dhe të tërësisë së pasojave të rrjedhura. Kur kjo nuk mund të përcaktohet, prezumohet se shkalla e fajësisë është e barabartë.”* Kjo dispozitë parashikon të drejtën e kthimit për debitorin që ka paguar detyrimin. Pra, një padi kthimi kundër debitorëve të tjerë, do t'i bëjë të mundur atij të marrë përfundimisht atë çfarë ka dhënë tepër.

Me ngritjen e kësaj padie lind problemi i kontributit të çdo debitori në shkaktimin e dëmit. Si do të zgjidhet pra çështja se sa do të paguajë njëri dhe sa tjetri në masën e shpërblimit ? Kodi Civil, në dispozitën e sipërcituar ka pranuar si kriter për vlerësimin e detyrimit të secilit debitor solidar, *“shkallën e fajësisë së secilit dhe të tërësisë së pasojave të rrjedhura”*.

Kur kjo gjë nuk është e mundur të përcaktohet, do të prezumohet barazia në pjesë të detyrimit. Personalisht mendoj se do të ishte më e drejtë që si kriter vlerësimi për detyrimin e çdo debitori solidar, të ishte shkalla e pjesëmarrjes së secilit në lidhjen shkakësore dhe në këtë mënyrë edhe në ardhjen e pasojës së dëmshme.

Pasi kemi konsumuar teorinë e përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit të shëndetit, mund të vazhdojmë me shpërblimin e këtij dëmi.

11.

12. Shpërblimi i dëmit i krahasuar me doktrinën perëndimore (France, Itali)

Shembujt e përdorur nuk e vështirësojnë kuptimin e këtij instituti përkundërti, duke gjetur përgjigjet e parashtruara për zgjidhje do të kufizojmë në maksimum gabimet në praktike.

Zhvillimi i teorisë dhe praktikës që ka pasur për objekt konceptin e dëmit kundër shëndetit, që sikurse e përmendëm gjen rregullim në nenin 625/1 të Kodit Civil, rrjedhë e drejtpërdrejtë e rregullimit kushtetues, ende nuk është unifikuar plotësisht në ligj.

Sidoqoftë është në diskutim një kontradiktë pikëpamjesh dhe mundësish, të cilën në duhet ta shpërfillim dhe të pranojmë ekzistencën e të dy mënyrave të shpërblimit të dëmit të shëndetit, kjo, duke i qëndruar opinionit që dëmtimi i shëndetit, pranohet më së fundi që shfaqet në forma të ndryshme të dëmit, pasuror dhe jo pasuror.

Shpërblimi në natyrë ose rivendosja e të dëmtuarit në gjendjen e mëparshme (*status quo ante*) apo *shpërblimi ekuivalent* që konsiston në pagimin e një shumë të hollash në favor të të dëmtuarit, e përberë nga humbja dhe fitimi i munguar, janë mundësitë kryesore që lejohen në shpërblimin e dëmit, të zbatueshme nga natyra e dëmit dhe mundësitë për riparimin e zhdëmtimin e tij.

Shumë shkurt duhet përmendur **zhvillimi i këtij instituti në të drejtën tonë**, duke e krahasuar me legjislacionin italian dhe atë francez.

Ne vitin 1929 doli Kodi i Ri Civil i shtetit shqiptar. Hartimi i tij u bë në frymën e të drejtës civile franceze dhe italiane. Në nenin 1160 të Kodit Civil të Zogut, përcaktohet mënyra e shpërblimit të dëmit, duke njohur si të riparueshëm dëmin material dhe moral. Në mënyrë të posaçme Kodi parashikon shpërblimin e dëmit në rastin e shkakimit të vdekjes, plagosjes, në

rast cenimi të nderit e dinjitetit të personit apo familjes së tij, në rastin e dhunimit të personit apo banesës si dhe në rastin e cenimit të jetës private

Ligji nr. 2359, datë 15. 11. 1956 “Mbi Veprimet Juridike dhe mbi Detyrimet” rregulloi marrëdhëniet e detyrimeve deri në vitin 1981. U pranua si i riparueshëm **vetëm dëmi pasuror**, duke u mohuar kategorikisht shpërblimi me para i dëmit moral.

Kodi Civil i mëvonshëm, ai i vitit 1981, e errësoi me tepër situatën, me ndryshime dhe kufizime më të dallueshme në kuptimin e përgjegjësisë dhe hapësirën ku pranohej përgjegjësia materiale, ndërsa vazhdonte të linte jashtë trajtimit juridik dëmin moral.

Kodi civil në fuqi ka parashikuar në mënyrë të shprehur rastet se kur një dëm moral mund të jetë i shpërblyeshëm. Megjithatë kjo nuk prezumon se gjithmonë, kur pretendohet shkaktimi i një dëmi moral, passjell detyrimin për shpërblimin e tij. Që të ekzistojë përgjegjësia civile për personin që ka shkakuar një dëm moral, kërkohet ekzistenca e një prej rasteve të parashikuara në nenin 625 të Kodit Civil.

Duke deduktuar nga parimet e përgjegjësisë civile për dëmin jo pasuror, dispozitat e ligjit civil dhe ligjeve të tjera materiale, dallojmë brenda bashkësisë së dëmit jo pasuror:

Dëmi moral në formën e cenimit të nderit

- *Dëmtimi i shëndetit* ose shkaktimi i një dëmi i cili cenon integritetin fizik të një personi, shpërblimi i të cilit, në jurisprudencën e huaj, përkufizohet me termin *Pretium doloris* (çmimi i dhimbjes), që nuk është gjë tjetër veç shpërblim i dhënë si pasojë e vuajtjeve fizike,

- *Dëmi ndaj kënaqësive të ofruara nga jeta* ose privimin nga gëzimi i kënaqësive të ekzistencës,

- *Dëmi estetik* - Në këto raste dëmi duhet shpërblyer në kuadrin e një dëmi pasuror ose si dëm moral, ose të dyja së bashku.

- *Dëmi në sferën afektive* (*pretium affectionis*) ose vuajtja e provokuar nga vdekja e një të afërmi. Ky dëm ngre një problem të ndryshëm nga dëmet e tjera morale. Në fakt nuk është viktima direkt e aksidentit që kërkon shpërblimin e dëmit moral, por të tretet, të afërmit. Një dëm i tillë nuk mund të shpërblehet sipas legjislacionit tonë ashtu siç u tha edhe më sipër. E drejta për

shpërblimin e dëmit moral ekziston vetëm në rastin e dëmtimit të shëndetit dhe i takon vetëm personit të dëmtuar.

- *Fyerja e kujtimit të një të vdekuri* - Në këtë rast e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit i takon bashkëshortit me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes ose të afërmeve të të vdekurit deri në shkallë të dytë. Këta persona nuk mund të kërkojnë shpërblimin e këtij dëmi në rast se i vdekuri ka qenë gjallë kur është shkaktuar fyerja dhe i është njohur e drejta e shpërblimit të dëmit moral. Kjo e drejtë nuk mund të trashëgohet nga trashëgimtarët e të vdekurit.

- *Cenimi i jetës private dhe i korrespondencës*, cenimi i të drejtave morale të autorit, cenimi i të drejtave jopasuror familjare e të tjera. Këto dëme morale janë të shpërblyeshme vetëm në se ligjet e veçanta që parashikojnë të drejtat jopasurore përkatëse, parashikojnë edhe një shpërblim në rast shkaktimi të dëmit si rezultat i cenimit të këtyre të drejtave.

Jemi të detyruar ta vazhdojmë debatin tonë, në lidhje me çështjen në bisedim, me dëmtimin më të rëndësishëm kundër shëndetit, vdekjes së personit ose me **Shpërblimin e dëmit në rastin e shkakimit të vdekjes**.

Sipas rregullimit tonë ligjor, në rastin e shkakimit të vdekjes, në dallim me atë të dëmtimit të shëndetit, personi i cili mund të kërkojë shpërblimin e dëmit është subjekt tjetër. Lidhur me këtë neni 643 i Kodit Civil, parashikon se:

“Kur është shkaktuar vdekja e një personi, dëmi që duhet të shpërblejë përbëhet nga:

a) shpenzimet për ushqim e jetesë të fëmijëve të tij të mitur, të bashkëshortes dhe prindërve të paaftë për punë që kanë qenë në ngarkim të të vdekurit, plotësisht ose pjesërisht, si dhe të personave që banonin në familjen e të vdekurit dhe që gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit;

b) shpenzimet e duhura për varrimin e të vdekurit, në masën që ato i përgjigjen rrethanave personale e familjare të të vdekurit.

Personi që ka shkaktuar dëmin mund të kundër-drejtojë të njëjtat mjete mbrojtëse që do t'i kundër-drejtonte të vdekurit.

Gjykata, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, mund të vendose që shpërblimi të jepet në natyrë, ose në para, njëherësh ose me këste.”

Në dallim nga shkaktimi i një dëmi në shëndetin e një personi, me rastin e shkakimit të vdekjes, personat e dëmtuar nuk kanë të drejtë të kërkojnë krahas shpërblimit të dëmit pasuror dhe shpërblim për dëmin jopasuror ata si rrjedhojë e humbjes së njeriut të afërt. Në këtë mënyrë, ligji e lidh ngushtë të drejtën për shpërblim me të dëmtuarin kryesor.

Ligji ynë është ende shumë larg përcaktimit të plotë dhe llogaritjes së dëmit të shkaktuar me vdekjen e personit, duke lënë të pambuluar shpërblimin e të mbijetuarve, shpërblimin e shqetësimit të shkaktuar nga humbja e prindit, nga mungesa e tij në edukimin dhe mirërritjen e fëmijës ose thjesht nga mungesa e të gëzuarit të një njeriu të dashur.

Kodi Civil i vitit 1929, parashikonte shprehimisht të drejtën për shpërblimin e dëmit të shkaktuar si rrjedhim i vuajtjes nga vdekja e një njeriu të afërm. Madje kjo e drejtë përfshinte në rrethin e personave të dëmtuar si gjininë, ashtu edhe krushqinë e afërt, duke përfshirë një numër jo të vogël personash (neni 1160 i Kodit Civil).

Për të mos vështirësuar komunikimin, nuk po përmend rastin kur vdekja nuk është e menjëhershme, që do të thotë viktimi e ardhshme behet subjekt, ndonëse i perkohshëm, i të drejtës së shpërblimit të dëmit, që më vonë transferohet “jure hereditatis” tek trashëgimtarët ligjorë.

Në këtë rast do të ndodheshim para disa pengesave të vështira për tu kapërcyer, qoftë dhe teorikisht. Më e rëndësishmja prej tyre, fakti që e drejta e shpërblimit të dëmit jo pasuror, duke qenë e natyrës personale dhe jo pasurore, nuk mund të transferohet “jure hereditatis” dhe për këtë shkak nuk mund të ushtrohet nga trashëgimtarët.

Por me kryesorja është dhënia e përgjigjes për pyetjen, a mund të konsiderohet objekt i temës tonë dhunimi i të drejtës së jetës si dëmin kundër shëndetit?

Sipas opinionit tim përderisa në pranojmë dëmtimin e personit, të barabartë me dëmtimin e shëndetit, të shpërblyeshëm sipas kriterëve të përcaktuara në ligj, kundërligjshmëria që çon në vdekjen e personit duhet të trajtohet së pari, si dëmtim kundër shëndetit dhe pastaj të verifikohen edhe rrjedhojat e dëmit jo pasuror të vdekjes.

Në Kodin Civil Francez dëmi, përgjegjësia nga shkaktimi i dëmit dhe ajo e dëmit kundër shëndetit në veçanti, është e organizuar pak a shumë si në Kodin Civil tonin, duke i dhënë prioritet shpërblimit të dëmit

Janë parimet e Kodit të Napolonit që rregullojnë përcaktimin e dëmit si dhe elemente dhe rrethana të tjera që duhet të verifikohen dhe të mbahen parasysh nga gjyqtari përpara shpalljes së vendimit; që në vijimin konsiderohen si modalitete të llogaritjes së dëmit kundër shëndetit.

Pavarësisht së kriteret e përcaktuara në Kodin Civil Francez kanë qenë objekt i vazhdueshëm kritikash, ato kanë qenë objekt reformash të vazhdueshme.

Neni 1382 i Kodit Civil që rregullon riparimin e dëmit të shkaktuar nga një vepër penale ose kundërvajtje, bazohet në një nocion më të gjerë të dëmit, duke përfshirë edhe dëmtimin kundër një interesi legjitim. “Fjala dëmtim duhet të përfaqësojë një kuptim shumë të gjerë. Dhe aplikohet kur interferon tek një e drejtë. Nuk ka dëm pa pasur një lëndim, pa shkelje të së drejtës (ligjit) apo të një interesi.”¹⁹

Dëmtimi i një interesi çfarëdo nuk është i mjaftueshëm sepse duhet të trajtohet si një interes i denjë për t’u mbrojtur nga ligji.²⁰ Në të drejtën franceze konsiderohet gjithashtu dëm edhe humbja e një mundësie nga shkaqe të pavarura dhe për rrjedhojë, të paligjshmërisë. Në këtë të drejtë nuk bëhet dallim midis dëmit material dhe dëmit moral.

Sipas opinionit të përgjithshëm në bazë të nenit 1382 të Kodit Civil mund të kërkohet riparimi tërësisht i dëmit, material dhe jo material. Dëmtimi i integritetit fizik të trupit të njeriut është konsideruar si dëm, në kuptimin juridik të termit, dhe në rastin e mungesës së dëmit ekonomik.

Shumica e autoreve francez kërkon mbi të gjitha të heq kufizimet midis dëmit pasuror dhe dëmit moral. Le Roy e Béraud pohojnë që duhet të eliminohet shprehja aktuale e "préjudice matériel" sepse ky term shkakton konfuzion në lidhje me trajtimin e mirëfilltë të dëmit material; për rrjedhojë mund të bëhet ndarja, ose të preferohet të cilësohet dëm pasuror ose ekonomik. Kjo është e qarte kur diskutohet me terma më të afërt, si "préjudice extra-patrimonial" në vend të "préjudice moral".

"Préjudice fonctionnel d'agrément" që i korrespondon dëmit biologjik është përcaktuar nga Gjykata e Parisit si "ulje e kënaqësive të jetës, të shkaktuara sidomos nga pamundësia ose

¹⁹ Cass. Crim., 02.12.1997: "Le mot dommage doit être entendu dans un sens très général. Il s'applique quant il y a atteinte à un droit....Mais il y a aussi dommage lorsqu'il y a lésion, non pas d'un droit proprement dit, mais d'un intérêt...".

²⁰ Cass. Crim., 02.12.1997: "un intérêt digne d'être pris en considération par la loi"

vështirësi për të marr pjesë në aktivitete të caktuara të pranueshme”²¹, ndërsa Gjykata e Kasacionit ka pohuar që "Humbja e kënaqësive përfshin jo vetëm paaftësinë për t'u angazhuar në një aktivitet zbavitje apo sportiv, por edhe privimi nga kënaqësitë normale të jetës”.²²

Në këtë praktike dallohen llojet e dëmtimeve kundër shëndetit, "préjudice sexuel" (në lidhje me funksionin riprodhues) ; le "souffrances physiques ou morales" (dhimbjet fizike dhe morale) ; il "préjudice esthétique" (dëmi i pamjes estetike); il "préjudice juvénile" (pamundësia e të miturit që në të ardhmen të ushtroje një profesion që kërkon integritet fizik dhe moral) e, infine, il "préjudice d'affection" (dëmi moral për humbjen e të afërmit).

E drejta e fqinjëve tanë, ajo italiane, i ka dhënë kuptim të ngjashëm, thuajse të njëjtë përkufizimit të dëmit jo pasuror apo, në terma të përgjithshme popullore, dëmit moral. E drejta italiane, në nenet 2043 e vijues të Kodit Civil, ka rregulluar përkufizimet dhe përgjegjësinë për dëmin jopasuror.

Nën-ndarjet kryesore të dëmit jo pasuror në të drejtën italiane i përkasin dëmit biologjik dhe dëmit moral.

Dëmi biologjik përbën ngjarjen e faktit që sjell pasojat tek shëndeti i personit, ndërsa dëmi moral subjektiv dhe dëmi pasuror gjithashtu, i përkasin kategorisë së pasojës së dëmit në kuptimin e ngushtë.

Dëmtimi i integritetit psikofizik i të dëmtuarit, që transformon në patologji vet integritetin fiziologjik (të pa krahasueshëm me shqetësimin psikologjik të dëmit moral subjektiv të çastit), përbën ngjarjen brenda faktit të paligjshëm, të lidhur me përbërësin e brendshëm të faktit, sjelljen, nga një lidhje shkakësore, si dhe me përbërës të jashtëm, dëmi moral subjektiv (apo dëm pasuror) rrjedhë e ndryshimit të marrëdhënies shkakësore materiale.

²¹ Cass. Crim., 02.12.1997: "...diminution des plaisirs de la vie, causée notamment par l'impossibilité ou la difficulté de se livrer à certaines activités normales d'agrément"

²² Cass. Crim., 26.05.1992: "...le préjudice d'agrément s'entend non seulement de l'impossibilité de se livrer à une activité ludique ou sportive, mais encore de la privation des agréments normaux de l'existence"

Në kuptimin e gjerë, dhe ngjarja e dëmtimit të integritetit psiko-fizik të subjektit të fyer është rrjedhim, por kjo përkundrajt sjelljes, ndërkohë që, njëkohësisht është shkak i pasojave, të të gjithë faktit të paligjshëm, pasoja subjektive morale apo pasurore, që verifikohen nga kjo paligjshmëri.²³

Dëmi moral subjektiv, që vërtetohet në shqetësimin e përkohshëm psikologjik të subjektit të fyer, është dëmtim-pasojë, në vet përbërjen e faktit të paligjshëm që ka dëmtuar shëndetin dhe përbën, kur pranohet ekzistenca, një nga kushtet për shpërblimin e tij; ndërsa dëmi biologjik është ngjarja, brenda faktit të kundërligjshëm që drejtohet kundër shëndetit, dhe domosdoshmërisht duhet të ekzistojë dhe të provohet, pavarësisht pranisë së pasojave të jashtme të gjithë faktit (moral apo pasuror) i përfshirë, në ngjarjen e dëmtimit të integritetit psiko-fizik të subjektit të fyer.²⁴

Në kuptimin popullor dëmi biologjik është thjesht dëmtimi i shëndetit, i karakterizuar si dëm jo pasuror. Jurisprudenca ka njohur, që çfarëdo lloj dëmi ndaj shëndetit shkakton dhe një dëm në kuptim të pengesës së marrëdhënies normale të jetës, që rrjedhimisht rezulton të përkasin subjektit të dëmtuar. Ky është, në thelb, koncepti i dëmit biologjik, për të cilin mundësia e shpërblimit është pranuar.

Nocioni i dëmit biologjik takohet në një tërësi marrëdhëniesh të caktuara juridike dhe natyrale, shfaqet në forma të ndryshme dhe të panumërta, disa prej të cilave do të jenë objekt i vëmendjes së posaçme gjatë këtij studimi.

Duke qëndruar, përkohësisht tek e drejta italiane, mund të përcjellim praninë e dëmit biologjik në marrëdhëniet e punës.

Në marrëdhëniet e punës, dallohet që neni 2087 i Kodit Civil Italian, i imponon punëdhënësit detyrimin të tutëlojë integritetin fizik dhe psikik të punëmarrësit. Me fjalë të tjera, punëdhënësi nuk duhet të mjaftohet vetëm me respektimin e standardeve, kundër aksidenteve që dispijlojnë punën në vende të rrezikshme, duke përshkruar mjete specifike të parandalimit dhe mbrojtjes. Punëdhënësi duhet të parandalojë dëmet, midis të tjerave, ndaj shëndetit, duke marrë të gjitha masat dhe, duke përdorur të gjithë mjetet që janë në dispozicion nga gjendja aktuale e shkencës dhe teknologjisë, edhe pse nuk mbulohen shprehimisht nga masat kundër aksidenteve.

²³ Gjykata e Kasacionit Itali. Vendimi civil Nr.2883/1988

²⁴ Gjykata e Kasacionit Itali. Vendimi civil Nr.2883/1988

Figura e dëmit biologjik është zhvilluar gjatë viteve nga praktika gjyqësore dhe është shoqëruar me figurat e tjera të dëmit, përfshi edhe dëmin moral. Dëmi pasuror verifikohet në momentin në të cilin prek fushën pasurore të subjektit të dëmtuar në kuptim të dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë shpërblimin e dëmit pasuror.

Ndërsa dëmi moral ekziston të gjitha herët në të cilat nuk ka një dëm pasuror, por megjithatë është e parashikuar dhe në dispozita të posaçme, ndonjëherë edhe me karakteristika penale, në Kodin Civil dhe në ligje të tjera materiale të cilat rregullojnë marrëdhënie të caktuara.

Dëmi biologjik apo dëmi ndaj shëndetit mbahet në konsideratë dhe në mungesën totale të një dëmi pasuror, apo të një vepre penale. Kjo është shprehje e të drejtës për shëndetin dhe, si një e drejtë e pacenueshme me rëndësi kushtetuese, gjithmonë kompensohet në momentin në të cilën ajo është e dëmtuar. Rëndësia e saj dallohet sidomos, kur dëmi drejtohet ndaj integritetit psikofizik të një individi.

Jurisprudenca ka identifikuar karakteristikat thelbësore të figurës së dëmit biologjik “... Në dëmtimin e integritetit psikofizik të personit të konsideruar në vetvete, si aksident në vlerat e njeriut në të gjithë dimensionin e tij konkret, që nuk përfundon në aftësinë për të prodhuar pasuri, por që lidhet me shumën e funksioneve natyrale të lidhura me subjektin, në ambientin në të cilën shprehet jeta, dhe me rëndësi jo vetëm ekonomike, por edhe biologjike, sociale, kulturore dhe estetike..”²⁵

Identifikimi i përmbajtjes së dëmit biologjik dhe diferenca konsekuente nga dëmi moral apo pasuror, është shprehur shumë mirë nga Gjykata e Kasacionit të Italisë, si dhe nga Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr.184 të vitit 1986.

Sidoqoftë, ka qenë Gjykata Kushtetuese italiane, që në një rast ka deklaruar mospërputhshmëri midis dy përcaktimeve të dëmit, në vijim Gjykata e Kasacionit²⁶ ka shprehur konceptin sipas të cilit: “...dëmi biologjik, si dëmtim i integritetit psiko-fizik të personit, përbën një dëm të padrejtë me natyrë pasurore, sepse prek një vlerë themelore, që është pjesë përbërëse e atij kompleksi të të mirave ekskluzive dhe që drejtpërdrejtë i përkasin të dëmtuarit...”.

²⁵ Gjykata e Kasacionit Itali. Vendimi civil Nr.90/7101, Gjykata e Kasacionit Itali. Vendimi civil Nr.88/5033 (Seksioni i punës)

²⁶ Gjykata e Kasacionit Itali. Vendimi civil Nr.1130/1985

Dëmtimi i shëndetit, i konsideruar si dëm biologjik duhet të shpërblehet në çdo rast që verifikohet dëmi ndaj personit, ndërsa dëmi moral dhe ai pasuror për humbje të aftësisë së punës dhe të të ardhurave, do të shpërblehen vetëm në se, në rastin e dëmit moral, dëmi rrjedh nga një veprim i paligjshëm, që ka karakter penal, ndërsa për të dytin kur vërtetohet pakësimi i pasurisë.

Figura e dëmit ndaj shëndetit individualizohet kështu si një figurë më vetë, duke qëndruar si “tertium genus”²⁷ e dëmit.

Dëmtimi që prodhon dëmi ndaj shëndetit, referohet në qëndrimet jo fitimprurëse dhe shërbimet e kryera nga subjekti (të veshurit, kujdesi ndaj vetës, të ecësh, të drejtosh mjete të ndryshme, pjesëmarrja në aktivitetin shoqëror të përditshëm etj.) të konsideruara objekt i dëmtuar, pasoja, të cilat, ndalojnë ose e bëjnë të vështirë, duke u konsideruar si pasoja negative në çdo fushë dhe që i drejtohen personalitetit të njeriut. Dëmtimi i shëndetit është provë e vetë ekzistencës së dëmit.

“E mira e shëndetit përbën, si e tillë, objekt të pavarësisë së një të drejtë parësore absolute. Për rrjedhojë, shpërblimi që duhet për dëmtimin e saj, nuk mund të kufizohet vetëm në pasojat që ndikojnë në përshtatshmërinë e prodhimit të të ardhurave, por duhet pavarësisht të përfshijë të ashtuquajturin dëm biologjik, në të cilin janë ri-përfshirë ato forma të dëmit jo ndikues në aftësinë për të prodhuar të ardhura, të kuptuara si dëmtim i integritetit psiko-fizik të personit në vetvete. Këto forma të dëmit, të konsideruara, si dëmtuese në vlerën e njeriut në të gjithë dimensionin e tij, nuk mbarojnë në qëllimin dhe objektivin e vetëm për të krijuar pasuri, por lidhen, drejtohen edhe kundër funksioneve natyrale, që i përkasin subjektit në ambientin e tij të jetesës, me rëndësi jo vetëm ekonomike, por edhe biologjike, sociale, kulturore dhe estetike.”²⁸

Gjatë viteve, nga praktika gjyqësore, rrjedhojë e një doktrine jo gjithmonë koherente, në këtë kategori të dëmit ndaj shëndetit, janë futur tipologji të ndryshme të dëmit, duke filluar nga dëmtimet që i përkasin marrëdhënieve të jetës, të kuptuara si dëme që ndikojnë negativisht në aktivitetet sociale dhe rikrijuese ²⁹, për të vazhduar në dëmet në sferën seksuale, të cilat vërehen në dëmtimin e funksionimit autonom të subjektit. Ky lloj dëmtimi ka të ngjarë të modifikojë kushtet psikofizike të subjektit në gjendjen aktuale psikofizike, dhe, duke ndikuar kështu në

²⁷ Figurë e tretë

²⁸ Gjykata e Kasacionit Itali. Vendimi civil Nr.7101/1990

²⁹ Gjykata e Kasacionit Itali. Vendimi civil Nr.9170/1994

fushën personale³⁰ dhe, jo së fundi, dëmtimet estetike, si dëmtime të funksioneve natyrale të njeriut në dimensionin e tij.³¹

Ashtu sikurse u analizua dhe tipologjia e dëmit jo pasuror, në të drejtën franceze, e gjej me vlera të ndalojë në të njëjtin synim dhe në njohjen e interpretimeve nga e drejta italiane.

Së pari, duke dashur të përmbledh atë që jurisprudenca ka dashur të tregojë si karakteristika të dëmit biologjik, kur ai verifikohet në kundërligjshmërinë e rrethanave të caktuara, do të mjaftohem në tiparet më të mundshme dhe më të pranishme të ekzistencës të një dëmi biologjik, që sigurisht nuk kanë karakter shterues.

Rrjedhojë e këtij synimi, do të përmendja si karakteristika kryesore:

Dëmtime të cilat pasjellin modifikim të pamjes së jashtme, që i përkasin tipareve morfologjike të personit;

Ulje e efikasitetit psikofizik, pamundësi e përdorimit të plotë të funksioneve trupore,

Ulje e aftësive shoqëruese, d.m.th e mundësive të zakonshme të personit për t'u afirmuar në shoqërinë njerëzore, nëpërmjet jetës së tij në marrëdhënie me të tjerët;

Reduktim i aftësisë së përgjithshme për të punuar,

Humbje e shanseve për punë apo dëmtime të cilat ndikojnë në lirinë e zgjedhjes së llojit të punës;

Lodhje më e madhe në kryerjen e punës, e shkaktuar nga ndikimi i dëmtimit;

Përdorim i fuqisë punëtore rezervë, kur nuk e bën të nevojshëm pensionin e parakohshëm,

Le të rikthehem në analizën e tipologjive të dëmit jo pasuror, duke i kushtuar vëmendje së pari dëmtimit psikik.

³⁰ Gjykata e Kasacionit Itali. Vendimi civil Nr.6536/1990

³¹ Gjykata e Kasacionit Itali. Vendimi civil Nr.411/1990

Kjo figurë e dëmit, akoma në rrugën e përcaktimit, nga arritjet e doktrinës dhe të jurisprudencës, diferencohet nga dëmi thjesht fizik, objekt i mundshëm i zhdëmtimit për dëmtimin biologjik, nga momenti që ai nuk ka një shfaqje të jashtme të prekshme, por është vetëm një shfaqje e karakterit të sjelljes.

Dëmtimi fizik lë gjithmonë një gjurmë të prekshme, ndërsa dëmtimi psikik ka shfaqje të karakterit nervor dhe psikik, që jo gjithmonë kanë ndikime të dukshme në trupin e subjektit. Do të duhej në këtë rast një analizë e tipologjive të ndryshme, ndaj subjektit të prekur nga patologjia e karakterit psikik, me qëllimin për t'u siguruar se në cilën masë manifestime të tilla të sjelljes përbëjnë dëmtim në kuptimin teknik-juridik të shprehjes, ose me fjalë të tjera, në kuptimin e saj mjeko ligjor. Pas kësaj mund t'i kthehemi dëmit psikik dhe veprës së paligjshme.

Kryesisht duhet të merret në konsideratë faktori pasojë, ndikimi që një dëm i tillë bën ndaj jetës së subjektit të dëmtuar.

Dëmtimi psikik konsiston në reduktimin, e përkohshëm apo të përhershëm, të një apo me shumë funksioneve psikike të personit, e cila, duke ndikuar në vlerat e njeriut në kuptimin tërësor, pengon të dëmtuarin të përballojë tërësisht apo pjesërisht aktivitetet e zakonshme të jetës.

Në rastet e dëmit psikik e rëndësishme dhe e vështirë njëkohësisht ngelet identifikimi i lidhjes shkakësore, që duhet të jetë gjithmonë e pranishme në marrëdhënien shkak-pasojë, midis dëmit psikik të shkakuar dhe veprimit të kundërligjshëm. Jurisprudenca është marrë në mënyrë sporadike me çështjet që i përkasin dëmit psikik, për të arritur së fundmi në vlerësime më të qëndrueshme.

Në të drejtën italiane janë të zhvilluara kriteret e vlerësimit të dëmit jo pasuror në tërësi dhe, të dëmeve biologjik e moral në veçanti, duke u udhëhequr nga parimi që barra e provës, për kompensimin e dëmit ndaj personit, është mbi paditësin.

Duke qenë se jo gjithmonë dëmi ndaj shëndetit gjendet në shoqërim me dëmin pasuror, por meqenëse jemi gjithsesi në praninë e dëmit, del e nevojshme të gjenden kriteret e ekuilibruara, të përgjithshme dhe gjithmonë të aplikueshme, për të mundur të përcaktohet në terma ekonomik masa e shpërblimit për dëmin e pësuar.

Duke qenë se dëmi biologjik identifikohet me ngjarjen e shkaktimit të dëmit dhe kategorizohet si dëm-ngjarje, për të konsideruar të provuar ekzistencën e dëmit biologjik është e mjaftueshme, përfundon me provueshmërinë e faktit të shkaktimit të dëmit.

Për sa i përket provës, ajo duhet të bazohet mbi një ekzaminim mjeko-ligjor, me anën e të cilit duhet të përcaktohet shkalla e aftësisë së subjektit dhe ç'ka është kufizuar tek subjekti i dëmtuar.

Duke qenë se në të shumtën e rasteve dëmtimi cilësohet nga mjeku në terma të përqindjes se invaliditetit (invaliditet në kuptimin e paaftësisë psikofizike për të kryer aktivitetet e jetës së përditshme), shumë gjykata kanë përpunuar një tabelë, që, duke llogaritur shkallen e invaliditetit dhe të moshës së individit, arrihet në një shifër, që mund të konsiderohet si bazë e nisjes, për të llogaritur masën e dëmshpërblimit.

Tabela të tilla, që janë hartuar nga Gjykata e Milanos dhe janë përkrahur rast pas rasti dhe në Gjykata e Kasacionit, akoma nuk përcaktojnë në mënyrë përfundimtare masën e dëmit (në vlerë) ekonomike, për subjektin që ka pësuar një dëm biologjik, por mund të konsiderohen, në një masë të mirë, një kriter mjaft i saktë.

Dëmi jo pasuror i shpërblyeshëm duhet të jetë rrjedhojë e menjëhershme dhe e drejtpërdrejtë e veprës së paligjshme dhe në të njëjtën kohë, kompensimi i dëmit moral i takon dhe të afërmeve të të dëmtuarit nga vepra e paligjshme që përbën krim, vetëm kur behet fjalë për ngjarje vdekjeprurëse dhe jo për dëmtime të thjeshta personale.

E ndryshme është problematika që i përket dëmtimit ndaj shëndetit.

Në fakt, sipas opinionit unanim të doktrinës, dëmtimi ndaj shëndetit drejtohet kundër raporteve të vendosura nga ligji, për të mbrojtur personin fizik jo vetëm në drejtim të integritetit fizik, por edhe të personalitetit të tij moral. Objektivi i këtyre normave është që të mbrohet dhe të respektohet "personi", jo vetëm në kuptimin fizik, por edhe në kuptimin më gjerësisht etik dhe moral, për të garantuar të drejtat e veta personale. Rezulton ndërkohë, të kuptohet si jurisprudenca ka lejuar hyrjen, në fushën civile, të konceptit të dëmit biologjik.

Dëmi biologjik nuk dallohet vetëm në qëllimin e cenimit të prodhimit të të ardhurave, pra në qëllimin ekonomik, por është i lidhur me kompleksin e funksioneve natyrale, që i përkasin personit në ambientin në të cilin jeton dhe zhvillon personalitetin e vet moral, intelektual, kulturor dhe social.

Dëmi biologjik është përcaktuar si një dëmtim i integritetit fizik dhe i aspektit psikik, të shfaqur jo vetëm në marrëdhëniet shoqërore, por edhe në vlerat, në kuptimin e gjerë, të lidhura me jetën. Prandaj, edhe antologjikisht është i ndryshëm, si nga i ashtuquajtimi dëm moral, ashtu dhe nga dëmi i shprehur në të ardhurat e munguara, për shkak të humbjes apo uljes së aftësisë për punë.

Në veçanti, në praktikën e cituar më lartë, Gjykata Kushtetuese dallon qartësisht dëmin moral që do të ishte i shpërblyeshëm vetëm në rastet e përcaktuara në ligj, nga dëmi biologjik, duke u kuptuar i pari si “i përkohshëm, që priset të jetë rastësor, shqetësim psikologjik, i lidhur me vuajtjen fizike dhe dhimbjen morale”³², ndërsa i dyti do të identifikohet “në hipotezën në të cilën vuajtja fizike-morale të përcaktojë në vetvete, ndryshime të psikikës, të tilla që të ndikojnë negativisht në qëndrimin e subjektit, për të marrë pjesë normalisht në aktivitete, në situata dhe në marrëdhënie, në të cilat personi paraqet vetën e vet në jetë”³³.

Gjykata Kushtetuese thekson që dëmi biologjik dhe moral nuk përkojnë, pasi i pari riparohet vështirësisht personale dhe sociale, ndërsa i dyti riparohet vuajtjen e përkohshme, si pasojë e dëmtimit të rrjedhur nga veprimi i kundërligjshëm.

Duke hequr dorë përkohësisht nga doktrina dhe e drejta italiane, nënvizoj që dëmi biologjik përbën një “tertium genus”, midis dëmit pasuror dhe dëmit moral, gjithmonë i pranishëm si i tillë, në çdo rast të dëmtimeve të verifikuara, pavarësisht të kompensueshme apo jo.

Për plotësim duhet të kujtoj që qëllimi i bazës ligjore të dëmit biologjik ka qenë burim i paqartësive të mëdha në doktrinën juridike. Në vija të përgjithshme, një bazë e tillë, është identifikuar në përgjegjësinë jashtëkontraktore,

Një bazë e tillë, megjithatë, është e diskutueshme në dëmin që shkaktohet nga dhe gjatë marrëdhënieve të punës, të cilat e përfshijnë shpesh herë atë si një të drejtë kontraktore, por që klasifikohet njëkohësisht dhe si e drejtë që rrjedh nga përgjegjësia për shkaktimin e dëmit biologjik.

³² Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Italisë, Nr.184 të vitit 1986.

³³ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Italisë, Nr.184 të vitit 1986

13. Lloje të dëmit kundër shëndetit, nën dritën e praktikës gjyqësore.

Në vijim unë do të kufizohem vetëm me shpërblimin e dëmit të shkaktuar shëndetit në format kryesore të tij: *dëmi material* (i shëndetit) dhe *jo material* (*dëmi moral*)

Ndërsa në rastin e dëmit material shpërblimi është i thjeshtë për tu përcaktuar, pasi përbëhet nga shpenzimet mjekësore që i janë dashur të bëjë subjektit të dëmtuar, për shkak të dëmtimit të shëndetit dhe çdo shpenzim tjetër, që ka lidhje me dëmin e shkaktuar, për sa i përket dëmit jopasuror të shkaktuar, si pasojë e dëmtimit të shëndetit apo dëmit moral, ligji nuk përcakton mënyrën dhe kriteret e shpërblimit.

Opinionimi im është që gjykatat duhet të udhëhiqen nga parimi i barazisë i përdorur shpesh edhe nga Gjykata e të Drejtave të Njeriut, duke caktuar një shpërblim të arsyeshëm në proporcion edhe me rëndësinë e dëmtimit. Megjithatë unë mendoj që vështirësia më e madhe është në konstatimin dhe përcaktimin e këtij dëmi, sesa në caktimin e shpërblimit.

Në vazhdim, objektivi i punimit do të jetë edhe mishërimi dhe zbatimi në praktikë, i doktrinës dhe i ligjit, duke krahasuar jurisprudencën bashkëkohore evropiane, me atë të trashëguar dhe të re të veprimtarisë tonë gjyqësore. Nga këto vlerësime do të lindin orientime drejt perspektivave të njohjes dhe të zbatimit në praktikë të përgjegjësisë civile, për shkaktimin e dëmit jo pasuror.

Duke u rikthyer edhe një herë, në mënyrë më të detajuar në lidhje me kuptimin e dëmit moral, vërejmë se ajo çka kuptohet me termin dëm moral, ka të bëjë me dëmet që nuk përmbajnë në vetvete një humbje ekonomike, një pakësim të pasurisë. Dëmi moral ka qenë objekt debati për sa i takon pranimit apo jo të shpërblimit të tij.

Kundërshtimi kryesor ka të bëjë me atë çka përfaqëson vetë natyra extrapatrimoniale e këtij dëmi. Kështu, si të kuptohet shpërblimi në të holla për shembull i cenimit të nderit të një personi? Opinioni më i përhapur është që pagesa në të holla, për shpërblimin e cenimit të nderit, nuk e bën të paqenë cenimin e këtij nderi.

Përveç papërshtatshmërisë për shpërblimin në të holla, dyshohet që mungon karakteri i sigurtë i dëmit. Kjo pasiguri në verifikimin e cenimit të nderit të dikujt, buron nga ndryshueshmëria e temperamentit dhe e përjetimeve të një veprimi të kundërligjshëm me objektiv cenimin e nderit, nga individë të caktuar.

Megjithatë është teza e kundërt që ka triumfuar në të drejtën dhe jurisprudencën bashkëkohore, duke pranuar se shpërblimi në të holla, nuk mund të riparojë atë çka është e riparueshme (kthimin e nderit të cenuar), por shpërblimi ka në këtë rast një karakter kompensues. Pra, ai nuk është riparues, por plotësues, ngushëllues.

Në favor të kësaj ideje mund të shtohet se ndoshta është më mirë një shpërblim jo i përshtatshëm, sesa asnjë lloj shpërblimi. Dhënia e një shpërblimi për dëmin moral shërben jo vetëm për respektimin e rregullave natyrale të sjelljes, por edhe si element i ndëshkimit privat (civil), i njohur si institut i të drejtës romake.

Dallohet që Kodi Civil i ka parashikuar në mënyrë të shprehur rastet se kur një dëm moral mund të jetë i shpërblyeshëm.

Kjo do të thotë se, jo gjithmonë kur pretendohet shkaktimi i një dëmi moral, ky do të pasjellë detyrimin për shpërblimin e tij. Për të qenë e pranishme përgjegjësia civile, për personin që ka shkaktuar një dëm moral, duhet të jetë e parashikuar në një nga rastet e Kodit Civil, përkatësisht në nenin 625 të Kodit Civil. Megjithatë, përtej rasteve të nenit 625 të Kodit Civil, lindja e përgjegjësive civile për shpërblimin e një dëmi moral, takohet edhe në ligje të tjera material, kësaj herë e shprehur në mënyrë të posaçme.

Duket me vend të ndalemi, jo shkurtimisht, në shfaqje të ndryshme të dëmeve morale dhe mundësive për të kërkuar shpërblimin e tyre, duke mos ngurruar edhe në ballafaqime rastësore me praktikën gjyqësore.

- **Cenimi i nderit** - Legjislatori e ka konsideruar shkaktimin e një dëmi moral në formën e cenimit të nderit, si një rast ku i dëmtuari mund të kërkojë shpërblimin e këtij dëmi.

Shkaktimi i një dëmi të tillë nuk ka rëndësi se si dhe në çfarë mënyre është realizuar. Mjafton vetëm fakti që i dëmtuari të jetë cenuar në ndjenjën e nderit të personalitetit të tij, nga veprimet me faj të personit përgjegjës.

Zakonisht mund të ndodhë që shkaktimi i një dëmi të tillë civil të përbëjë edhe vepër penale, si shpifja, fyerja, kallëzimi i rremë e të tjera vepra që mund të cenojnë nderin e një personi. Megjithatë dhënia e një shpërblimi civil për dëmin e shkaktuar nuk varet gjithmonë nga rezultatet e procesit penal.

Kështu që të kemi përgjegjësi penale për fyerje, shpifje apo kallëzim të rremë duhet të plotësohen një sërë elementësh të veprës penale. Nëse mungon njëri prej tyre autori nuk ngarkohet me përgjegjësi penale. Megjithatë një person mund të jetë cenuar në nderin e tij edhe pa ekzistencën e një vepre penale. Kështu për të kualifikuar si fyerje një veprim të caktuar, kërkohet pa tjetër qëllimi i autorit si element i domosdoshëm i anës subjektive të veprës penale. Po kështu mund të thuhet edhe për shpifjen.

Por qëllimi nuk është i domosdoshëm për shkaktimin dhe kërkimin e një dëmi civil. Mjafton që autori i dëmit të ketë vepruar edhe me pakujdesi, si dhe të provohet se i dëmtuari është cenuar realisht në nderin e tij, që të detyrohet të shpërblejë dëmin moral të shkaktuar. Mungesa e një elementi të veprës penale, nuk çon automatikisht në përjashtimin edhe nga përgjegjësia civile të autorit të dëmit.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në një nga praktikat e tij ka dalluar se: “ Me vendim penal të formës së prerë shtetasi xx është dënuar për shpifje në dëm të paditëses, por ndryshe nga sa arsyeton gjykata kjo nuk do të thotë se sipas nenit 625 të Kodit Civil ai ka përgjegjësi solidare me anën e paditur.

Veprimet e tij nuk kanë asnjë lidhje me ato të anës së paditur si kanal televiziv, dhe është e drejta e saj të pretendojë edhe ndaj tij konform dispozitave ligjore, por derisa kërkimet janë

përqendruar kundër kanalit televiziv “.....” edhe gjykimi duhet të kufizohet brenda këtij objekti të padisë”.³⁴

Gjykata duhet të hetojë rast pas rasti nëse kërkesa e një personi, i cili pretendon t’i jetë shkaktuar një dëm në bazë të nenit 625/a të Kodit Civil, është reale apo jo. Një veprim i caktuar në rrethana të caktuara mund të cenojë nderin e një personi të caktuar. Kjo varet shumë nga karakteristikat individuale të çdo personi. Edhe nëse konstatohet se është cenuar nderi i të dëmtuarit, gjykata duhet të hetojë rrethanat e shkaktimit të dëmit për të përcaktuar masën e shpërblimit. Kështu një dëm i tillë i shoqëruar me karakterin publik të tij, do të konsiderohej më i rëndë se sa një cenim i nderit, i bërë në një rreth më të ngushtë dhe jo në publik.

Praktika jonë në këtë aspekt është në fillimet e saj dhe ende nuk është krijuar një mendim i njëjtë i jurisprudencës mbi kriteret në të cilat gjykatat duhet të bazohen për verifikimin e ekzistencës së dëmit dhe, për vlerësimin dëmit moral.

Praktika e evokuar më poshtë dallon qartë elementë të kërkuar të dëmit moral.

“...Kolegji Civil i Gjykatës së lartë vëren se rasti në shqyrtim duhet të konsiderohet shkaktim dëmi moral (jo pasuror) ndaj nderit dhe personalitetit të paditësve dhe ky dëm duhet të shpërblehet nga pala e paditur. Botimi i fotografisë së paditësve në grup, duke interpretuar me veglat e tyre muzikore, ku dallohen qarte fytyrat e tyre që janë të njohura për publikun e gjere dhe nen titullin sensacional “Durrës, kapet banda e rreme e muzikanteve”, përbën një veprim të kundërligjshëm, si element i domosdoshëm i përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit.

Gjithashtu, ekziston edhe fajësia si element i domosdoshëm i kësaj përgjegjësie. Është e vërtetë që nuk është pranuar e provuar dashja dhe qëllimi i posaçme për të cenuar nderin dhe personalitetin e paditësve, por ndërkohë provohet pakujdesia e rende e palës së paditur. Ajo para se të vendoste fotografinë e paditësve nen titullin dukshëm diskreditues për ta, ishte e detyruar të bënte verifikimet e duhura për të saktësuar se kujt i përkiste ajo fotografi. Në gjykim pala e paditur nuk ka dhënë shpjegime për të sqaruar dhe justifikuar veprimin e saj, d.m.th. pse për ilustrim të ngjarjes së ndodhur, arrestimit të një grupi kriminal, është përdorur fotografia e paditësve, gjersa ata nuk kishin asnjë lidhje me këtë ngjarje kriminale.

³⁴ Vendim Nr.1986, datë 25.11.2004 i Kolegjit Civil – Gjykata e Lartë

I takonte barra e provës palës së paditur për të provuar mungesën e fajësisë, gjë që nuk ka mundur ta beje. Referuar neneve 608 dhe 625/a të Kodit Civil, për të pasur përgjegjësi për shpërblimin e dëmit, mjafton që veprimi i kundërligjshëm të kryhet me faj, si në formën e dashjes, ashtu edhe në formën e pakujdesisë. Përmbajtja e artikullit (mos përmendja e emrave të paditësve) ka krijuar bindje tek gjykatat që pala e paditur nuk ka vepruar me dashje dhe nuk ka pasur si qëllim të posaçme për të prekur nderin dhe personalitetin e paditësve, megjithatë nuk kishte asnjë arsye dhe justifikim vendosja e fotografisë se tyre nën titullin sensacional e diskreditues dhe për ilustrim të një ngjarjeje kriminale. Nëse përjashtohet dashja për të diskretitur paditëset, pakujdesia e rende e treguar, si element i anës subjektive të dëmit jo pasuror, ka bërë që ata të ndjehen të prekur në nderin dhe personalitetin e tyre përpara një publiku të gjere që i respekton dhe i nderon si artiste të shquar.

Është e vërtetë që pas ngritjes së padisë pala e paditur ka bërë përgënjeshttrimin dhe ka kërkuar ndjese, por ky veprim i saj nuk e shkarkon nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit moral. Për me tepër, kjo nuk mund të shërbeje edhe si justifikim për të pakësuar në mënyrë të ndjeshme masën e dëmshpërblimit, sepse përgënjeshtrimi dhe kërkimi i ndjesës është bërë me shume vonese dhe pas depozitimit të padisë në gjykatë”.³⁵

Në vendimin e gjykatës arsyetohet lidhur me faktin së paditësit janë cenuar realisht në nderin e tyre, duke u pranuar si element i fajësisë pakujdesia e rende e të paditurit. Gjykata ka dalluar ekzistencën e dëmit moral si dhe mundësinë e shpërblimit të tij, në vlerë ekonomike.

Megjithatë, baza e fundit doktrinarë dhe e jurisprudencës, e vendosur në lidhje me vlerësimin e dëmit moral është vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

“Shuma e dëmshpërblimit për dëmin moral, për shkak të natyrës subjektive dhe të brendshme të tij, nuk mund të llogaritet mbi tabela dhe skema të parallogaritura vetëm për këtë qëllim. Prandaj, gjykata e cakton atë mbështetur në parimin e dhënies se drejtësisë sipas bindjes se saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre, duke u mbështetur edhe në kritere eventuale normative të zbatueshme sipas natyrës se të drejtës se

³⁵ Vendim Nr.1230, datë 02.11.2006 i Kolegjit Civil – Gjykata e Lartë.

cenuar ose, në mungese të tyre, në kritere dhe elemente vlerësimi të konsoliduar nga praktika gjyqësore në zgjidhjen e çështjeve analoge ose në përvoja përkatëse jashtëgjyqësore, duke pasur gjithnjë parasysh zhvillimin aktual ekonomik e social të vendit, përfshirë vlerën e parasë në ekonominë kombëtare“³⁶.

Kjo praktikë e thjeshtëzuar ka vendosur kriteret bazë për vlerësimin e dëmit moral, të shkaktuar nga cenimi i nderit të personit.

³⁶ Vendim Unifikues Nr.12, datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë,

14. Dëmtimi i shëndetit.

Dëmtimi i shëndetit konstatohet në rastin e shkakimit të një dëmi, i cili cenon integritetin fizik të një personi.

Si rrjedhim i këtij dëmi mund të shkaktohen dëme pasurore dhe jopasurore, apo morale. Dëmet pasurore kanë të bëjnë me uljen e aftësisë për punë të personit të dëmtuar, të shpenzimeve mjekësore e të tjera.

Lidhur me dëmin moral, neni 625/a i Kodit Civil parashikon se: *“Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur: a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit...”*.

Nga dispozita e mësipërme kuptohet se shpërblimi i dëmit moral mund të kërkohet vetëm nga personi i dëmtuar dhe, jo nga të afërmit e tij. Gjithashtu, duket që kërkimi i shpërblimit të dëmit, mund të bëhet vetëm në rast dëmtimi të shëndetit dhe jo në rast të shkakimit të vdekjes.

Në vijim do të dallojmë, se si është trajtuar shpërblimi i dëmtimit të shëndetit, nga doktrina dhe jurisprudenca e huaj.

Pretium doloris³⁷ Është fjala për shpërblimin e dhënë, si pasojë e vuajtjeve fizike rrjedhim i aksidentit apo dhimbjen në kuptimin mjekësor të fjalës. Këto vuajtje, shpesh të patolerueshme dhe ku më shumë e ku më pak të zgjatura në kohë, justifikojnë kërkimin e një shpërblimi të quajtur *pretium doloris* (çmimi i dhimbjes). Sigurisht që shuma e dhënë si shpërblim nuk e zbeh aspak dhimbjen, vuajtjen, megjithatë kjo shumë të hollash do t'i lejonte të dëmtuarit të gjente sadopak ngushëllim me ndonjë argëtim kompensues.

Shpërblimi *pretium doloris* përveç vuajtjeve fizike duhej të shpërblente dhe vuajtjen shpirtërore, kjo nisur nga parimi i shpërblimit të plotë të dëmit.

Dëmi ndaj kënaqësive të ofruara nga jeta³⁸ përbën privimin nga gëzimi i kënaqësive të ekzistencës, rritjes së standardit të jetës. Kështu mund të konsiderohet i tillë: pamundësia e ushtrimit të profesionit burim kënaqësie private dhe profesionale, privimi nga funksionimi normal i organeve trupore etj. Për të pranuar shpërblimin e dëmit në këto raste nuk është e nevojshme të jetë ndërprerë një veprimtari specifike për personin e dëmtuar.

Dëmi estetik³⁹ Një person është shpërfytyruar, apo ka pësuar deformime, gjymtime ose cikatrice të ndryshme në fytyrë ose në trup, si pasojë e cenimit të integritetit të tij fizik. Shpesh dëmtimi estetik ka ndikim në aftësitë e të dëmtuarit për të fituar të holla, duke pasur parasysh se estetika luan rol parësor në disa profesione, për një aktore ose një stjuardesë për shembull.

Dëmi në sferën afektive (*pretium affectionis*) - Ky dëm ekziston nëse bëhet fjalë, për shembull për vuajtjen e provokuar nga vdekja e një të afërmi dhe ngre një problem të ndryshëm nga dëmet e tjera morale.

Në fakt, në kuptimin e dëmit moral, i dëmtuar nuk është viktima direkte e aksidentit, dhe për rrjedhojë, nuk është ai që mund të kërkojë shpërblimin e dëmit moral, por të tretët, të afërmit.

³⁷ Droit Civil, La responsabilite civil et obligations,

³⁸ Droit Civil, La responsabilite civil et obligations,

³⁹ Droit Civil, La responsabilite civil et obligations,

Shpërblimi i një dëmi të tillë nuk parashikohet drejtpërdrejte nga ligji, duke qenë së e drejta për shpërblimin e dëmit moral ekziston vetëm në rastin e dëmtimit të shëndetit dhe i takon vetëm personit të dëmtuar, shpërblimi i dëmit në rast të mungesës së një të afërmi, është rregulluar nga praktika gjyqësore, e cila i ka bërë interpretim të zgjeruar dispozitës materiale.

“Prezumohet se vdekja e të ndjerëve nga fakti i paligjshëm (aksidenti), në moshe të re e të mitur, sjell si pasojë shuarjen e marrëdhënieve prindërore dhe të gjinisë me paditësit e të afërmit familjare të tyre, si rrjedhojë, edhe cenimin e interesave të ligjshme jopasurore që lidhen me personalitetin e pas-jetuesve, si cilësia e jetës, paprekshmëria e familjes, solidariteti reciprok, dhimbja e vuajtja shpirtërore e tyre, etj...”⁴⁰

Dëmtimi i shëndetit shfaqet me karakteristika të shumanshme, dhe për rrjedhojë takohet edhe në raste kur përgjegjësia është në lidhje me dëme pasurore dhe jo pasurore të shkaktuara. Kolegjet e bashkuara të gjykatës së Lartë kanë rrëzuar tabunë e krijuar, se vdekja e të afërmit, nuk shfaqet edhe me karakteristikat e dëmit jo pasuror.

“Gjykata pranon se humbja e jetës së fëmijës është ngjarje e rende dhe mjaft e dhimbshme që rëndon gjendjen shpirtërore të të afërmeve të tyre.

Por, sipas nenit 18 të Dekretit Nr.295, datë 15.09.1992 dëmshpërblehet vetëm “vdekja, dëmtimi i shëndetit dhe dëmet pasurore ...”, në se janë pësuar nga vetë viktimat a të dëmtuarit e përfshirë në një aksident automobilistik. Madje, në zbatim të dispozitave të këtij dekreti, në mënyrë taksative, dëmshpërblehen vetëm dëmet pasurore, ku gjykata përfshin edhe dëmtimin e shëndetit dhe përjashtohen dëmet jopasurore, sipas nenit 625 të Kodit Civil.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se ky qëndrim vjen në kundërshtim me normat dhe frymën e Kushtetutës, qëllimin dhe përmbajtjen e dispozitave të Kodit Civil dhe atyre të legjislacionit të posaçme, për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë së mbajtësve të mjeteve motorike ndaj personave të tretë.

Edhe në praktikën gjyqësore, në zbatimin e dispozitave të lartpërmendura, konstatohen qëndrime të ndryshme dhe konfuze mbi kuptimin e format e dëmit jopasuror, rrethin e subjekteve që kanë

⁴⁰ Vendim Unifikues Nr.12, datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë,

legjitimim aktiv, kriteret e pranueshmërisë dhe të caktimit të masës së dëmshpërblimit, me tendencë kufizimin e fushës së zbatimit të tyre.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë të nevojshme mbajtjen e një qëndrim të unifikuar rreth këtyre çështjeve.

Dispozita e nenit 625 të Kodit Civil interpretohet e zbatohet në pajtim dhe harmoni me parimet themelore kushtetuese mbi të drejtat e njeriut, duke mbajtur parasysh dhe reflektuar në gjykim edhe vetë procesin dinamik të ndërgjegjësimit e të emancipimit të shtetit e të shoqërisë në njohjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Sikurse është trajtuar me sipër në këtë vendim, sipas neneve 3, 15 e vijues të Kushtetutës, parashikohet mbrojtje *e posaçme dhe e barabarte* e të mirave pasurore dhe atyre jopasurore të njeriut. Në këtë kuptim, edhe neni 608 e vijues i Kodit Civil synojnë riparimin e plote të *çdo dëmi* të pësuar në mënyrë të paligjshme, pra jo vetëm në pasurinë në kuptimin e ngushte ekonomik, por edhe në të mirat jopasurore që mëshirojnë *vlerat e vetë njeriut*.⁴¹

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arritur në përfundimin unifikues, të detyrueshëm për zbatim nga gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë, se:

“Dëmi jopasuror, i parashikuar në nenin 625 të Kodit Civil, si një kategori e gjere dhe gjithëpërfshirëse e dëmeve jashtëkontraktore, përfshin çdo lloj dëmi të pësuar nga cenimi i të drejtave dhe interesave jopasurore, që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut dhe që, nuk janë subjekt vlerësimi të drejtpërdrejtë ekonomik në treg.

Në thelbin e saj, kjo dispozite njeh të drejtën e dëmshpërblimit për çdo lloj dëmi jopasuror jashtëkontraktor, i cili është “*i ndryshëm nga ai pasuror*”. Rënditja e “rasteve” të dëmit jopasuror në paragrafët “a” dhe “b” të saj, nuk ka për qëllim të kufizojë, por të rregullojë në mënyrë të shprehur, për efekte të dallueshmërisë së cenimeve, të drejtën e dëmshpërblimit përkatës dhe rrethin e subjekteve që gëzojnë legjitimim aktiv.”⁴²

⁴¹ Vendim Unifikues Nr.12, datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

⁴² Vendim Unifikues Nr.12, datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

Fyerja e kujtimit të një të vdekuri

Shpërblimi i dëmit moral mund të kërkohet edhe kur nga veprimet e personit përgjegjës është shkaktuar fyerja e një personi tashmë të vdekur (neni 625/b i Kodit Civil).

Në këtë rast e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit i takon bashkëshortit me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes ose të afërmeve të të vdekurit deri në shkallë të dytë. Këta persona nuk mund të kërkojnë shpërblimin e këtij dëmi në rast se i vdekuri ka qenë gjallë kur është shkaktuar fyerja dhe i është njohur e drejta e shpërblimit të dëmit moral. Kjo e drejtë nuk mund të trashëgohet nga trashëgimtarët e të vdekurit.

“Ne këtë kuptim, dispozita e nenit 625 të Kodit Civil bën dallimin ndërmjet dy grupeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që nuk kanë natyrë pasurore të mbrojtura prej saj në rast cenimi: “dëmtimi i shëndetit” (e drejta absolute për shëndetin, në kuptimin biologjik) dhe cenimi i “personalitetit” (tërësia e të drejtave absolute të personalitetit). Nisur nga natyra specifike e të drejtave që mbrohen, në paragrafin “a” dhe “b” të nenit 625, ligjvënësi ka parashikuar dy raste të posaçme të dëmit jopasuror në personalitetin e njeriut: “cenimi i nderit” dhe “fyerja e kujtimit të një të vdekuri”.

Sipas doktrinës dhe praktikës, dëmtimi i shëndetit është figure autonome e dëmit jopasuror, e ndryshme nga dëmi pasuror për “humbjen dhe pakësimin e aftësisë për punë” (neni 641 i Kodit Civil). Ndërsa në grupimin e dytë përfshihen dy figura të dëmit jopasuror, autonome nga njeri tjetri, dëmi moral dhe dëmi ekzistencial...”⁴³

Përveç dëmeve morale të përmendura, dhe të parashikuara në Kodin Civil si të shpërblyeshme, ekzistojnë edhe dëme të tjera morale si: cenimi i jetës private dhe i korrespondencës, cenimi i të drejtave morale të autorit, cenimi i të drejtave jopasurore familjare e të tjera.

Këto dëme morale shpërblehen atëherë kur ligjet e veçanta parashikojnë të drejtat jopasurore përkatëse, si dhe shpërblimin në rast shkaktimi të dëmit si rezultat i cenimit të këtyre të drejtave.

⁴³ Vendim Unifikues Nr.12, datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë,

Aktualisht, forma më e përhapur e përgjegjësisë civile të dëmit jo pasuror, po ndeshet në fushën lirive dhe të të drejtave të njeriut. Për shkak të aktualitetit dhe të rëndësisë së saj, të vështirësive që ndeshen thuhet për çdo rast, meriton trajtim të veçantë. Në shpalljen e opinionëve një mbështetje e sigurtë është dhe praktika dhe doktrina e krijuar nga GjEDNJ.

Zhvillimet me interesante të kësaj forme të përgjegjësisë dallohen kur kundërligjshmëria që shërben si shkak i shkakimit të dëmit, konsumohet nga persona të veshur me pushtet, apo të mbrojtur nga neni 10 i Konventës.

Liria e shprehjes, e tejkaluar nga subjekte të veshur me pushtet, përbën një nga format e cenimit të personalitetit, për rrjedhojë dhe të shkakimit të dëmit jopasurore (moral).

Fjala e mbajtur në parlament

Fjala e mbajtur në parlament, nga një deputet, në interpretim të nenit 73/1 të Kushtetutës, vlerësohet se deputeti, nuk mund të procedohet penalisht për veprën penale të “Fyerjes për shkak të detyrës”, për arsye të përdorimit prej tij në punimet e Kuvendit të një fjalori, që mund të konsiderohet fyes nga deputetë apo persona jashtë parlamentit.

Deputeti nuk mund të procedohet penalisht për këtë veprë as në rastin kur riprodhon në median e shkruar apo vizive, atë që ka thënë në Kuvend. Në këtë përfundim arrihet, duke u bazuar në nenet 22 dhe 23 të Kushtetutës së Republikës, si dhe në nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Por, kjo marrëdhënie me Kushtetutën nuk e përjashton deputetin nga përgjegjësia civile. Justifikimi i shprehjeve fyese, duke argumentuar se deklaratimet janë në kuadër të përmbushjes së detyrave parlamentare, si përfaqësues i popullit dhe politikan në kuadër të një situatave politike.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka bërë të qartë, se liria e shprehjes konkurren me (shpifjen dhe) të folurën fyese, duke e bërë këtë një parim bazë në jurisprudencën e saj. Mbi këtë vlerësim, parlamentari shqiptar përgjigjet civilisht, përveç se dhe pavarësisht nga dhe në rastet kur konsumohet veprë penale.

Handyside⁴⁴ ishte një botues i fjalimeve të Fidel Castros dhe Che Guevarës. Për sa kohë botonte këto fjalime ai nuk u dënua ndonjëherë. Dikur, në vitin 1961, Handyside botoi “Manualin e vogël të kuq shkollor”, i paracaktuar për të rinjtë, rreth moshës 12 vjeç. Libri përmbante fjalor që përbëhej nga terma pornografikë dhe intimë mjekësorë, terma të cilët sipas autorit duhej të edukonin brezin e ri. Libri përmbante gjithashtu, propozime që nëpër shkollat e të miturve, duhet të kishte makineri automate që shpërndanin kontraceptivë. Gjyqtarët ishin të prirur ndaj këndvështrimit, sipas të cilit manuali mund të ushtronte ndikim shumë të dëmshëm në moshën e fëmijëve dhe të rinisë.

Në kundërshtim me qëllimin e përdorimit të rëndomtë të kësaj praktike, GJEDNJ ka arritur në konkluzionin që, nuk ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës dhe, dënimi i Handyside ka qenë i drejtë.

Gjykata ka nënvizuar se: *“Përfitimi nga e drejta e të shprehurit lind detyrime dhe përgjegjësi, të cilat janë të ndërvarura nga rrethanat dhe mënyra e të shprehurit.”*⁴⁵

Gjykata Evropiane në gjykimin e kësaj çështje ka arritur në konkluzionin se: *“Nuk ka dyshim se shprehjet për të cilat u dënuan “xhaketat jeshile”, përbënin diçka më tepër se fyerje për anëtarët e grupeve, që u bënë objekt sulmimi (mediatike). Mbrojtjen e tyre nuk e përfshin neni 10 i Konventës.”*⁴⁶

Ndërsa, në lidhje me dënimin e gazetarit, i cili kishte organizuar emisionin, Gjykata u shpreh se, mungonin bazat e mjaftueshme për të pranuar se ndërhyrja në të drejtën e lirisë së të shprehurit ishte e domosdoshme.”⁴⁷

Kërkuesi, kryetar bashkie, kishte përdorur vlerësime negative kundër disa sekteve, vlerësime të cilat shteti i kishte ndaluar. Gjykata ka vlerësuar që ndërhyrja e shtetit ndaj kryetarit të bashkisë kishte qenë e padrejtë.

⁴⁴ Vendim i datës 17.12.1976 (Handyside vs Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr.5493/72.

⁴⁵ Jersild vs Danimarkës, Kërkesa Nr.15890/89, Vendim i datës 23.09.1994.

⁴⁶ Jersild vs Danimarkës, Kërkesa Nr.15890/89, Vendim i datës 23.09.1994

⁴⁷ Jerusalem vs Austrisë, Nr.26958/95, paragrafi 52, Vendim i datës 27.02.2001

Në lidhje me elementët e veprës penale të shpifjes për shkak të detyrës, prirja për t'u mbrojtur nga përgjegjësia civile është referimi në **mendime dhe gjykime vlerësuese**, si të tilla ato nuk përfaqësojnë fakte që cenojnë nderin dhe dinjitetin e njeriut.

Praktika evropiane në “Lingens vs Austrisë, datë 08.07.1986”, “Dalban vs Rumanisë, datë 28.09.1999”, në të cilat Gjykata, duke bërë dallimin ndërmjet “shprehjeve dhe fakteve”, ka qartësuar, sa ka qenë e mundur, jo vetëm reagimin penal, por edhe bazat e përgjegjësisë civile.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 3 të Saj, tregon si një nga parimet themelore mbrojtjen e drejtpërdrejtë të dinjitetit të njeriut:

“...dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij... janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë ato.”

Në legjislacionin material penal, në krye të tij, janë qartësuar objekti i detyrave të tij, :

Neni 1/a, i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë: “Kodi penal bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në parimet e përgjithshme të së drejtës penale ndërkombëtare, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar”.

Neni 1/b, i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë: Detyrat e legjislacionit penal. “Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë... dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij...”.

Neni 239

Fyerja për shkak të detyrës

Fyerja e qëllimshme që i bëhet punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore ose të shërbimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Po kjo veprë, kur kryhet botërisht ose në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.”

Neni 240

Shpifja për shkak të detyrës

Shpifja e qëllimshme që i bëhet punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore ose të shërbimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në § 2, të Neni 10 (Liria e shprehjes) kufizon mundësitë për sjelljet që cenojnë dinjitetin, duke lejuar kundërveprime të ligjit:

“Ushtrimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet disa formaliteteve, kushteve, *kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara nga ligji*, të cilat në një shoqëri demokratike, përbëjnë masat e nevojshme për... *ruajtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit* ose të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e informacioneve konfidenciale...”

Elementet e përgjegjësisë civile në rastet e cenimit në personalitetin e njeriut, rrjedhojë e fyerjes apo fjalimeve, nuk kërkojnë analiza të hollësishme, për shkak të rëndësisë së faktit dhe të subjektit të posaçëm. Në rrethanat e faktit, të një shpifjeje apo fyerjeje, ekzistenca e të cilave nuk mund të mohohet, gjenden të konsumuar të gjithë elementët e përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit, të pasojës dhe të lidhjes shkakësore, për rrjedhojë, të fajësisë.

Subjekti i kundërligjshmërisë, sjelljes së kundërligjshme, mund të jetë çfarëdo, edhe deputet apo politikan:

“1. Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe për votat e dhëna prej tij. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes. Neni 73/1 i Kushtetutës.

Pavarësisht dispozitës së cituar, Gjykata Kushtetuese, në përgjigje të kërkesës për interpretimin e nenit 73/2 të Kushtetutës, ka dalë me këtë konkluzion:

“Gjykata e zakonshme, është i vetmi organ procedues për veprat penale që ndiqen mbi kërkesën e të dëmtuarit akuzues. Për këtë shkak, ajo ka të drejtë dhe është e detyruar me ligj t’i drejtohet drejtpërsëdrejti, pa ndërmjetësinë e prokurorit, të gjitha organeve kompetente, duke përfshirë edhe Kuvendin dhe t’iu kërkojë atyre sipas përkatësisë, autorizimin për ndjekjen penale të personave që gëzojnë imunitet, vetëm në rastet kur i dëmtuari akuzues, në bazë të neneve 59 e 284/5 të Kodit të Procedurës Penale, ushtron kërkesë për procedim.”

Duke vlerësuar në një situatë të praktikës gjyqësore elementët e përgjegjësisë, gjejmë të konsumuar elementët kryesor të saj.

Ana objektive e kundërligjshmërisë gjendet e përfaqësuar nga veprimet konkrete të subjektit të paditur, si autor i dëmit. Pa asnjë lloj ngacmimi të jashtëm, të çastit apo të qëndrueshëm, nga i dëmtuari apo të tretët, në lidhje me objektin e diskutimeve në kuvend, apo me marrëdhëniet shoqërore midis tyre, subjekti i paditur tregon të dhëna të pavërteta, të rreme, të krijuara prej tij.

Fjalimi i tij, me ndikimin e tij, është përçuar edhe në njerëz të pa interesuar për jetën familjare të paditësit, duke u shndërruar në mjet dhune dhe represioni ndaj tij.

Në çështjen “A. kundër Mbretërisë së Bashkuar” (Nr. 35373/97), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka nënvizuar:

*“Gjykata u pajtua me vërejtjet e kërkueses për efektet që komentet e anëtarit të parlamentit përgjatë fjalimit të tij ishin jashtëzakonisht të rënda dhe haptazi jashtë diskutimit parlamentar.”*⁴⁸

Në rastin e shkaktimit të dëmit moral, i vetmi synim i autorit është nëpërkëmbja, nxirrja, cenimi i dinjitetit dhe personalitetit të të dëmtuarit.

Ana Subjektive në kundërligjshmërinë e shpifjes nuk kërkon elementë të veçantë psikologjik, nuk kërkon “dashjen” në një nga format klasike të saj. Për të qenë i konsumuar elementi i anës subjektive është e mjaftueshme “dashja e përgjithshme”, dëshira dhe vullneti i subjektit për të përhapur shprehje fyese, i ndërgjegjësuar që këto thënie sjellin efekte negative tek “i dëmtuari”.

Duke e trajtuar jurisprudencën e Gjykatës së Kasacionit të Italisë si doktrinë në lidhje me vlerësimin e instituteve të caktuara, në lidhje me anën subjektive të shpifjes do të arrinim në konkluzionin e themeluar në disa vendime të Gjykatës së Kasacionit:

“Për të përcaktuar anën subjektive në veprën penale të shpifjes është e mjaftueshme vërtetimi i “dashjes së përgjithshme” që do të thotë që subjekti, autor i thënieve të rreme të jetë i vetëdijshëm që këto thënie cenojnë nderin dhe dinjitetin e një personi tjetër.” Pra konsumimi i anës subjektive vërtetohet me praninë e dy elementëve, zhvillimi normal intelektual i autorit të thënieve ose përgjegjshmëria e tij në kuptimin mjekësor dhe, së dyti, mundësia e tij për të vlerësuar negativitetin e thënieve.

⁴⁸ A. kundër Mbretërisë së Bashkuar” - Nr. 35373/97

Për sa i përket elementit subjektiv të veprës penale të shpifjes është pranuar që në veprat kundër nderit dhe dinjitetit nuk është i nevojshëm qëllimi i posaçëm kriminal i subjektit”⁴⁹.

Në vendimin e Gjykatës së Kasacionit të Italisë Nr.11663, datë 23.09.1997 do të gjejmë përkufizimin që vijon.

“Nuk ka nevojë për një hetim të veçantë në lidhje me ekzistencën ose jo të elementit psikologjik, kur në këtë kontekst është e qartë se ana subjektive e shpifjes përfaqësohet nga qëllimi i përgjithshëm, domethënë vetëdija e subjektit për fyerjen e nderit apo reputacionit të një personi tjetër, kur fjalët shpifëse nuk i shpëtojnë përgjegjshmërisë së subjektit, i cili i ka përdorur ato për ti dhënë një efekt më të madh fjalëve të tij.”

Normat e vendosura në mbrojtje të moralit dhe të dinjitetit të njeriut janë objektivi i përgjithshëm i synimit të kundërligjshëm të autorit të kundërligjshmërisë. Dinjiteti i personalitetit të të dëmtuarit është gjithmonë objekti i posaçëm i veprimeve të kundërligjshme të autorit.

Objekti i këtyre veprave penale, që shkaktojnë, në fund të fundit edhe përgjegjësinë civile, apo që në vetvete përbejnë një nga format e përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit moral, është marrëdhënia juridike që mbron nderin e njeriut ose ndjenjën e dinjitetit të personit.

“Nderi është një vlerë e njeriut e njohur dhe pranuar nga persona të tjerë (marrëdhënie respekti), e cila buron nga dinjiteti i tij dhe formon integritetin e tij si person”.

Integritetin e personit, e formojnë një tërësi elementësh, si paprekshmëria e jetës, e shëndetit etj. Por, citim: *“koncepti i integritetit nuk kufizohet vetëm në elementë kryesisht të jashtme të lirisë së individit. Liria bazohet edhe në një bosht të brendshëm të njeriut, qëndrueshmërinë e të cilit ai e ruan vetëm, duke u shfaqur ndaj të tjerëve”.*

Kjo do të thotë që integriteti nuk është një status, i cili mund të krijohet plotësisht prej vetë personit, por një status, i cili mund të formohet dhe ruhet vetëm nëpërmjet pranimet nga të tjerët. Marrëdhënia e njohjes nga të tretët, e kërkuar nga dinjiteti i secilit, shpreh në këtë mënyrë një marrëdhënie ndër njerëzore themelore.

⁴⁹ Vendimi i Gjykatës së Kasacionit Nr.3571, viti 1996

Personi i dëmtuar bëhet preh e cenimeve reale, kur kjo njohje i mohohet atij pa të drejtë dhe nga ana tjetër, duke qenë një marrëdhënie njerëzore bazë, cenimi i kësaj njohje nëpërmjet fyerjes dhe shpifjes përbën një rrezikshmëri shoqërore të tillë, që e justifikon plotësisht dënimin e subjektit.

Mbrojtja e të drejtës për respekt shoqëror siguron mundësinë e mbrojtjes së bashkëjetesës ndërmjet njerëzve, mbrojtje e cila nëse nuk do të garantohej, apo do të dhunohej, do të trondiste rëndë bazën e një shoqërie.

Veprat e kryera nga persona të veshur me pushtetin e deputetit apo të gazetarit janë veçanërisht të rrezikshme, sepse janë kryer publikisht nëpërmjet foltoreve të parlamentit, mjeteve të medias, apo forma të tjera të fyerjes e shpifjes botërisht. Ndryshe nga fyerja e bërë në prani të personit, kur ai ka mundësi të reagojë personalisht dhe në çast, ndaj zhvlerësimit të vetëm një njeriu (autorit të veprave), në këto raste fyerjet, shpifjet dhe autori i tyre, kanë mundësuar krijimin e një mendimi negativ në mbarë opinionin shoqëror, në mënyrë të pavarur nga personi i cenuar.

Rrezikshmëria e veçantë e shpifjes në raste të tilla qëndron kryesisht në elementin e anës subjektive, pasi thënie “dihet që janë të rreme”, duke qenë se përmbajtja e thënies ka natyrë faktike ato, ndryshe nga fyerja ku shprehen thjesht vlerësime dhe gjykime që mbështeten në mendime personale, në rastin e shpifjes krijojnë një bindje më të sigurt të opinionit shoqëror për zhvlerësimin e dinjtetit të personit, sepse mbështeten në “fakte” të servitura si të vërteta.

Pikërisht elementët intelektualë dhe volitivë (të vullnetshëm), në lidhje me anën objektive të përhapjes së thënies të rreme dhe, jo vetëm elementët e shpifjes në vetvete (përhapja dhe pavërtetësia), përbëjnë dhe thelbin e rrezikshmërisë më të madhe të shpifjes në krahasim me fyerjen; sepse thënie të rreme mund t’i thuhet edhe vetë të dëmtuarit dhe të konsiderohen përsëri fyerje, ashtu sikurse nëpërmjet fyerjes vlerësimet poshtëruese mund t’u përhapen të tretëve.

Në rastin e shpifjeve të konsumuara, autori i tyre, ka parashikuar dhe ka dëshiruar cenimin e nderit të personit të dëmtuar, pikërisht, duke deformuar opinionin shoqëror nëpërmjet përhapjes së thënies të rreme.

Duke qenë një vepër penale/ kundërligjshmëri civile që konsumohet kryesisht me anë të shprehjes dhe në çastin e bërjes së saj, mundësia e parandalimit të cenimit nga personi i prekur nëpërmjet institutit të mbrojtjes së nevojshme është pothuajse inekzistente.

Mospërfillja e gjykatave, në raste të veçanta ndaj padive të tilla, nën petkun e imunitetit apo të lirisë së shprehjes vjen në kundërshti me **mundësitë për t'ju drejtuar gjykatës**, “aksesin në gjykatë”, deri në krijimin e instrumenteve personale, për mbrojtjen dhe imunizimin e autorit të dëmit.

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

*Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjesë të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë..”*⁵⁰

E drejta e aksesit në gjykatë aplikohet kur i dëmtuari i bashkohet procesit penal si palë civile. Nga ky moment procesi përfshin ”një të drejtë civile” në kuptimin e nenit 6 të konventës.

Në mbrojtje të të dëmtuarve, në rastet e cenimit të dinjitetit e personalitetit nëpërmjet shpifjes dhe fyerjes, nga subjekte me imunitet, është jo vetëm ligji material, por dhe jurisprudenca vendase, e Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese, si dhe praktika e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut.

Në çështjen *Cordova vs Italy 2003*, gjykata ka konstatuar se:

*“...komentet e bëra jashtë parlamentit, dhënia e imunitetit parlamentar këtyre deklarimeve përbën një ndërhyrje jo proporcionale me nenin 6 të konventës.”*⁵¹

Zotërinjtë Vitorio Sgarbi dhe Francesko Kosiga, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre parlamentare, shpifën dhe fyen rëndë prokurorin e Mesinës – Itali, Agostino Kordova.

Fillimisht, gjykata e shkallës së parë të Mesinës e dënoi zotin Sgarbi me dy muaj burgim. Më tej, të dy të akuzuarit, u përjashtuan nga përgjegjësia penale për shkak të “imunitetit” parlamentar, i

⁵⁰ Neni 6/1 i Konventës.

⁵¹ Cordova vs Italy 2003

diskutuar nga gjykatat e niveleve më të larta, si dhe nga Senati dhe Dhoma e Deputetëve (Parlamenti).

GjEDNj mbi kërkesën e të dëmtuarit, arriti në konkluzionin që: “*ka pasur shkelje të të drejtës së kërkuarit për aksesin në gjykatë*”,⁵² pra ishte mohuar e drejta e kërkuarit për akses në gjykatë.

Gjykata ka tërhequr vëmendjen se: “*Gjykata vëren se aktet apo veprimet për të cilat pretendohet imunitet duhet të kenë lidhje direkte me funksionin për të cilin njihet imuniteti. Pra një deputet mund të gëzojë imunitet vetëm për sa i përket akteve që kanë lidhje direkte me punën e tij parlamentare, por jo akteve apo veprimeve që ai ka kryer jashtë këtij konteksti specifik. Gjithashtu gjykata ekzaminon nëqoftëse ekziston një balance e drejtë ndërmjet interesit publik që presupozohet nga dhënia e imunitetit dhe interesit për të pasur akses në gjykatë.*”

Në çështjen *De Jorio vs Italy* gjykata vërejti se:

“*...dhënia e imunitetit ndaj deklarimeve të bëra në një intervistë të një senatori me imunitet tek një gazetar, pra jashtë dhomës së parlamentit dhe që nuk kishin të bënin me kryerjen e detyrave parlamentare në kuptimin e ngushtë, dhe, dukeshin më shumë si mosmarrëveshje personale, përbënin një mohim të së drejtës për akses në gjykatë dhe, vetëm mbi bazën se mosmarrëveshja mund të ishte politike në natyrë, apo e lidhur me një aktivitet politik. Pra gjykata vlerësoi se nuk kishte balancë ndërmjet interesit të përgjithshëm të imunitetit dhe mbrojtjes së të drejtave individuale.*”⁵³

Edhe më parë, në çështjen *Cordova vs Italy*, gjykata konstatoi se deklaratat e bëra në një takim elektorale pra jashtë dhomës së parlamentit nuk kishin të bënin me ushtrimin e funksioneve parlamentare dhe ngjanin më shumë me një mosmarrëveshje personale.

Gjithashtu, në çështjen *A. vs United Kingdom* gjykata ka diferencuar ndërmjet imunitetit që i

⁵² *Cordova vs Italy* 2003 “...there had been an interference with the applicant's right of access to a court.”

⁵³ *De Jorio vs Italy* – GjEDNj

jepet deklaratave të bëra gjatë zhvillimit të debateve parlamentare me qëllim mbrojtjen e interesave të parlamentit në tërësi dhe të deklaratave të parlamentarëve si individ.

“Më tej, gjykata thekson se nuk ka imunitet për deklaratat të bëra jashtë parlamentit apo në një konferencë për shtyp ndaj një deputeti edhe pse përmbajtja e tyre mund të përsërisë deklaratat të bëra në debatin parlamentar.”

Me vendimin e datës 22.02.2002 midis Dichand etj vs. Austrisë, GjEDNj ka bërë një dallim ndërmjet gjykimeve vlerësuese dhe fakteve (konstatimit apo parashtrimit të fakteve).

Gjykata orienton se në parim gjykimet vlerësuese nuk mund të provohen. Gjykata vijon, duke nënvizuar se, *“kjo nuk do të thotë që i padituri, mund të shprehë çdo opinion, pavarësisht se sa dëmtues mund të jetë ai, pa pasur prova për ti mbështetur ato”*. Në këtë kuptim, gjykata ka vlerësuar që edhe gjykimet vlerësuese kërkojnë një bazë faktike.

Me vendimin datë 07.05.2002 (McVicar vs. Britanisë së Madhe, Nr.46311/99, paragrafi 87), GjEDNj hapur, qartë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, krijon jurisprudence evropiane, duke kërkuar për sa i përket konstatimeve të fakteve që i kundërvihen të drejtave dhe dinjitetit të individëve të tjerë, *i akuzuari/i paditurit për shpifje, të provojë të vërtetën e deklaratave faktike që ka bërë.*

Në vendimin e datës 17 dhjetor 2004, në gjykimin e kërkesës *“Pedersen dhe Baadsgard v. Danimarkës”*, Dhoma e Madhe e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut e kufizon të drejtën e gazetarit vetëm në dhënien e gjykimeve vlerësuese, duke konsideruar cenim të të drejtës së tjetrit prezantimin e deklaratave faktike, të rreme apo të pavërtetuara.

Gjykata përgjithësisht e vlerëson vetë, në se deklarata përbën një gjykim vlerësues, konstatim apo parashtrim faktik, duke orientuar se *“kemi të bëjmë me konstatime të fakteve edhe kur ato shprehen në formën e pyetjeve “retorike”. Në këtë vlerësim arrihet, duke marrë parasysh natyrën dhe seriozitetin e shpifjes.”*⁵⁴

⁵⁴ “Pedersen dhe Baadsgard v. Danimarkës” - GjEDNj

Konsumimi i veprave penale që cenojnë dinjitetin apo kryerja e kundërligjshmërive civile me synim poshtërimin nëpërmjet fyerjes apo shpifjes, nga subjekte të veshur me imunitet parlamentar apo njerëz të medieve nëpërkëmbin, duke dhunuar njëherazi, zotimin kushtetues “për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor”, nenin 3 të Kushtetutës, si dhe nenet 8/1 dhe 10/2 të “Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

Liria e shprehjes, përbën themelet kryesore të një shoqërie demokratike, por pikërisht në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, neni 10/2 dhe neni 17 i Konventës vendosin kufizime të kësaj lirie, pasi në emër të kësaj lirie nuk duhet të abuzohet. Kjo liri nuk mund të shërbejë si bazë për të shpifur e denigruar figurën e individit.

Me kundërligjshmëritë në trajtim si shkak të dëmit moral (fyerje, shpifje etj.) dhunohet drejtpërdrejtë neni 8, pa përfillur nenet 10/2 dhe 17 të Konventës.⁵⁵

Materializimi i dispozitave të Konventës gjen pasqyrim në nenet 42 dhe 73 të Kushtetutës së Republikës.

Injorimi i neneve 13 (mjetet efektive të ankimit) dhe 14 (diskriminimi), të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, përbën strehë të argumenteve kundër përgjegjësisë civile, në rastin e dëmit moral, kur ky dëm shkaktohet, duke abuzuar me të drejtën e lirisë së shprehjes.

Liria e shprehjes nuk është absolute në asnjë vend të botës, dhe të gjithë kanë kufizime kur bëhet fjalë për “shprehjet e urrejtjes”, rrjedhoja të fyerjeve, shpifjeve nëpërmjet fjalimeve apo komunikimeve me publikun.

⁵⁵ Neni 10/2 i Konventës – Liria e shprehjes

“2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale osë për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

Neni 17 i Konventës – Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave:

“Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një Shteti, grupimi ose individi, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cenimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjëra të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë.”

“Ashtu sikurse liria e dikujt përfundon aty ku fillon liria e tjetrit, ashtu edhe liria e shprehjes duhet të përfundojë aty ku fillon dinjiteti i njeriut”.

Nobelisti Albert Kamy ka thënë dikur, në pragun e miratimit të nenit 10 të konventës:

“Liri nuk do të thotë të flitet çfarëdo që i bie njeriu në mendje, as të rritet numri i gazetave të mbushura me skandale, as vendosje e diktaturës në emër të lirisë së nesërme. Liri, para së gjithash, do të thotë të mos gënjesh. Sepse, atje ku gënjehet, atje ku shtohen gënjeshttrat, atje tirania ose paralajmërohet ose vazhdohet.”

15. Lloje të tjera të dëmit jopasuror

Demi i shkaktuar nga ndërhyrja në jetën private.

Një stacion televiziv ka organizuar një emision, ku trajtohen investigime të një skandali seksual, të një ministri. Në Lidhje me kërkimet, shkakun dhe bazën ligjore.

Një nga parimet themelore të bashkëjetesës në shoqërinë njerëzore është ndalimi për t'i shkaktuar dëm tjetrit. Zbatimi i tij gjen rregullim të përgjithshëm në Kodin Civil dhe në veçanti në dispozitat mbi përgjegjësinë civile.

Neni 608 i Kodit Civil parashikon faktin juridik njerëzor të sjelljes së paligjshme dhe me faj të një personi, që i shkakton dëm një personi tjetër. Nëse vërtetohet fakti i paligjshëm dhe lidhja shkakësore e tij me dëmin, lind marrëdhënia e detyrimit, e drejta subjektive e personit të dëmtuar, për të kërkuar dëmshpërblim dhe detyrimi i personit përgjegjës për ta shlyer atë.

Sjellja e paligjshme dhe me faj e të paditurit, që përbën faktin e paligjshëm, përfaqësohet nga veprime dhe mosveprime, haptazi në kundërshtim me ligjin:

Të paditurit kanë ushtruar “të drejtën e shprehjes së mendimit dhe të drejtën për të informuar publikun për ngjarje të një interesi publik” në dhunim të hapur të nenit 23, Pika 2, të Kushtetutës së Republikës, si dhe me nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut-KEDNJ, duke mospërfillur kuadrin ligjor në fuqi dhe rregullat e etikës profesionale.

Të paditurit, duke përvetuar kompetenca dhe pushtete të shërbimeve sekrete, të policisë gjyqësore, të prokurorisë dhe të gjykatave, gjatë një periudhe kohe, duke filluar nga një datë e papërcaktuar, kanë kryer veprime që synojnë drejtpërdrejtë njeriun, për shkak dhe në të gjitha cilësitë e tij, natyrale dhe ligjore.

Për realizimin e regjistrimeve të transmetuara, të paditurit kanë urdhëruar dhe realizuar ndjekjen, vëzhgimin dhe përgjimin e paditësit, në cilësinë e personit fizik dhe të funksionarit publik.

Për grumbullimin e të dhënave që do të përdoreshin gjatë një programi televiziv, atyre ju është dashur dhe kanë realizuar, me anë të mashtrimit dhe mënyrave të tjera të paligjshme, që përbejnë disa figura veprash penale, dhunimin e jetës private, të korrespondencës dhe të banesës së paditësit.

Në shfaqjen e parapërgatitur të programit “Investigim” të datës 04.03.2009, dhe në vazhdim, të paditurit kanë publikuar të dhëna të falsifikuara, të manipuluar dhe të rreme, me synim të kundërligjshëm, dhunimin e personalitetit të paditësit.

Duke zotëruar mjete më të shumta komunikimi se paditësi, duke gjetur interesimin e publikut për “lajmin”, pavarësisht se ishte i rreme, të paditurit kanë ndaluar çdo lloj ballafaqimi në publik dhe, duke tejkalluar etiken dhe detyrimet ligjore elementare e kanë dhuruar dhe kanë shitur, publikime të pavërteta dhe fyese.

Të paditurit kanë vepruar me faj. Përtej prezumimit ligjor dhe mjekësor që i kuptojnë veprimet që kryejnë, ata gjithmonë kanë qenë të ndërgjegjshëm që ju ndalohet të kryejnë veprime në kundërshtim me Kushtetutën e Republikë, Ligjin penal dhe atë Civil, në rastet e respektimit të rregullave të bashkëjetesës.

Faji i të paditurve është në formën e dashjes direkte për arritjen e synimit të kundërligjshëm. Dashja është shprehje e vlerësimeve psikike të individit ndaj një fakti të kundërligjshëm ose, për kryerjen apo moskryerjen e një veprimi të caktuar.

Vlerësimi pozitiv, nga ana e të paditurve, i veprimeve apo mosveprimeve që dihenin ose duhej të dihenin prej tyre, si të kundërligjshme, paraqitja e fakteve të rreme dhe thëniet që përbëjnë fyerje, deklaratimet publike të tyre, janë shprehja me e kulluar e dashjes direkte.

Dëmi i shkakuar si rrjedhojë e veprimeve të kundërligjshme të të paditurve është i natyrës pasurore dhe jo pasurore.

Vlera e dëmit pasuror të shkakuar do të përcaktohet gjatë gjykimit, pas vlerësimeve nga ekspertë të caktuar nga gjykata, të cilët do t'i nxjerrin konkluzionet e tyre, duke u bazuar në faktin, që në padinë objekt gjykimi, dëmi pasuror përfaqësohet nga:

Dëmtimi i shëndetit, pavarësisht se në shfaqjen e tij të jashtme trajtohet si dëm moral, ka shkakuar humbje pasurore, që lidhen me shpenzimet e kryera për kurimin e pasojave të shaktuara dhe parandalimin e aksidenteve mjekësor, që lidhen me patologjitë e lindura.

Ndikimi negativ në aktivitete fitimprurëse, të administruara nga familjarë të të dëmtuarit, që e ushtrojnë veprimtarinë fitimprurëse, duke përdorur pasurinë intelektuale të paditësit është pjesë e dëmit pasuror të shkakuar,

Shpenzimet e kryera nga i dëmtuari, për parandalimin apo rivendosjen jashtëgjyqësisht të së drejtës.

Cenimi dhe ulja e të ardhurave të të dëmtuarit, për shkak të shkarkimit të tij nga detyra e Ministrisë.

Dëmi jo pasuror përfshin çdo lloj dëmi të pësuar nga cenimi i të drejtave dhe interesave jopasurore, që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut.

Dëmi moral është shfaqje e brendshme e turbullimit të padrejtë të gjendjes shpirtërore të paditësit, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm.

Për shkak të natyrës subjektive dhe të brendshme të tij, dëmi moral i kërkuar është rrjedhojë e vlerësimit subjektiv dhe objektiv të personalitetit të paditësit dhe përfaqësohet nga shumica e objektit të padisë.

Doktrina dhe Jurisprudenca mbi objektin e padisë

Si burim ligji dhe orientim i gjykatës, për krijimin e bindjes në ekzistencën e dëmit dhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjes civile, mund dhe duhet të shërbejë jurisprudenca e niveleve më të larta gjyqësore, të GJEDNJ dhe vendeve të tjera evropiane.

Në çështjen Nr. 12556/03, § 35, ECHR 2007 “Pfeifer k. Austrisë”, Gjykata e të Drejtave të Njeriut, ka theksuar se neni 10 i Konventës nuk garanton një të drejtë të pakufizuar, edhe në rastet kur informacioni mund të jetë me interes për publikun e gjerë. Kur qëllimi kryesor i informacionit është sulmi kundër garancive të nenit 8 të Konventës, e drejta për jetë private dhe reputacion, marrin përparësi (shih inter alia).

Në çështjen “Flux k. Moldavisë”, Gjykata e të Drejtave të Njeriut, kërkon vendosjen e një ekuilibri të drejtë me parimin e prezumimit të pafajësisë, të garantuar nga neni 6 § 2 i Konventës.

Në çështjen “Von Hannover v. Germany”, Gjykata e të Drejtave të Njeriut, realizon prevalencën e të drejtave të garantuar nga neni 8 i Konventës kundrejt nenit 10 të Saj.

Sipas Gjykatës së Drejtave të Njeriut, media mund të jenë të justifikuara të publikojnë informacion të pasaktë kur ato veprojnë në mirëbesim. (Përvetësimi i kompetencave dhe pushteteve të shërbimeve sekrete, të policisë gjyqësore, të prokurorisë dhe të gjykatave, nuk tregon për mirëbesim, por për veprimtari të mirëfilltë kriminale.)⁵⁶

(shih mutatis mutandis: *Bladet Tromsø and Stensaas k. Norvegjisë [GC]*, no. 21980/93, § 65, *ECHR 1999-III*).

Gjykata Italiane e Kasacionit në Vendimin Nr.25171, datë 03.12.2007 përcakton se: “*Dëmi moral është konsekuencë e dhunimit të nderit dhe reputacionit të subjektit*”.

⁵⁶ Von Hannover v. Germany - GjEDNJ

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës Italiane të Kasacionit në Vendimin Nr.26972, datë 11.11.2008 përcaktojnë se: *“Dëmi moral është rrjedhojë e një fakti të paligjshëm në kufijtë e një veprë penale që drejtohet kundër të drejtave personale të mbrojtura nga Kushtetuta”*.

Në fundin e vitit 2008, Gjykatat mbretërore Londineze, pranuan qartësisht, për rrethana fakti të ngjashme, padinë e Max Mosley kundër FIA (Federata Ndërkombëtare e Automobilizmit) me objekt dëm jopasuror.

Dëmi jo pasuror është i njohur qartësisht dhe nga doktrina bashkëkohore. Në këtë diskutim, përfaqse më e afërt e trajtimeve shkencore me rrethanën konkrete të faktit, gjendet në studimet dhe punimet shkencore të kohëve të fundit, të cilat i rekomandohen gjykatës bashkëlidhur kësaj padie.

Në lidhje me provat

Barra e provës për vërtetimin e dëmit moral është e paditësit. *“Por, nisur nga natyra subjektive e këtij dëmi dhe veçanërisht nga karakteri, shfaqja e brendshme e tij, vërtetimi i cenimit të personalitetit të të dëmtuarit në turbullime, dhimbje e vuajtje shpirtërore, etj., nuk mund të provohet në mënyrë tjetër përveçse, duke i vlerësuar ius receptum, si të mbështetura ligjërisht dhe, duke i çmuar si të provuara ipso iure me vërtetimin nga paditësi të vetë faktit të paligjshëm të të tretit dhe lidhjes së këtij fakti me cenimin moral të pësuar, sipas parimit të rregullshmërisë shkakësore”*.⁵⁷

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga persona të tjerë.

Në vijim do të trajtohen rastet e përgjegjësisë që rrjedh nga shkaktimi i një dëmi, por që nuk ka qenë rezultat i veprimeve të vetë personit përgjegjës. Në këto raste dëmi është shkaktuar nga një i tretë për të cilin përgjigjet civilisht personi i caktuar nga dispozitat e Kodit Civil.

Sipas Kodit tonë Civil, personi fiton zotësi të plotë veprimi në moshën 18 vjeçare. Në këtë moshë ai mund të fitojë të drejta ashtu si edhe mund të marrë përsipër detyrime. Kurse një i

⁵⁷ Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë Nr. 12 datë 14.09.2007

mitur që ka mbushur moshën 14 vjeç ka zotësi të kufizuar veprimi. Zotësia për të vepruar është gjithashtu kusht edhe për ngarkimin me përgjegjësi civile si rezultat i shkakimit të një dëmi.

Megjithatë pavarësisht se Kodi Civil e ka lidhur përgjegjësinë e personit me aftësinë për të kuptuar rëndësinë e veprimeve që kryen, në rastin kur dëmi është shkaktuar nga një person që nuk ka pasur ndërgjegjen e veprimeve të tij, ai do të përgjigjet civilisht me shpërblimin e dëmit⁵⁸.

Në këtë rast gjykata vetëm mund të marrë në konsideratë moshën, shkallën e ndërgjegjes dhe kushtet ekonomike të palëve. Por nuk mund ta bëjë këtë kur vetë autori i dëmit e ka sjellë vetën në një gjendje të tillë. Kurse parimi i përgjithshëm, sipas të cilit personat që nuk kanë zotësi për të vepruar nuk mbajnë përgjegjësi për dëmet e shkaktuara, vepron për të miturit dhe personat që me vendim gjyqësor u është hequr kjo zotësi (apo u është kufizuar). Më tej do trajtohen në radhë të parë ndër përgjegjësitë për veprimet e të tjerëve, pikërisht përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga të miturit dhe personat pa zotësi veprimi (ose me zotësi të kufizuar).

Përgjegjësia e prindërve për dëmin e shkaktuar nga fëmijët e tyre të mitur. Dëmi i shkaktuar nga i mituri nën katërbëdhjetë vjeç.

Kodi Civil, neni 613 parashikon:

“ I mituri që nuk ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç dhe personat që janë krejt të pazotë për të vepruar nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar.

Prindërit, kujdestari ose ata të cilëve u janë besuar ose kanë në mbikëqyrje persona të pazotë për të vepruar, janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga veprimet e paligjshme të fëmijëve nën moshën katërbëdhjetë vjeç, të personave nën kujdestarinë e tyre dhe të atyre që i kanë në mbikëqyrje e me të cilët banojnë, por që nuk kanë zotësi për të vepruar, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.”

Kjo dispozitë ngarkon me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga fëmijët e mitur nën katërbëdhjetë vjeç dhe personat që barazohen me ta (të pazotë për të vepruar), prindërit apo kujdestarin. Bëhet fjalë kështu, për një dëm të shkaktuar nga një person i cili nuk mund të jetë mbajtës i të drejtave dhe detyrimeve. Në këtë rast nuk do të ishte e drejtë që personi i dëmtuar të

⁵⁸ Neni 616 i Kodit Civil.

mos kishte mundësi për të kërkuar shpërblimin e dëmit vetëm për faktin se ky është shkaktuar nga një person që nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi civile. Për këtë arsye ligji ka parashikuar detyrimin e prindërve për shpërblimin e këtij dëmi. Këtu lind pyetja se me çfarë përgjegjësie kemi të bëjmë në këtë rast ? Lidhur me këtë çështje ekzistojnë dy mendime.

Së pari, ekziston mendimi se përgjegjësia e prindërve ka për bazë të saj vetë fajin e tyre⁵⁹. Prezumimi i fajësisë në këtë rast lidhet me detyrimin e prindërve për edukim dhe mbikëqyrje të fëmijëve të tyre. Ky prezumim i fajësisë mund të kundërshtohet vetëm Nëse prindërit përgjegjës provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.

Ekziston një mendim tjetër sipas të cilit përgjegjësia e prindërve nuk është një përgjegjësi për faj të tyre. Kjo lloj përgjegjësie shpjegohet me *idenë e solidaritetit familjar* dhe nuk varet nga asnjë lloj faji që ka të bëjë me edukimin apo mbikëqyrjen e fëmijëve. Kështu sipas kësaj ideje, familja është një grupim i lidhur nga interesa mjaft të gjera dhe nuk është aspak anormale që këto lidhje të arrijnë deri në atë masë që prindi të përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga fëmijët e tij.

Mjafton të kujtojmë që kur ati (ose nëna) është detyruar civilisht, e gjithë familja pëson si rezultat i kësaj, pasojat e këtij detyrimi, i cili mund të varfërojë së tepërmi mjetet financiare të familjes. Përse atëherë sipas kësaj ideje mos të jetë kështu edhe në rastin e dëmit të shkaktuar nga fëmijët ?

Doktrina jonë ka pranuar se përgjegjësia e prindërve ka si bazë të saj fajin e këtyre të fundit. Faji konsiston në mospërmbushjen e detyrimit të tyre për edukimin e fëmijës dhe mbikëqyrjen e tyre. E njëjta gjë vlen edhe për personat të cilëve u është hequr zotësia për të vepruar. Do të jetë kujdestari apo personi që ka nën mbikëqyrjen e tij këtë person, i cili do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga personi i pazotë për të vepruar. Vetë gjendja e një të pazoti për të vepruar imponon një mbikëqyrje të vazhdueshme mbi të dhe është detyrim i kujdestarit ta bëjë një gjë të tillë.

Prindërit si persona përgjegjës., duke lexuar nenin 613 vëmë re se ligji parashikon se janë *prindërit* ata që do të përgjigjen civilisht. Me këtë formulim është pasur parasysh rasti i familjes legjitime, në të cilën ati dhe nëna përgjigjen së bashku për dëmin e shkaktuar nga fëmija i tyre. Por jo gjithmonë jemi para një fakti të tillë. Kështu në rastin e një martese të zgjidhur, fëmija i

⁵⁹“Manuel Droit Civil” - Pierre Voirin

është lënë për rritje dhe edukim njërit prej prindërve. Në këtë rast përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga fëmija do të përgjigjet prindi pranë të cilit ai banon. Në rast se fëmija i është lënë për rritje dhe edukim një personi të tretë dhe asnjërit prej prindërve, do të jetë personi që i është besuar i cili do të përgjigjet.

Kushtet e përgjegjësive. Për të ngarkuar me përgjegjësi prindin e një fëmije apo kujdestarin e një të pazoti për të vepruar, duhet të plotësohen disa kushte të parashikuara nga neni 613. Këto janë: moshën nën katërbëdhjetë vjeç apo pazotësia për të vepruar, bashkëjetesa, ekzistenca e dëmit.

Mosha e fëmijës apo pazotësia e personit. Përgjegjësia e prindërve për dëmin e shkaktuar nga fëmija i tyre parashikuar nga neni 613 i Kodit Civil, ka të bëjë vetëm me dëmin e shkaktuar nga një i mitur nën moshën katërbëdhjetë vjeç. Përcaktimi i moshës së fëmijës do të bëhet lidhur me ditën e shkaktimit të dëmit. Kurse përgjegjësia e kujdestarit sipas kësaj dispozite do të ketë vend vetëm për personat të cilëve u është hequr tërësisht zotësia për të vepruar.

Bashkëjetesa. paragrafi i dytë i nenit 613 parashikon si kusht të lindjes së përgjegjësive se personi që ka shkaktuar dëmin duhet të banojë me personin përgjegjës. Nëse i mituri apo i pazoti nuk banojnë me prindërit apo kujdestarin kush do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar ? Në këtë rast përgjegjësia do të binte mbi personin që ushtron efektivisht mbikëqyrjen e të miturit (të pazotit). Kështu në rast se një i mitur ka shkuar me pushime të gjyshërit e tij do të ishin këta që do të përgjigjeshin për dëmin e shkaktuar nga i mituri.

Shkaktimi i një dëmi. Pa dyshim që duhet ekzistenca e një dëmi të shkaktuar nga i mituri (i pazoti), që të lindë përgjegjësia për prindërit (kujdestarin). Por lind pyetja nëse kërkohet thjesht që i mituri (i pazoti) të ketë shkaktuar një dëm, apo duhet gjithashtu që të ketë vepruar me faj. Mendoj se në qoftë se i mituri (i pazoti) nuk ka pasur asnjë faj në shkaktimin e dëmit, nuk do të përgjigjen as prindërit (kujdestari) për dëmin e shkaktuar. Kështu nuk do të ishte e drejtë që të detyrohej prindi (kujdestari) për shpërblimin e një dëmi që i mituri (i pazoti) e ka shkaktuar në rrethana të pavarura nga ai, të cilat nuk mund t'i ndalonte. Në këtë mënyrë Nëse prindërit (kujdestari) provojnë së dëmi është shkaktuar pa faj të të miturit (të pazotit), nuk do të përgjigjen për dëmin e ardhur.

Përjashtimi i prindërve (kujdestarit) nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit. Paragrafi i dytë i nenit 613 parashikon përgjegjësinë e prindërve (kujdestarit) për dëmin e shkaktuar nga fëmijët (i pazoti), “përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.” Megjithatë, është pranuar se personat përgjegjës për shpërblimin e dëmit mund të përjashtohen, duke provuar

se kanë ushtruar një mbikëqyrje të rregullt dhe se u kanë dhënë fëmijëve të tyre një edukim të mirë. Barra e provës sigurisht që bie mbi prindërit (kujdestarin) që të rrëzojnë prezumimin e fajësisë.

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga i mituri mbi katërmbëdhjetë vjeç dhe personi me zotësi të kufizuar veprimi.

Kodi ynë Civil ka parashikuar përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga të miturit në varësi të moshës së tyre. Kështu ndërsa për dëmet e shkaktuara nga i mituri nën katërmbëdhjetë vjeç, ligji parashikon se ata nuk përgjigjen, për dëmet e shkaktuara nga i mituri që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, parashikohet përgjegjësia e këtij të fundit. Neni 614/1 i Kodit Civil parashikon: “ I mituri që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, përgjigjet për dëmin e paligjshëm të shkaktuar prej tij.”

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për personat që kanë zotësi të kufizuar për të vepruar e që barazohen me të miturit mbi katërmbëdhjetë vjeç, megjithëse neni 614/1 nuk e ka parashikuar shprehimisht si në rastin e personave të pazotë për të vepruar.⁶⁰

Një dallim i tillë midis përgjegjësisë së të miturve është pranuar me arsyetimin se i mituri me mbushjen e moshës katërmbëdhjetë vjeçare fillon të kuptojë rëndësinë e veprimeve që kryen dhe si rrjedhim duhet të përgjigjet për to. Megjithatë ligji ka pasur parasysh se i mituri në këtë moshë zakonisht nuk disponon të ardhura dhe si rrjedhim i dëmtuari do të mbetet pa u dëmshpërblyer në rast insolvabiliteti të tij.

Për këtë arsye neni 614/2 parashikon se në këto raste do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar sipas rastit prindërit ose kujdestari. Kjo është përsëri një përgjegjësi e kushtëzuar sepse ata mund të provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit dhe në këtë rast, ligji i përjashton nga përgjegjësia.

⁶⁰ Neni 613 i Kodit Civil: I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç dhe personat që janë krejt të pazotë për të vepruar nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar. Prindërit, kujdestari ose ata të cilëve u janë besuar ose kanë në mbikëqyrje persona të pazotë për të vepruar, janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga veprimet e paligjshme të fëmijëve nën moshën katërmbëdhjetë vjeç, të personave nën kujdestarinë e tyre dhe të atyre që i kanë nën mbikëqyrje e me të cilët banojnë, por që nuk kanë zotësi për të vepruar, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.

Kështu në një rast të tillë paditësi ka kërkuar nga i padituri, i mitur mbi 14 vjeç, shpërblimin e dëmit që ky i fundit i ka shkaktuar autoveturës së tij. Pasi gjykata konstatoi se i mituri nuk dispononte të ardhura për të shpërblyer dëmin, thirri si të paditur nënën e autorit të dëmit në bazë të nenit 614 të Kodit Civil. E paditura ka pretenduar se nuk ka mundur ta ndalonte shkaktimin e dëmit me argumentin e vetëm se nuk kishte qenë prezent në ngjarje. Gjykata me të drejtë nuk e ka pranuar pretendimin e të paditurës, për arsye se pamundësia për të ndaluar ardhjen e dëmit nuk varet nga fakti i të qenit apo jo prezent në momentin e shkakimit të tij. Përrjashtimi nga përgjegjësia do të bëhej vetëm nëse e paditura do të provonte se e kishte mirë edukuar dhe mbikëqyrur fëmijën e saj⁶¹.

Gjithsesi duhet pasur parasysh se përgjegjësia e prindërve është subsidiare dhe do të hyjë në lojë vetëm nëse i mituri nuk disponon të ardhura nga puna e tij ose nuk ka ndonjë pasuri tjetër çfarëdo. Nëse i mituri do të ishte në gjendje të shlyente këtë detyrim, atëherë nuk mund të detyroheshin prindërit, por vetë i mituri për shpërblimin e dëmit.

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga personat nën mbikëqyrje.

Kodi Civil, neni 615 parashikon: “ Mësuesit dhe personat e tjerë që kanë nën mbikëqyrje të mitur ose personat që u mësojnë të tjerëve një mjeshtëri ose profesion, janë përgjegjës për dëmin e paligjshëm të shkaktuar të tjerëve nga nxënësit ose personat që kanë nën mbikëqyrje, ose personat që mësojnë mjeshtëri apo profesion pranë tyre, të shkaktuar gjatë kohës që kanë qenë nën mbikëqyrje të tyre të drejtpërdrejtë, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.”

Kjo përgjegjësi, duket analoge me përgjegjësinë e prindërve për dëmet e shkaktuara nga të miturit. Kjo sepse mësuesit apo personi që u mëson të tjerëve një mjeshtëri ka detyrimin për të mbikëqyrur të miturit apo atë që mëson mjeshtërinë. Gjithashtu ata, si edhe prindërit, mund të përjashtohen nga kjo përgjegjësi vetëm në rast se provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.

Kushtet e përgjegjësive. Që të lindë përgjegjësia e parashikuar në nenin 615, duhet së pari të ekzistojë një lidhje e posaçme midis personit përgjegjës dhe atij që ka shkaktuar dëmin. Kështu person përgjegjës do të jetë mësuesi për dëmet e shkaktuara nga të miturit në ngarkim të tij. Gjithashtu përgjegjës do të jetë mjeshtri për dëmin e shkaktuar nga personi që mëson prej tij.

⁶¹ Vendim Nr.651, datë 08.06.2000

Këta duhet të kenë lidhur midis tyre një kontratë të posaçme për mësimin e mjeshtërisë sipas parashikimit që bëhet në Kodin e Punës për një rast të tillë (neni 17 i Kodit të Punës). Një kusht tjetër i kësaj përgjegjësie është ushtrimi i mbikëqyrjes. Kjo do të thotë se personat e lartpërmendur do të përgjigjen për dëmin e shkaktuar vetëm për sa kohë personat që kanë shkaktuar dëmin kanë qenë nën mbikëqyrjen e tyre të drejtpërdrejtë. Vetëm gjatë kësaj kohe ekziston detyrimi për të mbikëqyrur personat që mund të shkaktojnë një dëm dhe mospërbushja e këtij detyrimi sjell si pasojë lindjen e përgjegjësise së mësuesit apo mjeshtrit për ndonjë dëm të mundshëm.

Përjashtimi nga përgjegjësia. Neni 615 prezumon fajësinë e mësuesit apo mjeshtrit për dëmin e shkaktuar nga i mituri apo personi që mëson një mjeshtëri. Si rrjedhim, nëse shkaktohet një dëm nga këta të fundit gjatë kohës që kanë qenë nën mbikëqyrjen e personave përgjegjës, do të lindë përgjegjësia për shpërblimin e dëmit. Ky prezumim ashtu siç thamë më sipër mund të kundërshtohet vetëm Nëse personi përgjegjës provon se nuk ka mundur të ndalonte shkaktimin e dëmit. Me këtë duhet kuptuar se mësuesi apo mjeshtëri ka përbushur si duhet detyrimin e tij për mbikëqyrjen e të miturit apo të atij që mëson një mjeshtëri. Në këtë mënyrë nuk ka pasur faj (*culpa in custodiendo*) pasi nuk ka pasur mundësi të ndalonte dëmin e shkaktuar.

Përgjegjësia e përfaqësuesit.

Kodi Civil në nenin 620 parashikon se: “*Në qoftë se veprimtaria e përfaqësuesit në ushtrimin e pushteteve që i janë caktuar, sjell një përgjegjësi me faj ndaj një të treti, i përfaqësuari është gjithashtu përgjegjës ndaj këtij personi.*”

Siç dihet përfaqësuesi vepron në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit. Kjo gjë është në interes të këtij të fundit i cili për arsye nga më të ndryshmet nuk mund të veprojë vetë. Megjithatë pavarësisht se të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesi konsiderohen si të kryera nga i përfaqësuari, përgjegjësia për shkaktimin e një dëmi gjatë veprimtarisë përfaqësuese zgjidhet nga ligji paksa ndryshe.

Dispozita e sipërcituar parashikon se përfaqësuesi do të përgjigjet për dëmet e shkaktuara për faj të tij ndaj një të treti. Pra që të lindë përgjegjësia e përfaqësuesit, duhet që ky të ketë vepruar me faj të tij. Po ashtu parashikohet se përgjegjësia në këtë rast bie edhe mbi të përfaqësuarin. Këtu lindin dy pyetje.

Së pari, çfarë përgjegjësie është ajo e të përfaqësuarit ? Kemi të bëjmë me një dëm të shkaktuar për faj të përfaqësuesit, për të cilin detyrohet edhe i përfaqësuari. Ky i fundit nuk ka lidhje direkte me dëmin dhe megjithatë detyrohet ta shpërblejë atë., duket se kemi të bëjmë me një përgjegjësi pa faj, e cila mund të jetë parashikuar në interes të të dëmtuarit.

Së dyti, përgjegjësia në fjalë është individuale apo solidare ? Meqenëse bëhet fjalë për shkaktimin e një dëmi të vetëm, për të cilin ligji ngarkon njëkohësisht dy persona si përgjegjës, mendoj se përgjegjësia është solidare.

16. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, në raste të veçanta.

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga ushtrimi i një veprimtarie të rrezikshme.

Kjo përgjegjësi është pranuar nga doktrina si një nga rastet e përgjegjësisë civile pa faj. Kodi Civil e parashikon atë në nenin 622 si vijon: “Personi që kryen një veprimtari të rrezikshme nga natyra e saj ose nga natyra e sendeve të përdorura dhe u shkakton dëm personave të tjerë, detyrohet të shpërblejë dëmin, përveç kur provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit.”

Në këtë mënyrë çdokush që, duke zhvilluar një veprimtari, krijon një rrezik për të tjerët, që lidhet me natyrën e saj apo të mjeteve që përdoren, është i detyruar të shpërblejë dëmin që mund të vijë nga ushtrimi i kësaj veprimtarie.

Personi përgjegjës nuk mund të pretendojë se nuk ka pasur faj në shkaktimin e dëmit, sepse kemi të bëjmë me një përgjegjësi pa faj. Vetëm nëse ai provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit, mund të përjashtohet nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit.

Lidhur me kuptimin e veprimtarisë së rrezikshme, në doktrinën e huaj është pranuar se nuk është e domosdoshme që të bëhet fjalë për një veprimtari të dallueshme nga të tjerat për nga rreziku që ajo krijon. Mjafton kështu që të krijohet një rrezik për të tjerët, që të aplikohet neni 622 në rast të shkakimit të dëmit. Për shembull, edhe një sipërmarrës që është, duke restauruar një rrugë, nëse hap një gropë në mes të saj, krijon rrezikun e mundshëm për ndonjë aksident.

Për këtë arsye ai është i detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme për të shmangur dëmet, duke vënë shenja dalluese të përshtatshme për drejtuesit e automjeteve. Për të përcaktuar se cilat do të jenë masat e përshtatshme e të nevojshme, ato do të vlerësohen të tilla nëse janë marrë të gjitha masat e sigurisë që ofron teknika dhe jo ato që mund të ketë konsideruar si të përshtatshme

personi përgjegjës. Ka sisteme që përfshijnë në këtë përgjegjësi edhe atë për dëmet e shkaktuara nga ndërtesat, nga një send me të meta dhe nga kafsha⁶²

Gjykata në vendimin e saj është shprehur se është pikërisht detyrimi i të paditurit që të mirëmbajë rrjetin e veprimtarisë së tij. Mosmarrja e këtyre masave për riparimin e të metave si masa të përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit, sjell përgjegjësinë e tij për dëmin e shkaktuar⁶³.

Lidhja ndërmjet faktit dhe dëmit të ardhur është baza e kësaj përgjegjësie. Kështu në këtë përgjegjësi subjekti që zhvillon veprimtari të rrezikshme për nga natyra e saj apo e sendeve që përdor konsiderohet përgjegjës nëse ekziston lidhja shkakësore ndërmjet ngjarjes dhe pasojës. Ky subjekt mund t'i shmanget përgjegjësisë vetëm Nëse provon se i ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të shmangur ardhjen e dëmit si pasojë e ngjarjes. Dhe për këtë “faji” si element i domosdoshëm i përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit përmbledhet në detyrimin absolut të marrjes së masave të përshtatshme dhe të nevojshme që në mënyrë të arsyeshme bëjnë të mundur shmangien e dëmit.

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar ndaj mjedisit.

Kodi Civil, neni 624 parashikon se: “Personi që me faj ka cenuar mjedisin, duke e keqësuar, ndryshuar ose dëmtuar atë, tërësisht ose pjesërisht, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.” Me këtë dispozitë ligji ngarkon me përgjegjësi për shpërblimin e dëmit, çdo person që i shkakton një dëm mjedisit. Problemi qëndron se në këtë rast është e vështirë të zbatohet rregulli i përgjithshëm për një dëm ndaj personit apo pasurisë i parashikuar në nenin 608 të Kodit Civil.

Dëmet ndaj ambientit mund të shkaktojnë edhe dëme në shëndetin apo pasurinë e personave të veçantë, por në një rast të tillë të dëmtuarit mund të padisin shkaktuesin e dëmit për të shpërblyer dëmet që u janë shkaktuar atyre personalisht. Por përtej dëmeve shkaktuar personave të veçantë, ekzistojnë edhe dëme të tjera mjaft të rënda, që u janë shkaktuar sendeve që nuk përbëjnë objekt pronësie si atmosfera, ujërat e deteve, liqeneve e lumenjve, dhe ambientit në përgjithësi, do me thënë hapësirës në të cilën zhvillohet jeta e të gjithëve, me karakteristikat e saj jetësore-

⁶² Prof. Dr. Mehdi J. Hetemi, Detyrimet dhe kontratat, Tiranë 1998

⁶³ Vendim nr. 652, datë 22.06.2000

shëndetësore, ekuilibrin ekologjik dhe vlerat kulturore të peizazhit. Cenimi i këtyre ekuilibrave dhe vlerave rezulton sigurisht në fund të fundit, në dëmet ndaj shëndetit dhe cilësisë në përgjithësi të jetës së individëve të veçantë.

Përgjegjësia për publikimet mashtruese.

Kemi të bëjmë përsëri me një përgjegjësi pa faj. Kjo parashikohet nga neni 617 i Kodit Civil si vijon:

“Kur vërtetohet se një person ka përgjegjësi ndaj një personi tjetër, për shkak se ka publikuar të dhëna të pasakta, jo të plota ose mashtruese, gjykata me kërkesën e personit të dëmtuar, detyron personin tjetër që të publikojë një përgënjeshttrim, në mënyrën që ajo do ta quante të përshtatshme.

Gjykata mund të urdhërojë publikimin e përgënjeshttrimit edhe kur vërtetohet se publikimi i të dhënave nuk është i paligjshëm dhe i kryer me faj, se autori i tyre nuk kishte dijeni për karakterin e pasaktë ose të paplotë të këtyre të dhënave.”

Dispozita e mësipërme, më tepër se një përgjegjësi, parashikon mënyrën e shpërblimit në një rast të tillë. Për sa i përket përgjegjësisë së publikuesit, kjo do të lindë, duke mjaftuar një fakt i vetëm: publikimi i të dhënave të pasakta, jo të plota ose mashtruese. Me vërtetimin e një fakti të tillë gjykata urdhëron publikimin e një përgënjeshtrimi. Nuk ka rëndësi nëse personi që ka publikuar të dhënat e pasakta të ketë vepruar me faj do me thënë që ai të ketë ditur për pasaktësinë e të dhënave apo të ketë pasur mundësi për t’i verifikuar ato.

Prova për pafajësinë e personit përgjegjës do të vlente vetëm për ta përjashtuar atë në rast të kërimit nga i dëmtuari për shpërblimin e ndonjë dëmi të ardhur si pasojë e publikimit, qoftë ky pasuror, qoftë moral.

Publikimi mashtrues dhe Konkurrenca e pandershme

Në rastin kur nga veprimi i paligjshëm i përcaktuar si më sipër do t’i shkaktohet dëm një personi të caktuar, autori i publikimit (ose ai që ka shkaktuar publikimin) do të përgjigjet për dëmin e ardhur. Kjo përgjegjësi është një përgjegjësi me faj. Fajësia e autorit të dëmit prezumohet dhe ky do të konsiderohet fajtor përderisa të provojë se nuk ka pasur faj në ardhjen e dëmit (neni 636).

Shpërblimi i dëmit në këto raste përveç shpërblimit të dëmit pasuror që mund të jetë shkaktuar, do të shoqërohet edhe me një shpërblim në natyrë sipas të cilit gjykata do të vendose ndalimin e publikimit mashtrues dhe një përgënjeshtim publik sipas mënyrës që e çmon gjykata. Kjo masë mund të merret edhe atëherë kur nga një publikim i tillë rrezikon t'i shkaktohet dëm një personi të caktuar (neni 637).

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar si rezultat i konkurrencës së pandershme, parashikohet në nenet 638 dhe 639 të Kodit Civil. Neni 638 përcakton se kur kemi të bëjmë me konkurrencë të pandershme. Megjithatë pas daljes së Kodit Civil në vitin 1995 doli një ligj i posaçëm që rregulloi më hollësisht mënyrën e operimit të konkurrentëve në treg. Kështu që për të përcaktuar nëse veprimi është konform rregullave të konkurrencës apo jo, do t'i referohemi krahas Kodit Civil edhe Ligjit "Për konkurrencën". Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga konkurrenca e pandershme është një përgjegjësi me faj e autorit të dëmit. Kjo përcaktohet nga neni 639/II. Kurse në rast se thjesht konstatohet një veprim i cili përbën konkurrencë të pandershme, por pa faj të atij që ka kryer veprimin, do të ndalohet veprimi dhe do të përcaktohen masat e nevojshme që të zh, duken pasojat. Kështu shprehet neni 639/I.

Ngritja e një padie të padrejtë.

Gjykata e Lartë, më tepër se një herë, ka trajtuar raste të dëmit jo pasuror të shkaktuar nga një padi e padrejtë. Pavarësisht mënyrës së përfundimit të çështjeve, janë evidentuar karakteristikat e këtij dëmi.

"Padiësit me kërkesë padinë objekt i shqyrtimit gjyqësor kane pretenduar se nga veprimet e të paditurit i është shkaktuar një dëm jo pasuror.

Konkretisht pretendohet se nga i padituri janë denoncuar për veprën penale të parashikuar nga Neni 309§2 i Kodit Penal dhe përfundimisht për njërin është pushuar çështja penale dhe tjetri ka marre vendim pafajësie të formës së prerë.

Me këto veprime pretendohet se padiësit janë cenuar nga i padituri në nderin dhe dinjitetin e tyre.

Me kundërpadinë e paraqitur nga i padituri është pretenduar se padiësit abuzojnë me të drejtën e padisë, pasi ai nuk ka bërë ndonjë denoncim kundër tyre.

Gjykata e shkallës së parë i ka konsideruar pretendimet e paditësve të vërteta dhe ka pranuar kërkesë padinë.

Gjykata e Apelit e ka lënë në fuqi këtë vendim (ka ndryshuar masën e gjobës).

...Vendimi i gjykatës në arsyetimin e tij është në kundërshtim e ligjin dhe si i tillë duhet të priset.

Neni 625 i Kodit Civil përcakton se personi që shkakton një dem, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur: a)... është cenuar në nderin e personalitetin e tij.

Ne këtë rast ligjvënësi ka parasysht që veprimi të jete i kundërligjshëm dhe me faj, në drejtim të cenimit të nderit dhe personalitetit të personit të dëmtuar. Ankimi i personit në një organ të ngarkuar nga ligja për verifikimin e të dhënave nuk është veprim i kundërligjshëm. për pasojë edhe ankimi i të paditurit, në rastin konkret në organin e Prokurorisë, me mendimin se kemi të bëjmë me një vepër penale nuk është veprim i kundërligjshëm. Është organi përkatës shtetëror, që brenda kompetencave të dhëna nga ligji, bën verifikimin e të dhënave, duke ndjekur rrugën e përcaktuar nga ligji.

Pra në veprimet e të paditurit nuk kemi ndonjë veprim që me faj të këtë cenuar personalitetin e paditësve. Nëse veprimet e kryera nga organi shtetëror janë të kundërligjshme e përligjin paditësin të kërkojë të drejtën e tij në rrugën e shpërblimit të dëmit.

Në këto kushte kërkesë padia duhet të rrezohet.”⁶⁴

Neni 34 i Kodit të Procedurës Civile parashikon në mënyrë të posaçme, pa bërë dallimin midis dëmit material dhe dëmit jo pasuror, mundësinë e shkakimit të dëmit nga ngritja e një padie abuzive.

“Personi që abuzon në të drejtën për të ngritur padi, duke qenë i ndërgjegjshëm për pathemelësinë ose pabazueshmërinë në ligj të saj, ose përdor mashtrimin, mund të dënohet nga gjykata me gjobë deri në 50 000 lekë, pa llogaritur shpërblimin e dëmit që mund të kërkohet.”

Neni 608 i Kodit Civil rregullon elementët bazë që përbejnë përgjegjësinë nga shkaktimi i dëmit.

⁶⁴ Vendim i Kolegjit civil të Gjykatës së Lartë, Nr.8, datë 17.01.2008

Dispozita materiale e Kodit Civil, neni 625/1, shkronja “a”, përkufizon të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit jopasuror:

“Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur:..... është cenuar në nderin e personalitetit të tij;”

Nenet 34 i Kodit të Procedurës Civile dhe 625/1, shkronja “a” i Kodit Civil, janë rrjedhoja të materializimit në legjislacionin tonë të nenit 17 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut:

“Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një shteti, grupimi ose individi, të drejtën që të ndërmarrë ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cenimin e të drejtave ose lirive të njohura në këtë Konventë, ose kufizime më të gjëra të këtyre të drejtave ose lirive të parashikuara gjithashtu në këtë Konventë.”

Në kuptim të këtyre dispozitave, ngritja e një padie abuzive, me shkak material shpifjen me dashje, me synim dhunimin e personalitetit dhe të dinjitetit të subjektit të paditur, përfaqëson të konsumuar të gjithë elementet e përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit jo pasuror.

Nga rrethanat e faktit të një çështje gjyqësore ⁶⁵, në shkakun ligjor dhe juridik të padisë, gjenden të gjithë elementët e përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit jo pasuror, atëherë kur, i padituri, me sjelljen e tij të kundërligjshme, duke përdorur “mjete ligjore” ka synuar të cenojë nderin e personalitetit të paditësve.

Kërkimi i dëmit moral të shkakuar nga i padituri, gjen përkrahje në dispozita ligjore procedurale dhe materiale.

Në aspektin procedural është e mjaftueshme të provohet pathemelësia dhe pabazueshmëria e padisë së padrejtë, e cila është ushtruar nga paditësi, duke e ditur që rrethanat e faktit të përdorura si shkak i padisë, nuk.

Ligji procedural civil, reagimin kundrejt personit që abuzon me të drejtën për të ngritur padi, e rregullon në mënyrë të dyfishtë. Shteti, nëpërmjet dënimit me gjobë dhe individi, nëpërmjet

⁶⁵ “A” ShPK vs B, Tiranë 2010

kërkimit të shpërblimit të dëmit, pa bërë dallim në natyrën e dëmit të shkaktuar, dëm material apo dëm jo pasuror.

Subjekti i dëmtuar nga një padi abuzive, pas vlerësimeve gjyqësore të të gjithë niveleve, pajtohet me përfundimin e arritur nga gjykatat, për faktin që ndodhemi përpara një padie të padrejtë., duke qenë se reagimi i shtetit nëpërmjet gjobës, nuk është i detyrueshëm, për çdo rast që konstatohet abuzim me të drejtën e padisë, është në diskrecionin e tij, të zgjedhë të kërkoj shpërblimin e dëmit jo pasuror.

Dëmi i shkaktuar për këtë shkak, rrethanë e parashikuar nga neni 34 i Kodit të Procedurës Civile, mund të jetë pasuror, jo pasuror, ose i përzier.

Mund të jetë pasuror për shkak të ndikimit të proceseve gjyqësore në pasurinë, rendimentin në pune, mungesën e fitimit, konkurrencën etj. Është jo pasuror, për shkak të cenimit të dinjitetit dhe të dyshimeve që krijohen në korrektesën e sjelljes apo përmbushjes së një detyrimi të të paditurit.

Gjithashtu, pavarësisht se është përdorur si shkak i një padie gjyqësore, në rrethanën e faktit të parashtruar si shkak i padisë, i fakteve haptazi të pavërteta, që përmbajnë elementë formalë të shpifjes, duke përdorur gjykimin, përhapen thënie të pavërteta, të cilat për shkak të pavërtetësisë së hapur të tyre klasifikohen si shpifje.

Në raste të tilla, me veprimtarinë në vazhdim, autori (paditësi) synon të dhunojë dinjitetin dhe personalitetin e të paditurit. Në kohë të ndryshme, në gjykatat e të gjitha niveleve, padia gjyqësore, me përmbajtje të pavërtetë i është bërë e njohur publikut.

Një fakt i tillë cenon rëndë dinjitetin dhe personalitetin e të dëmtuarve si persona fizikë, gjithashtu, ai drejtohet kundër marrëdhënieve të besimit, marrëdhënie mbi të cilat është ndërtuar veprimtaria shoqërore apo publike e tij. Autori, me dashje të kundërligjshme, ka kryer veprime konkrete në shkelje dhe në mashtrim të ligjit, të cilat kanë passjell dëmin pasuror dhe jopasuror.

Pretendimi se është ushtruar e drejta e padisë është i pabazuar në fakt dhe në ligj. Autori i një padie abuzive, gjithmonë është në dijeni të pavërtetësisë së rrethanave që ka parashtruar, në fund të fundit, të pamundësisë së tij për të kërkuar gjyqësisht të drejta që nuk i takojnë.

Në gjykimin e këtyre çështjeve, vëmendja e gjykatës, në mungesë të jurisprudencës vendase, duhet të drejtohet drejt praktikës gjyqësore të krijuar nga Gjykata e të Drejtave të Njeriut, që për çdo rast paditë e padrejta i ka konsideruar si shkak të cenimit të dinjitetit dhe personalitetit, si shkak të shkakimit të dëmit jo pasuror.

Në rastet kur ky dëm nuk është shpërblyer nga individi që e ka shkaktuar, për çdo rast të paraqitur në gjykim pranë Gjykatës së të Drejtave të Njeriut, ka qenë shteti ai që ka zhdëmtuar.

Gjithashtu, si orientim i gjykatave për krijimin e bindjes në ekzistencën e dëmit jo pasuror mund të shërbejë dhe jurisprudenca e niveleve më të larta gjyqësore, të vendeve të tjera evropiane.

Në vendimin Nr.2515, datë 21.02.2002, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës Italiane të Kasacionit, midis të tjerave arrihet në përfundimin: *“Rrjedhoja e parë e një padie të padrejtë është patjetër një vuajtje e thellë e brendshme, një dëmtim i padrejtë i shkaktuar nga paligjshmëria e veprimt ose një dëm moral.”*

Po Gjykata Italiane e Kasacionit në Vendimin Nr.25171, datë 03.12.2007 përcakton se: *“Dëmi moral është konsekuencë e dhunimit të nderit dhe reputacionit të subjektit”*.

Dëmi jo pasuror i shkaktuar në fushata zgjedhore, rrjedhojë e shpifjeve, fyerjeve apo informacioneve të pasakta.

Nga fakti i paligjshëm, fjalimi me përmbajtje shpifëse apo fyese, botime fotografish komprometuese apo përhapje e një informacioni të pavërtetë me synim përballje elektorale, cenon të drejta dhe interesa të ligjshme personale dhe pasurore, me rrjedhojë lindjen e të drejtës subjektive për kërkuar (*ius proprius*) dëmshpërblimin e dëmit jo pasuror të pësuar. Ky legjitimim aktiv, në parim, kushtëzohet dhe është rrjedhojë vetëm e cilësisë të të dëmtuarit nga fakti i paligjshëm.

Subjekti që ka ndryshuar, duke cenuar me akte dhe sjellje të paligjshme, normalitetin dhe detyrimet e bashkëjetesës së qetë, konsiderohet autori i kundërligjshmërisë, i cili pas paraqitjes së padisë, gëzon dhe legjitimimin pasiv.

Edhe në këto raste objekti i padisë përfaqësohet nga kërkimi për shpërblimin e dëmit jo pasuror të shkakuar me faj. Bazueshmëria në ligj dhe pranueshmëria e kërkimeve janë të lidhura me konsumimin e elementëve që përbëjnë përgjegjësinë nga shkaktimi i dëmit, të përcaktuar në nenin 608 të Kodit Civil.

Përgjegjësia në shkaktimin e dëmit jo pasuror, kërkon të njëjtët elementë fajësie sikurse në dëmin pasuror. Në rrethanat e faktit të vërtetuara gjyqësisht duhet të identifikohen subjekti i kundërligjshmërisë civile, i cili me sjelljet dhe veprimet e tij ka zbuluar fajin, ana objektive që përfaqësohet nga veprimet e kundërligjshme të kryera, e cila provon njëkohësisht dhe lidhjen shkakësore midis faktit dhe cenimit moral të pësuar, si dhe dëmi jo pasuror i shkakuar.

Pikërisht vlerësimi dhe vërtetimi i rrethanave të faktit e udhëheq bindjen e gjykatës në pranimin e faktit, të konsumimit apo jo të elementëve të përgjegjësive nga shkaktimi i dëmit.

Fakti i kundërligjshëm përfaqësohet nga sjellja e autorit, përgjatë komunikimit me publikun në fushatë personale për tërheqjen e zgjedhësve. Kundërligjshmëria e shkrimeve, e fjalimeve apo botimeve, kryesisht dhe në tërësi, duhet të verifikohet dhe të lidhet me faktin që ato janë të ndërtuara në bazë të të dhënave të pavërteta dhe, që autori, kur i ka përgatitur dhe bërë publike të ketë qenë në dijeni që faktet e publikuara kanë qenë të pavërteta.

Fakti i kundërligjshëm e merr cilësinë dhe nga mungesa e të drejtës së autorit, për të përdorur shpifjen, fyerjen dhe rrethana të tjera të pavërteta në drejtim të dinjitetit dhe të personalitetit të të dëmtuarit. Cilido ndalohet të cenojë dinjitetin dhe personalitetin e tjetrit, në çdo mënyrë shprehjeje apo veprimi, dinjitet dhe personalitet i cili mbrohet jo vetëm nga morali dhe zakonet e mira, por dhe nga ligji.

Subjekt i përgjegjësive në shkaktimin e dëmit jo pasuror mund të jetë person fizik ose juridik. Prania e subjektit në përgjegjësinë civile nuk lidhet me cilësi të posaçme të tij. Nenet 608 dhe 625 të Kodit Civil, sikurse të gjitha dispozitat e tjera materiale e procedurale, që rregullojnë përgjegjësinë juridike civile, nuk veshin me “imunitet” asnjë lloj subjekti të përgjegjshëm për veprimet që kryen.

Ana subjektive qëndron në dashjen direkte të kryerjes së kundërligjshmërisë me objekt cenimin e dinjitetit në personalitetin e të dëmtuarit.

Pavarësisht se forma e dashjes, direkte apo në cilësinë e pakujdesisë së rëndë, nuk është domosdoshmëri për përcaktimin e përgjegjësive civile, gjatë veprimtarisë së kundërligjshme, gjithashtu dhe gjatë gjykimit, duhet të rezultojë e vërtetuar përtej çdo dyshimi, që i padituri në kundërligjshmërinë e tij, të ketë vepruar me dashje direkte ose pakujdesi të rëndë.

Dashja është shprehje e vlerësimeve psikike të individit ndaj një fakti të kundërligjshëm ose, për kryerjen apo moskryerjen e një veprimi të caktuar. Vlerësimi pozitiv, nga ana e të paditurit, i fakteve të rreme dhe thënieve që përbëjnë fyerje, janë shprehje e dashjes direkte.

Ana objektive e kryerjes së kundërligjshmërisë në rrethanën e faktit që përbën shkakun e padisë përfaqësohet nga “shkrimet”, komunikimi publik i subjektit, në formën e bisedave apo të fjalimeve, me zgjedhësit.

Konsumimi i anës objektive si rregull, është në harmoni me synimet e kundërligjshme të subjektit. Pa këtë mënyrë konsumimi të kundërligjshmërisë subjekti nuk mund të realizojë synimin e kundërligjshëm për të cenuar paditësin në dinjitetin e personalitetit të tij.

Objekti i përgjegjësive civile në dëmin jo pasuror, në veprimtarinë e subjektit, përfaqësohet nga dhunimi i dinjitetit nëpërmjet shpifjes dhe fyerjes të bërë botërisht.

Dëmi jo pasuror, në veçanti ai që përfaqësohet nga cenimi i nderit në personalitetin e paditësit, nga pikëpamja procedurale konsiderohet i provuar, vetëm me vlerësimin dhe pretendimin e palës së cenuar. Në këtë përfundim arrihet, pasi kemi mbajtur parasysh praktikën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Nr.12, datë 14.09.2007.

Objekti i kundërligjshmërisë në rastin e dëmit jopasurore (moral) është gjithmonë personaliteti i paditësit. Shprehjet e përdorura, vlerësimet negative, rrethana të pavërteta të përhapura në publik, në formën dhe në përmbajtjen e tyre, janë të lidhura vetëm me emrin dhe veprimtarinë e paditësit.

Ndërsa veprimtaria e subjektit, e cilësuar si fakt i kundërligjshëm, përbën cenim të dinjitetit në personalitetin e paditësit. Cenimi i dinjitetit shkakton tek i dëmtuari shqetësim dhe vuajtje dhe kur përpjekjet për të mënjeluar dëmin jo pasuror të shkaktuar nuk kanë gjetur mirëkuptimin e subjektit, vijon ndërmarrja e veprimtarisë civile për mënjanimin e tyre.

Dëmi moral i shkaktuar nga veprimtaria e kundërligjshme e subjektit, përtej prezumimit ligjor, provohet dhe nga ndikimi në psikikën e paditësit. Një veprimtari e tillë shkakton zemërim, neveri dhe gjendje të përafërta shpirtërore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në shëndetin e të dëmtuarit.

Në zbatim të nenit 609 të Kodit Civil, për pranimin e përgjegjësisë civile jashtëkontraktore, duhet të vërtetohet lidhja shkakësore materiale ndërmjet sjelljes së paligjshme e me faj dhe dëmit të shkaktuar.

Lidhja shkakësore e kërkuar nga ligji dhe Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë kërkohet në rrethanën e faktit të pretenduar. Veprimet e kundërligjshme të të paditurit, duke pasur për objekt errësimin dhe përcëlimin e personalitetit të paditësit, me përmbajtje të rreme dhe fyese, drejtohen vetëm kundër dinjitetit dhe nderit të tij.

Përmbajtja e këtyre veprimeve nuk tregon dhe nuk mund të tregojë, interesa dhe synime të mira të të paditurit, në drejtim të prezantimit të detyrave të tij në publik. Ato janë haptazi me synim cenimin e dinjitetit të paditësit. Ky argumentim, plotëson dhe tregon praninë e lidhjes midis veprimeve të kundërligjshme të të paditurit (shpifje, fyerje), me pasojat e prezumuara të shkaktuara në drejtim të nderit të paditësit.

Rregullimi material në Kodin Civil, e përjashton paditësin nga detyrimi për të provuar fajësinë e të paditurit në kryerjen e kundërligjshmërisë që ka sjellë si rrjedhojë dëmin jo pasuror.

Në raste të tilla, në mbrojtje të dinjitetit dhe të personalitetit të njeriut është jo vetëm ligji material, por dhe jurisprudenca vendase, e Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese, si dhe praktika e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut.

Në vendimin e datës 17 dhjetor 2004, në gjykimin e kërkesës Pedersen kundër Danimarkës, Gjykata e të Drejtave të Njeriut e kufizon të drejtën e gazetarit vetëm në dhënien e gjykimeve

vlerësuese, duke konsideruar cenim të së drejtës së tjetrit prezantimin e deklaratave faktike, të rreme apo të pavërtetuara.

Në vendimin Nr.1986 datë 25.11.2004, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, gjatë gjykimit të padisë së V.U. kundër Top Chanel, midis të tjerave dallon elementë të tillë që kanë të bëjnë me ndërgjyqësinë, legjitimitimin, shkakun dhe objektin, duke përcaktuar natyrën e dëmit jo pasuror dhe mënyrën e dëmshpërblimit.

17. Dëmi jopasuror dhe praktika Unifikuese e Gjykatës së Lartë, rrjedhim i praktikës së Kolegjit Civil.

Në vendimin Nr. 1230 datë 02.11.2006, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, gjatë gjykimit të padisë së R.R. etj kundër Gazeta “Dita”, midis të tjerave shprehet:

“... Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vëren se rasti në shqyrtim duhet të konsiderohet shkaktim dëmi moral (jo pasuror) ndaj nderit dhe personalitetit të paditësve dhe ky dëm duhet të shpërblehet nga pala e paditur.

Gjithashtu, ekziston edhe fajësia si element i domosdoshëm i kësaj përgjegjësie. Është e vërtetë që nuk është pranuar e provuar dashja dhe qëllimi i posaçëm për të cenuar nderin dhe personalitetin e paditësve, por ndërkohë provohet pakujdesia e rëndë e palës së paditur.

I takonte barra e provës palës së paditur për të provuar mungesën e fajësisë, gjë që nuk ka mundur ta bëjë. Referuar neneve 608 dhe 625/a të Kodit Civil, për të pasur përgjegjësi për shpërblimin e dëmit, mjafton që veprimi i kundërligjshëm të kryhet me faj, si në formën e dashjes, ashtu edhe në formën e pakujdesisë.... Nëse përjashtohet dashja për të diskredituar paditësit, pakujdesia e rëndë e treguar, si element i anës subjektive të dëmit jo pasuror, ka bërë që ata të ndjehen të prekur në nderin dhe personalitetin e tyre përpara një publiku të gjerë që i respekton dhe i nderon si artistë të shquar.”

Në vendimin Nr. 12 datë 14.09.2007, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, unifikojnë praktikën gjyqësore, midis të tjerave në objektin “Çfarë do konsiderohet dëm jo pasuror dhe kush janë kriteret e përcaktimit të tij në këto raste?”

Konkluzionet kryesore të vendimit unifikues, që lidhen dhe mbulojnë tërësisht dhe me objektin dëmet moral janë:

“...Dëmi jopasuror, i parashikuar në nenin 625 të Kodit Civil, si një kategori e gjere dhe gjithëpërfshirëse e dëmeve jashtëkontraktore, përfshin çdo lloj dëmi të pësuar nga cenimi i të drejtave dhe interesave jopasurore që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut dhe që nuk janë subjekt vlerësimi të drejtpërdrejtë ekonomik në treg. Në thelbin e saj, kjo dispozitë njeh të drejtën e dëmshpërblimit për çdo lloj dëmi jopasuror Jashtëkontraktor, i cili është ‘i ndryshëm nga ai pasuror’. Rënditja e “rasteve” të dëmit jopasuror në paragrafët “a” dhe “b” të saj, nuk ka për qëllim të kufizojë, por të rregullojë në mënyrë të shprehur, për efekte të dallueshmërisë së cenimeve, të drejtën e dëmshpërblimit përkatës dhe rrethin e subjekteve që gëzojnë legjitimim aktiv....

...Dëmi moral (*pretium doloris* ose *pecunia doloris*) është shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit të padrejtë (*non iure perturbatio*) të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm. Cilido që pëson cenime në sferën e shëndetit dhe të personalitetit të tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj të një të treti, ka të drejtën të kërkojë edhe dëmshpërblimin e dëmit moral të pësuar.

Barra e provës për vërtetimin e dëmit moral është e paditësit. Por, nisur nga natyra subjektive e këtij dëmi dhe veçanërisht nga karakteri, shfaqja e brendshme e tij, vërtetimi i cenimit të personalitetit të të dëmtuarit në turbullime, dhimbje e vuajtje shpirtërore, etj., nuk mund të provohet në mënyrë tjetër përveçse, duke i vlerësuar *ius receptum*, si të mbështetura ligjërisht dhe, duke i çmuar si të provuara *ipso iure* me vërtetimin nga paditësi të vetë faktit të paligjshëm të të tretit dhe lidhjes së këtij fakti me cenimin moral të pësuar, sipas parimit të rregullshmërisë shkakësore.

Duke qenë provë në formën e prezumimit të thjeshtë, nëse autori i dëmit nuk arrin të vërtetojë të kundërtën, ajo merr të njëjtën vlerë e fuqi të plotë provuese si Kurse prezumimi ligjor *iuris tantum* (neni 13 i Kodit të Procedurës Civile).

Dëmi jo pasuror është i njohur qartësisht dhe nga doktrina bashkëkohore. Në këtë diskutim, përjasje më e afërt e trajtimeve shkencore me rrethanën konkrete të faktit, gjendet në studimet dhe punimet shkencore të kohëve të fundit:

P. Szollosy "Vlerësimi i dëmit rrjedhojë e moskuptimeve në vende të ndryshme evropiane", Zurich, 2007.

Giovanni Battista Petti: "Shpërblimi i dëmit biologjik, e drejta aktuale", UTET.

G. Giannini e M. Pogliani, Giuffrè: "Dëmi dhe paligjshmëria civile", 1997.

Ë. Brondolo, A. Marigliano: "E drejta dhe dëmi psikik", 1996,

Ugo dal Lago, Edvige Bressan dhe Alessandra Casarotto: "Shpërblimi i dëmit në rastet e shpifjeve" 2008

Përafrimi i legjislacionit dhe i kuptimeve ndër-evropiane do të sjellin mundësira të një kuptimi dhe interpretimi më të qartë në cilësimin dhe vlerësimin e dëmit të shkaktuar në rrethanat e faktit të parashtruara.

18. Shpërblimi i dëmit.

Nëse përgjegjësia penale ka për qëllim dënimin e autorit të veprës penale, përgjegjësia civile e gjen qëllimin e saj në shpërblimin e dëmit. Detyrimi për dëmshpërblim lind në të njëjtën kohë me shkaktimin e dëmit, por kredia që rrjedh nga ky dëm do të mbetet e tillë në potencial, përderisa ajo nuk është njohur vullnetarisht ose konstatuar në rrugë gjyqësore.

Dhe siç nuk është e përditshme në natyrën e njeriut pranimi i gabimeve të tij, shpesh një proces gjyqësor është i nevojshëm për t'i dhënë shpërblim të dëmtuarit. Por nuk është e thënë që çdo shpërblim për dëmin e shkaktuar të kalojë nëpër një proces gjyqësor. Zgjatja në kohë e procedurave, kosto e gjykimit do të nxisë shpesh interesin për të arritur një zgjidhje jashtëgjyqësore me marrëveshje të palëve.

Marrëveshja për shpërblimin e dëmit.

Në praktikë, një nga mundësitë për shpërblimin e dëmit është marrëveshja midis të dëmtuarit dhe personit përgjegjës për dëmin. Kjo marrëveshje nuk mund të aplikohet në ato raste, kur palët nuk merren vesh për zgjidhjen e çështjes, përderisa nuk ka një përputhje të vullnetit të tyre.

Jo në pak raste, marrëveshje të tilla janë problematike. Nga njëra anë mund të ndodhë që shumat e ofruara të jenë shumë më të ulëta se dëmi i shkaktuar. Të dëmtuarit i pranojnë nën presionin e nevojës së momentit apo si rezultat i pesimizmit ndaj një procesi që mund të vazhdojë shumë gjatë. Nga ana tjetër i dëmtuari mund të mendojë se aksidenti ka qenë i parrezikshëm, por vetëm pak kohë pas nënshkrimit të marrëveshjes, manifestohen keqësime të rënda të gjendjes së tij.

Në rastin kur i dëmtuari pranon një marrëveshje të tillë, ai duhet të jete i ndërgjegjësuar që është realizuar një kontratë e lidhur mes dy palëve dhe si e tillë ajo ka forcën e ligjit për palët⁶⁶.

⁶⁶ Neni 609 i Kodit Civil.

Në fakt, ajo do t'u nënshtrohet dispozitave mbi veprimet juridike dhe pavlefshmërinë e tyre. Në këtë mënyrë të dëmtuarit nuk i ngelet tjetër veçse të godasë marrëveshjen për pavlefshmëri, në rast vesimi të vullnetit të tij.

Mënyra e shpërblimit të dëmit.

Lidhur me këtë çështje është i njohur parimi i shpërblimit në natyrë. Kjo do të ishte edhe mënyra më e përshtatshme e shpërblimit të dëmit.

Shpërblimi në natyrë ka si qëllim rivendosjen e të dëmtuarit në gjendjen e mëparshme "statu quo ante". Por kjo mënyrë ideale e shpërblimit nuk është shumë e përdorur.

Në shumicën e rasteve shpërblimi konsiston në derdhjen, pagimin e një shumë të hollash, të përbërë nga humbja dhe fitimi i munguar në favor të të dëmtuarit. Ky është *shpërblimi ekuivalent*.

Kodi Civil nuk parashikon ndonjë dispozitë të veçantë lidhur me mënyrën e shpërblimit të dëmit. Kjo çështje zgjidhet rast pas rasti nga gjykata, duke pasur parasysh që mënyra e shpërblimit të jetë në funksion të vetë qëllimit, domethënë të kthimit të të dëmtuarit në gjendjen e mëparshme.

Në rastin e dëmit jo pasuror, praktika gjyqësore jona ka krijuar dhe lejuar disa mundësi të shpërblimit të dëmit:

“Është e vërtetë që pas ngritjes së padisë (date 16.09.2003) pala e paditur ka bërë përgënjeshttrimin dhe ka kërkuar ndjese (date 10.10.2003), por ky veprim i saj nuk e shkarkon nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit moral. për me tepër, kjo nuk mund të shërbejë edhe si justifikim për të pakësuar në mënyrë të ndjeshme masën e dëmshpërblimit, sepse përgënjeshtrimi dhe kërkimi i ndjesës është bërë me shume vonese dhe pas depozitimit të padisë në gjykate..”⁶⁷.

Megjithatë ka raste kur vetë lloji i dëmit imponon si mënyrë shpërblimi atë në natyrë. Në rastin e një publikimi mashtrues apo të pasaktë, gjykata mund të detyrojë personin përgjegjës që të

⁶⁷ Vendim Nr.1230, datë 12.11.2006 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

publikojë një përgënjeshtim me shpenzimet e tij. Po kështu gjykata mund të marrë edhe masa të tjera si shkatërrimin e botimeve që përmbajnë publikimin mashtrues.

Një shpërblim i këtij lloji mund të vendoset krahas një shpërblimi në të holla, edhe në rastin e dëmit moral të cenimit të nderit të personit. Në të tilla raste shpërblimi në natyrë përshtatet me natyrën e dëmit, duke qenë i domosdoshëm për një shpërblim të plotë të dëmit.

19. Mënyra e shpërblimit të dëmit në varësi të llojit të tij.

Shpërblimi i dëmit jo pasuror.

Në parim, përveç prezumimit të thjeshtë mbi ardhjen e pasojës morale, për caktimin e masës së dëmshpërblimit, gjykata mban parasysh se çdo individ ka personalitetin e tij, unik dhe të ndryshëm nga të tjerët. Prandaj, edhe shkalla e vuajtjes së pasojave morale dhe masa konkrete e dëmshpërblimit mund të ndryshojë rast pas rasti.

Shuma e dëmshpërblimit për dëmin moral, për shkak të natyrës subjektive dhe të brendshme të tij, nuk mund të llogaritet mbi tabela dhe skema të parallogaritura vetëm për këtë qellim.

Prandaj, gjykata e cakton atë mbështetur në parimin e dhënies se drejtësisë sipas bindjes se saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre, duke u mbështetur edhe në kritere eventuale normative të zbatueshme sipas natyrës së të drejtës së cenuar ose, në mungese të tyre, në kritere dhe elemente vlerësimi të konsoliduar nga praktika gjyqësore në zgjidhjen e çështjeve analoge ose në përvoja përkatëse jashtëgjyqësore, duke pasur gjithnjë parasysh zhvillimin aktual ekonomik e social të vendit, përfshirë vlerën e parasë në ekonominë kombëtare.”

Shpërblimi i dëmit pasuror.

Shpërblimi i dëmit pasuror parashikohet në nenin 640 të Kodit Civil sipas të cilit:

“Dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar.

Shpërblehen gjithashtu shpenzimet e kryera në mënyrë të arsyeshme për të shmangur ose pakësuar dëmin, ato që kanë qenë të nevojshme për të përcaktuar përgjegjësinë dhe masën e dëmit, si dhe shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin në rrugë jashtëgjyqësore.”

Siç parashikohet edhe në paragrafin I të dispozitës, personi që ka shkaktuar dëmin do të përgjigjet në bazë të parimit të shpërblimit të plotë të tij.

Kjo do të thotë se ai do të shpërblejë si humbjen e pësuar (damnum emergens), ashtu edhe fitimin e munguar (lucrum cessans) si rezultat i shkaktimit të dëmit. Vetëm, duke pranuar një sistem të tillë shpërblimi do të mund të themi se e kemi kthyer të dëmtuarin në gjendjen e mëparshme.

Për sa u përket dëmeve pasurore, humbja e pësuar do të vlerësohej në bazë të shumës së parave që përbën vlerën e të drejtës së cenuar. Kjo vlerë duhet llogaritur sipas çmimit të tregut dhe kërkesë-ofertës.

Gjithashtu Kodi Civil ka parashikuar se në masën e shpërblimit do të llogariten edhe të gjitha shpenzimet e tjera të kryera këto, si për të shmangur apo pakësuar dëmin, ashtu edhe për procedurat e vlerësimit të tij dhe zgjidhjen e çështjes me marrëveshje të palëve.

Shpërblimi i dëmit të shkaktuar në shëndetin e një personi.

Kodi Civil parashikon në nenin 641 shpërblimin e dëmit në rast të dëmtimit të shëndetit. Kështu: *“Personi që i ka shkaktuar tjetrit një dëm në shëndetin e tij, detyrohet ta shpërblejë dëmin, duke pasur parasysh humbjen ose pakësimin e aftësisë për punë të të dëmtuarit, shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij, si dhe shpenzime të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar.”*

Ne rastin e shkaktimit të një dëmi në shëndetin e personit mund të thuhet se parimi i shpërblimit në natyrë për të cilin u fol më lart, nuk mund të aplikohet. Kjo për vetë llojin e dëmit si pasojë e të cilit cenohet integriteti fizik i personit të dëmtuar.

Nga shkaktimi i një dëmi të tillë të dëmtuarit i lind e drejta të kërkojë si shpërblimin e dëmeve pasurore të pësuar, ashtu edhe shpërblimin e dëmit moral në bazë të nenit 625 të Kodit Civil. Neni 641, i sipërcituar trajton mënyrën e shpërblimit të dëmeve pasurore të shkaktuara si rezultat i dëmtimit të shëndetit.

Në zbatim të kësaj dispozite, personi përgjegjës do të shpërblejë së pari, dëmin e shkaktuar si pasojë e humbjes apo pakësimit të aftësisë për punë. Kur flasim për një dëm të tillë duhet të kemi parasysh se kemi të bëjmë me një të dëmtuar që ka një moshë pune. Pra, nuk mund të kërkojnë një shpërblim për humbjen apo pakësimin e aftësisë për punë as një i mitur nën 16 vjeç, as një madhor që ka mbushur moshën për pension.

Së dyti, me rastin e dëmtimit të shëndetit, personi i dëmtuar ka të drejtë të kërkojë si shpërblim, shpenzimet mjekësore që i janë dashur të bëjë për shkak të dëmtimit të shëndetit. Po ashtu ai mund të kërkojë edhe çdo shpenzim tjetër që ka lidhje me dëmin e shkaktuar. Këtu mund të përmendim nevojën e një personi të paralizuar për shembull, për të pasur një person në shërbim të tij.

Dhënia e një shpërblimi në favor të të dëmtuarit si pasojë e dëmtimit në shëndetin e tij nuk përbën gjë të gjykuar, në kuptimin që ky shpërblim nuk mund të ndryshojë. Përkundërti masa e shpërblimit mund të rishikohet dhe ndryshohet në të ardhmen me kërkesë të personit të interesuar. Ky ndryshim do të varet nga ndryshimi i kushteve në të cilat u vendos një masë e caktuar shpërblimi. Këto kanë të bëjnë me përmirësimin apo rëndimin e gjendjes shëndetësore të të dëmtuarit, me shtimin apo pakësimin e aftësisë për punë krahasuar me kohën kur u vendos shpërblimi dhe me ndryshimin e pagës së të dëmtuarit.

Shpërblimi i dëmit me rastin e shkakimit të vdekjes.

Në rastin e shkakimit të vdekjes në dallim me atë të dëmtimit të shëndetit, personi i cili mund të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nuk është viktima direkte, por persona të tretë. Këta të fundit mund të kërkojnë shpërblimin vetëm të dëmeve pasurore që kanë pësuar, si rrjedhim i shkakimit të vdekjes se personit që ka qenë viktima direkte. Lidhur me këtë neni 643 i Kodit Civil, parashikon se:

“Kur është shkaktuar vdekja e një personi, dëmi që duhet të shpërblejë përbëhet nga:

- a) shpenzimet për ushqim e jetesë të fëmijëve të tij të mitur, të bashkëshortes dhe prindërve të paaftë për punë që kanë qenë në ngarkim të të vdekurit, plotësisht ose pjesërisht, si dhe të personave që banonin në familjen e të vdekurit dhe që gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit;*
- b) shpenzimet e duhura për varrimin e të vdekurit, në masën që ato i përgjigjen rrethanave personale e familjare të të vdekurit.*

Personi që ka shkaktuar dëmin mund të kundër drejtë të njëjtat mjete mbrojtëse që do t'i kundër drejtonte të vdekurit.

Gjykata, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, mund të vendose që shpërblimi të jepet në natyrë, ose në para, njëherësh ose me këste.”

Nga dispozita e mësipërme dallohet se cilët janë personat e dëmtuar dhe në çfarë konsiston dëmi që ata mund të kërkojnë nga autori që ka shkaktuar vdekjen. Kështu, përfitojnë si shpërblim dëmi me rastin e vdekjes së një personi këta persona: fëmijët e mitur të të vdekurit, bashkëshortja e tij, prindërit e paaftë për punë që kanë qenë plotësisht ose pjesërisht në ngarkim të të vdekurit, personat që banonin në familjen e të vdekurit dhe që gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit.

Personat e përmendur kanë të drejtë të kërkojnë shpërblimin e dëmit që përbëhet nga shpenzimet për ushqim e jetesë. Gjithashtu personi përgjegjës detyrohet të shpërblejë shpenzimet e varrimit të të vdekurit, duke pasur parasysh gjendjen dhe mundësitë e familjes së tij.

Shpërblimi i dëmit në këtë rast do të bëhet në mënyrën që e çmon gjykata në bazë të rrethanave konkrete të çdo çështjeje. Kështu ajo mund të vendose që shpërblimi i dëmit të behet në natyrë ose në të holla. Në rastin e fundit shpërblimi mund të jepet njëherësh, në total ose me këste.

Kodi Civil i vitit 1929, parashikonte shprehimisht të drejtën për shpërblimin e dëmit të shkaktuar si rrjedhim i vuajtjes nga vdekja e një njeriu të afërm. Kjo e drejtë përfshinte në rrethin e personave të dëmtuar si gjininë, ashtu edhe krushqinë e afërt, pra një numër jo të vogël personash.⁶⁸

Në lidhje me shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga humbja e të afërmit të familjes mund të zbatohen edhe standardet e vendosura nga gjykatat. Në praktikën tonë gjyqësore janë bërë përpjekje serioze në lidhje me vlerësimin e dëmit të shkaktuar. Gjykatat udhëhiqen nga rrethanat e çështjes, të vlerësuara në bazën e kriterëve të përcaktuara në akte nënligjore, duke i interpretuar ato në mënyrë subjektive.

“Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së lartë arrijnë në përfundimin unifikues se: Dëmtimi i shëndetit (demi biologjik) përbën, në thelb, cenimin e se mirës se shëndetit, të integritetit fizik

⁶⁸ Neni 1160 i Kodit Civil të vitit 1929.

dhe/ose psikik të njeriut. Ky dëm jopasuror, i parashikuar nga shkronja “a” e nenit 625 të Kodit Civil, është objekt kërkimi dhe dëmshpërblimi i pavarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore të pësuar nga i dëmtuari për shkak të të njëjtit fakt të paligjshëm.

Gjithashtu, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se: Meqenëse jeta dhe shëndeti i njeriut nuk ka çmim, në respektim të parimit themeltar kushtetues të barazisë përpara ligjit dhe ndalimit të diskriminimit sipas nenit 18 të Kushtetutës, gjykata duhet të garantojë një gjykim uniform dhe vlerësim të njëjtë të përqindjes e të masës së dëmshpërblimit të dëmit biologjik, për çdo formë e shkalle konkrete të cenimit të përhershëm a përkohshëm të integritetit fizik ose psikik të të dëmtuarit, nëse mosha është e njëjtë dhe po i njëjtë është edhe lloji i dëmtimit shëndetësor fizik a psikik të pësuar.”⁶⁹

Me padinë e vet shtetasi A.M. ka kërkuar shumën 2.000.000.000 Lekë, si shpërblim të dëmit jo pasuror të shkaktuar nga humbja e bashkëshortes, si rrjedhojë e rrëzimit të një banese. Kërkimi, i krahasuar me standarde evropiane, të vendosura nga GJEDNJ apo Gjykatat Evropiane, rezultoi i tepruar.

Gjykatat italiane si rregull orientohen nga të ashtuquajturat tabela të Milanos, të cilat kanë vendosur standardin e dëmit jo pasuror në rastin e humbjes së bashkëshortit, midis vlerave 150.000 deri në 300.000 Euro (Tabelat e Milanos për vitin gjyqësor 2009.)

Vlerësimi i dëmit jo pasuror sipas këtyre tabelave afrohet me vlerat efektive, të aplikuar edhe nga gjykatat.

Nuk ka asnjë pengesë që nëpërmjet akteve nënligjore, unifikimit të praktikave apo edhe ligjit të standardizohet brenda kufijve të përshtatshëm vlera e dëmit moral. Gjykata nuk ka vlerësuar si duhet rëndësinë e faktit të kundërligjshëm dhe pasojat e rrjedhura prej tij.

Masa e dëmit të kërkuar nga paditësit është në vlerësimin subjektiv të tyre. Është detyrë e gjykatës, që në tërësinë e rrethanave të vërtetuara gjyqësisht, të përcaktojë dëmin e shkaktuar nga i padituri. Gjykatat, duhet të orientohen, së paku nga Vendimi Unifikues i cituar, në të cilin përcaktohet se:

⁶⁹ Vendim Unifikues Nr.12, datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

"Shuma e dëmshpërblimit për dëmin moral, për shkak të natyrës subjektive dhe të brendshme të tij, nuk mund të llogaritet mbi tabela dhe skema të parallogaritura vetëm për këtë qellim. Prandaj, gjykata e cakton atë mbështetur në parimin e dhënies së drejtë sipas bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre, duke u mbështetur edhe në kritere eventuale normative të zbatueshme sipas natyrës së të drejtës së cenuar ose, në mungesë të tyre, në kritere dhe elemente vlerësimi të konsoliduar nga praktika gjyqësore në zgjidhjen e çështjeve analoge ose në përvoja përkatëse jashtëgjyqësore, duke pasur gjithnjë parasysh zhvillimin aktual ekonomik e social të vendit, përfshirë vlerën e parasë në ekonominë kombëtare."

Është pikërisht vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë i cituar, i cili jo vetëm elementin dëm, por edhe vlerën e tij, e shoqëron me vlerësimin subjektiv të paditësit, të të dëmtuarit. Ky vlerësim duhet të gjejë pasqyrim në rrethanat që formësojnë bindjen e brendshme të gjykatës, në harmoni edhe me "të gjitha rrethanat e çështjes në tërësinë e tyre, duke u mbështetur edhe në kritere eventuale normative të zbatueshme sipas natyrës së të drejtës së cenuar ose, në mungesë të tyre, në kritere dhe elemente vlerësimi të konsoliduar nga praktika gjyqësore në zgjidhjen e çështjeve analoge ose në përvoja përkatëse jashtëgjyqësore.

Sigurimet shoqërore dhe shoqëritë e sigurimit. Roli i tyre në shpërblimin e dëmit.

Në nenin 645 të Kodit Civil parashikohet rasti kur personi i dëmtuar në shëndetin e tij, apo të cilit i është shkaktuar vdekja, përfiton nga fondi i sigurimeve shoqërore. Nëse kemi të bëjmë me një rast të tillë, sigurimet shoqërore do t'i akordojnë shumën përkatëse të dëmtuarit. Ky i fundit ka të drejtë që të kërkojë nga personi përgjegjës diferencën e dëmit, që nuk mbulohet nga sigurimet shoqërore. Po ashtu në favor të sigurimeve shoqërore ekziston mundësia e një padie kthimi, për shumën që i kanë paguar të dëmtuarit, kundër personit përgjegjës për dëmin.

Për sa i përket shoqërive të sigurimit, çështja trajtohet ndryshe në varësi të faktit nëse kemi të bëjmë me sigurim të pasurisë apo me sigurim të jetës dhe shëndetit. Kështu në rastin kur shkaktohet një dëm pasuror për të cilin i dëmtuari ka qenë i siguruar, siguresi ka të drejtën e kthimit kundër personit që ka shkaktuar dëmin për shumën që ka paguar në favor të të dëmtuarit (neni 1142 i Kodit Civil). Në rast se i dëmtuari nuk ka mundur të përfitojë nga siguresi të gjithë shumën e shpërblimit, mund ta kërkojë diferencën nga personi përgjegjës.

Dispozitat e Kodit Civil lidhur me kontratën e sigurimit dhe pozitën e siguresit ndaj të tretit përgjegjës për dëmin, zbatohen vetëm në rastet e sigurimit vullnetar. Kjo do të thotë se kur

sigurimi është i detyrueshëm, çështja do të zgjidhet në bazë të dispozitave ligjore që rregullojnë kontratën e sigurimit të detyrueshëm.

Aktualisht sigurimi i detyrueshëm është parashikuar vetëm për automjetet. Kështu me Dekretin Nr. 295, datë 15.09.1992 dhe me Ligjin Nr. 7641 datë 01.12.1992. “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë.”, është parashikuar si detyrim ligjor, sigurimi i automjeteve. Janë pikërisht këto raste që dominojnë praktikën. Sipas këtij ligji nëpërmjet kontratës së sigurimit, siguroesi merr përsipër shpërblimin e dëmeve të shkaktuara nga mjetet motorike. Ky i fundit ruan të gjitha të drejtat e të dëmtuarit kundrejt personit përgjegjës për shkaktimin e dëmit.

20. Padia për shpërblimin e dëmit.

Me rastin e shkakimit të një dëmi të paligjshëm, lind dhe përgjegjësia për shpërblimin e tij nga personi përgjegjës. Dëmi do të konsiderohet i paligjshëm, kur është rezultat një veprimi apo mosveprimi që ka shkelur apo cenuar të drejtat dhe interesat e një të treti. Këto të drejta mund të mbrohen posaçërisht nga legjislacioni dhe në qoftë se ato shkelen apo cenohen, titullari i tyre mund të kërkojë rivendosjen apo pushimin e cenimit nga të tretët. Kështu edhe para se të shkaktohet një dëm, personi i cenuar në të drejtën e tij, mund të kërkojë me padi të veçantë rivendosjen e të drejtës së tij.

Poseduesi i një të drejtë mund të rivendose të drejtën e tij dhe njëkohësisht të parandalojë ndonjë dëm të mundshëm. Në rast se nga cenimi i të drejtës subjektive të një personi, rezulton se është shkaktuar një dëm, ky i fundit mund të kërkojë shpërblimin e këtij dëmi krahas rivendosjes së të drejtës së tij.

Mjeti më i përshtatshëm për kërkimin e shpërblimit të dëmit është padia *acquiliane*.

Parashkrimi

E drejta për shpërblimin e dëmit lind që në momentin e shkakimit të dëmit. Por mund të ndodhë që i dëmtuari të mos vijë në dijeni menjëherë për dëmin që i është shkaktuar dhe për autorin e tij. Për këtë arsye ligji ka parashikuar se parashkrimi i padisë për shpërblimin e dëmit nuk do të fillojë në momentin e shkakimit të tij, por atëherë kur i dëmtuari ka ardhur në dijeni për të.⁷⁰

⁷⁰ “Për kërkimin e shpërblimit të dëmit jokontraktor, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar.” Neni 120 i Kodit Civil.

Që të fillojë ecja e parashkrimit të padisë, duhet që i dëmtuari të dijë jo vetëm se i është shkaktuar një dëm, por edhe se kush ka qenë autori i tij. Kjo gjë është e kuptueshme, sepse pa ditur identitetin e personit përgjegjës, i dëmtuari nuk mund të ngrejë dot padinë për shpërblimin e dëmit.

Kjo padi parashkruhet brenda tre vjetëve dhe kjo është parashikuar në nenin 115/dh të Kodit Civil. Me kalimin e këtij afati i dëmtuari nuk mund të kërkojë më në rrugë gjyqësore, shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Në një rast, të cituar ndërkohë, nga rrethanat e faktit, në shkakun ligjor dhe juridik të padisë, pretendohen elementët e përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit pasuror, duke parashtruar që dëmi i shkaktuar për shkak të ngjarjes është pasuror dhe jo pasuror. Është pasuror për shkak të pakësimit të pasurisë së paditësit dhe jo pasuror, për shkak të humbjes së jetës së dy të afërmve të familjes.

Por ka rezultuar që nga koha e shkakimit të dëmit të kenë kaluar 6 vjet. Në rrethana të tilla, padia e paditësit është ngritur tej afateve të lejuara për ngritjen e padisë, rrethanë kjo që nuk lejon vazhdimin e mëtejshëm të gjykimit.

Kjo rrethanë buron nga neni 112 i Kodit Civil, në të cilin parashikohet se “E drejta e padisë që nuk është ushtruar brenda afatit të caktuar në ligj, shuhet dhe nuk mund të realizohet më me anë të gjykatës ose të organit tjetër kompetent”.

E drejta e paditësit, për kerkimin e shpërblimit të dëmit, e rregulluar nga baza ligjore e padisë në gjykim, është parashkruar. Mundësia e ngritjes së saj ka qenë e parashikuar brenda afatit të percaktuar në nenin 115, shkronja “dh” të Kodit Civil.⁷¹

Parashkrimi i padisë, në rastin shembull, është rrjedhojë e të dy elementeve të kërkuar në lidhje me realizimin e të drejtës.

Së pari i kalimit të kohës së caktuar, i afatit perkatës për ushtrimin e të drejtës së padisë dhe, **së dyti**, i mosveprimit të papërligjur të paditësit për të ushtruar këtë të drejtë, brenda këtij afati.

⁷¹ “Parashkruhen brenda afateve prej:

dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jo kontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë.”

Ndërkohë që afati i parashkrimit ka perfunduar në datën x, jo vetëm nuk verifikohet, por as nuk është pretenduar nga paditësi ndonjë shkak ligjor apo objektiv që ta ketë penguar për ushtrimin e të drejtës së ngritjes së padisë.

Paditësit i ka lindur e drejta të ngrejë padi në datën y, datë në të cilën ka ndodhur ngjarja. Shkaku i perdorur në objektin e padisë dhe rrethanat e çështjes, barazojnë kohën e diskutuar për ngritjen e padisë.

Në nenin 120 të Kodit Civil percaktohet qartësisht se kur fillon afati i parashkrimit të padisë për kerkimin e dëmit jashtekontraktor, në të cilin përfshihet dhe dëmi jopasuror i kerkuar nga paditësi:

“Për kerkimin e shpërblimit të dëmit jokontraktor, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar”.

Për ngjarjen dhe pasojat, që lidhen me shkakun dhe dëmin e pësuar, si dhe me personat që e shkaktuan atë (shoqeria ndërtuese etj.), paditësi ka ardhur në dijeni në të njëjtën kohë, aty për aty, pikerisht në kohën e ngjarjes dhe nuk pretendohet dhe nuk mund të ketë, në rastin konkret, dyshime në lidhje me ecjen apo fillimin e afatit të parashkrimit.

Gjithashtu, në rrethanat e çështjes, gjithmonë ato të pretenduara në kërkesë padi, nuk rezultojnë pranishëm asnjë nga shkaqet që mund të sjellë nderprerjen apo pezullimin e parashkrimit. Fakti që çështja është gjykuar edhe penalisht nuk e ka penguar paditësin të drejtohej gjykatës civile apo penale për të kerkuar shpërblimin e dëmit, edhe sikur dëmi të ishte shkaktuar nga vepra penale.

Përkundrazi edhe në rastin e gjykimit penal, paditësit i kanë kaluar afatet për ngritjen e padisë civile në procein penal, padi, e cila, duke respektuar afatet e parashkrimit, mund të ngrihej perderisa çështja penale nuk kishte shkuar në gjykatë.

Në doktrinen dhe jurisprudencën tone janë trajtuar gjerësisht efektet e parashkrimit.

Anderea Nathanaili, në shkrimin “Disa probleme të parashkrimit”⁷² trajton shuarjen e të drejtës në rastin e kalimit të afatit të parashkrimit, ndersa Feti Gjilani në titullin “Rivendosja e afateve të parashkrimit”⁷³, trajton në menyre të detajuar rastet se kur mund të rivendoset në afat parashkrimi.

Viktor Floqi apo Perikli Zaharia, në shkrimet e tyre për parashkrimin, në vitet 1973 dhe 1985, trajtojnë në menyre të njejte efektet e parashkrimit shues.

Është e dallueshme qartesisht që doktrina e permendur i ka paraprirë praktikës gjyqesore, të shprehur në vecanti jo vetëm në Udhezimet e Pleniumit të Gjykatës së Lartë,⁷⁴ por edhe në vendimet unifikuese, apo të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë⁷⁵, praktike e realizuar rast pas rasti në bazë të legjislacionit, thuajse të pandryshuar në këtë lëndë.

⁷² Anderea Nathanaili : Drejtesia popullore Nr.2, viti 1961.

⁷³ Feti Gjilani: Drejtesia popullore Nr.6, viti 1963.

⁷⁴ Udhezimet e Pleniumit të Gjykatës së Lartë Nr.4/1953, 8/1964, 7/1974

⁷⁵ Vendim Nr.1046, datë 06.11.2002, (faqe 25, volumi 11– 2002 “Vendime të Gjykatës së Lartë),

Vendim Nr.16, datë 09.01.2004, (faqe 62, volumi 1 – 2004 “Vendime të Gjykatës së Lartë),

Vendim Nr.417, datë 05.04.2007

Konkluzione dhe rekomandime.

Ndërmarrja ime për të trajtuar “Dëmin jo pasuror” në termat e një punimi shkencor më përfshiu në kërkime që i përkasin një fushë shumë delikate, të pashkelur tërësisht dhe, për këtë shkak po aq interesante, të së drejtës civile. Tërheqja ndaj këtij objekti ishte rrjedhojë e mishërimit në të, thuajse të të gjithë parimeve të së drejtës civile. Pretendimet e mia në formimin teorik, gjejnë në këtë fushë, lëndë për të eksploruar, për të kundërshtuar, për të krijuar, së fundi, për të shfaqur opinione vlerësuese.

Ndryshimi i sistemit politik solli frymë dhe botëkuptim të ri në legjislacionin e vendeve të Evropës lindore, për rrjedhojë edhe në Shqipëri. Instituti i shkaktimit të dëmit, me përkufizime të politizuara dhe të përcipta filloi të ndryshojë, duke u përshtatur me të drejtën dhe trashëgiminë doktrinare të vendeve evropiane kontinentale ose, në një vlerësim më kombëtar, u rikthye në përkufizimet e të drejtës civile të rregulluara në Kodin Civil të vitit 1929.

Me shpërblimin e dëmit ndaj të dëmtuarit, gjen zgjidhje shkaktimi i një dëmi të paligjshëm. Por që të arrihet deri këtu duhet që paraprakisht të plotësohen kushtet për lindjen e detyrimit dhe të konsumohen procedurat civile.

Çështja e parë që shtrohej për zgjidhje në rastin e shkaktimit të një dëmi, ishte nëse jemi para një përgjegjësie civile kontraktore apo jo kontraktore (në rastin tonë u fol vetëm për dëmin që shkaktohej nga veprimet e paligjshme). Për fat të keq praktika gjyqësore evidenton një numër jo të vogël rastesh, kur këto dy përgjegjësi nuk dallohen nga njëra tjetra. Dëmi i shkaktuar do të jetë kontraktor, kur i dëmtuari dhe autori i dëmit janë të lidhur në një marrëdhënie kontraktore. Dëmi i shkaktuar do të rezultojë nga mospërbushja e detyrimeve që rrjedhin për palët nga klauzolat e kontratës. Si i tillë dëmi në këto raste do të shpërblehet sipas përgjegjësisë kontraktore dhe jo sipas dispozitave që rregullojnë shkaktimin e një dëmi të paligjshëm, siç vërehet jo rrallë në praktikë.

Për sa i përket dëmit jo kontraktor, do të konsiderohet i tillë rasti kur midis të dëmtuarit dhe autorit të dëmit nuk ekziston asnjë lidhje e mëparshme kontraktore. Janë këto raste që do të

sjellin përgjegjësinë civile jashtëkontraktore dhe do të rregullohen nga dispozitat e shkakimit të dëmit.

Pyetja më e pritshme në prezantime të tilla është përse pikërisht dëmi jo pasuror? Arsyet janë të shumta. Tërheqja ndaj të vështirës dhe të bukurës njëkohësisht, përkushtimi i vjetër në veprimtarinë studimore shkencore, por më intrigues, boshllëku dhe kontradikta njëkohësisht, që ekziston midis legjislacionit dhe praktikave gjyqësore nga njëra anë dhe mentalitetit në zhvillim nga ana tjetër.

Është koha kur çështje me objekt shpërblim dëmi jo pasuror gjykohen, jo vetëm në gjykatën e Tiranës, por edhe në Gjykatën e Kurbinit, të Vlorës apo të Sarandës. Mosmarrëveshje të cilat dikur zgjidheshin me të drejtë zakonore, tani kanë si shkak ligjor nenin 325 të Kodit Civil, apo bazë tjetër ligjore në ligjet materiale, që rregullojnë dëmin jo pasuror.

Një punimi shkencor mbi dëmin jo pasuror do ti mungonin vlerat akademike në rast se, nëpërmjet tij, nuk do të synohej të ndikohej në jetën shoqërore, në marrëdhëniet juridiko civile dhe, në objektin konkret të punimit shkencor. Detyrat që do të dalin në përfundim të këtij punimi do të synojnë jo vetëm ngritjen e nivelit profesional në kuptimin e marrëdhënieve juridiko civile, që janë bazë e dëmit jo pasuror por, edhe në njohjen e shkaqeve dhe problematikave të shumta, që shkaktojnë dëmin jo pasuror.

Përtej procesit të njohjes është infrastruktura ligjore e cila, ndonëse në zhvillim, vlerësohet shumë mbrapa në kohë, në raport me zhvillimin e marrëdhënieve juridike. Përpjekje të copëzuara të Gjykatës së Lartë, për unifikim të qëndrimeve të gjyqësorit, vetëm se kanë shkaktuar konfuzion, pa mundur të arrijnë në nivele përgjithësues.

Objektivat e ligjvënësit për përsosjen e legjislacionit, që rregullon dëmin jo pasuror, mund dhe duhet të përdorin si bazë të ushtrimit të veprimtarisë ligjëbërëse, jo vetëm vendimet unifikuese apo praktikat më të mira të gjykatave, por edhe arritjet e legjislacionit bashkëkohor.

Është përmendur vazhdimisht në këtë debat, që në legjislacionin për dëmin jo pasuror ka hapësira boshe, për shkak të mungesës së legjislacionit, kohezionit të ligjeve apo praktikave të gabuara dhe të vjetruara. Kjo gjendje e infrastrukturës ligjore shkakton pasiguri juridike në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile që lindin mbi bazë të shkakimit të dëmit jo pasuror. Mënyra e vetme, për të minimizuar efektet e pasigurisë juridike është përafrimi i legjislacionit

me zhvillimet bashkëkohore evropiane, gjithmonë, duke ruajtur raportin me nivelin e zhvillimit të marrëdhënieve shoqërore dhe juridike në vend.

Për të qenë më i komunikueshëm, nuk mund të kërkohet implementimi “an block” i “Tabelave të Milanos” në infrastrukturën ligjore vendase. Ajo që mund dhe kërkohet të bëhet është sigurimi në infrastrukturën ligjore i një mekanizmi të ngjashëm me tabelat e Milanos, i përshtatshëm për vlerësimin e dëmit jo pasuror në vend.

Në praktikën tonë ligjberëse jo rrallë është vulgarizuar krijimtaria ligjore, deri në përkthimin konsekuent të akteve ligjore apo nënligjore të huaja. Skena e parë ku dallohet kontradikta midis këtij legjislacioni dhe marrëdhënies juridike reale është gjykata, e cila vërtitet në përgjegjësinë për të dhënë një vendim të drejtë, e bazuar në një legjislacion, i cili nuk përputhet me trashëgiminë, mentalitetin, karakteristikat e marrëdhënies juridike vendase.

Gjëja e parë që mendojmë kur përmendim togfjalëshin “dëmi jo pasuror” është dëmi moral. Pikërisht ky mentalitet i gabuar duhet dhe mund të korrigojohet. Dëmi jo pasuror nuk lidhet vetëm me dëmin moral apo thjesht me dëmin jo kontraktor, përkufizimi më i përgjithshëm. Dëmi jo pasuror është një institucion i cili përfshin në vetvete edhe dëmet e shkaktuara për shkak të kundërligjshmërive në sjelljet njerëzore.

Duke u kufizuar vetëm në dëm jashtëkontraktor, dëm moral, biologjik, ekzistencial etj, etj. dashur pa dashur zbehet karakteristika kryesore e shkakimit të këtij dëmi, që është “kundërligjshmëria e sjelljes”.

Nënvlerësimi i kësaj karakteristike shkakton pasiguri në përcaktimin e llojit të dëmi jo pasuror, por edhe në identifikimin e elementëve të tjerë, të cilët përbëjnë përgjegjësinë civile nga shkaktimi i dëmit jo pasuror. Elementë të tillë si subjektet, ana objektive, ana subjektive, lidhja shkakësore janë të domosdoshëm për verifikimin e dëmit jo pasuror. Ato ndikojnë në mënyrë thelbësore në bindjen e gjykatës, në arritjen e fajësisë dhe përcaktimin e dëmit.

Njohja e hollësishme e marrëdhënies juridike që prodhon dëmin jo pasuror lehtëson zgjidhjen e mosmarrëveshjes civile.

Në legjislacionin dhe praktikën tona është trajtuar me indiferentizëm të plotë marrëdhënia shoqërore, për pengimin e mosmarrëveshjeve civile që shkaktojnë dëmin jo pasuror.

Kjo do të thotë që në të ardhmen mund dhe duhet të institucionalizohen marrëdhëniet e pajtimit midis subjekteve në një mosmarrëveshje civile më objekt dëmi jo pasuror. Mënyrat janë të shumta, por fatkeqësisht përpjekjet për gjetjen dhe zbatimin e tyre kanë munguar. Ligjvënësi mund të përdorë kërcënimin e mjeteve shtrënguese, kur dështon zgjidhja e mosmarrëveshjes me pajtim, praktikë kjo e njohur në shumë vende evropiane.

Detyra të shumta për ligjbërësit dhe zbatuesit e ligjit krijohen në lidhje me procedurat e gjykimit, materializmin e parimeve në një proces ligjor edhe në elementë të tillë si barra e provës, përmbushja e detyrimit etj. ndaj të cilëve është konstatuar pasiguri nga praktika gjyqësore.

Është e domosdoshme një përqasje, edhe në rrugë institucionale e praktikave dhe legjislacionit vendas, me mentalitetin dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së.

Kjo nuk është e mjaftueshme dhe nuk konsiderohet e realizuar vetëm me një ndryshim të detyruar në Kodin e Procedurës Civile. Jurisprudenca e GJEDNJ-së nuk duhet të përbëjë shkak vetëm për rishikimin e vendimit gjyqësor civil. Ajo duhet të zërë vend në mentalitetin tonë gjyqësor dhe në infrastrukturën ligjore si burim ligji. Gjyqtarët nuk kanë asnjë pengesë institucionale për të zgjidhur çështjen në themel, duke ju referuar zgjidhjeve të dhëna nga GJEDNJ. Është e domosdoshme që të inkurajohen edhe nga infrastruktura ligjore drejt zgjedhjeve të tilla.

Kuptimi i përgjithshëm i dëmit jo pasuror.

Karakteristikat e dëmit jo pasuror, rrjedhojë e kundërligjshmërisë së sjelljes në shoqëri, ndaj të tretëve, u trajtuan jo vetën nën vështirimin e përgjithshëm mbi formën dhe përmbajtjen e dëmit jo pasuror, por me vëmendjen e duhur mbi kushtet e përgjithshme në lidhje me praninë e elementëve përbërës të përgjegjësisë së rrjedhur nga shkaktimi i dëmit jo pasuror.

Në shumë legjislacione titulli që rregullon shkaktimin e dëmit dhe përgjegjësinë përkufizohet si “Fakt i kundërligjshëm” (Kodi Civil Italian, Titulli 9) apo “Veprime të paligjshme” (Kodi Civil i Zogut – seksioni 6) etj.

Rregullimet që i bëhen përgjegjësisë në parime janë thuajse të njëjta. Ndryshimet dallohen në rregullimin e anës materiale të posaçme. Ndërsa në Kodin Civil Italian mjaftohet vetëm me përkufizimin që “..dëmi jo pasuror duhet të shpërblehet...” (Neni 2059), në Kodin Civil francez pranohet përgjegjësia e përzier (Neni 1032 i Kodit Civil), në Kodin tonë Civil tentohet, natyrisht në mënyrë të gabuar që, dëmi jo pasuror të trajtohet kryesisht si dëm kundër shëndetit

Vështrim historik i zhvillimit të konceptit të dëmit jo pasuror.

Karakteri historik i zhvillimit të dëmit jo pasuror merr vlera të veçanta, për të njohur trashëgiminë ligjore dhe teorike, nivelet bashkëkohore dhe perspektivat e institutit të njohjes. Të dhëna të reja doktrinare krahasuese mbi kuptimin e përgjithshëm do të jenë objekt i vëmendjes në këtë studim.

Termi i sotëm “dëm i shkaktuar shëndetit” apo “dëm jo pasuror” (që është koncept më i gjerë), u përshtat për herë të parë si institut ligjor në të drejtën zakonore, duke zënë hapësira në “Sheriat” apo “Kanunin e Lek Dukagjinit”. Pavarësisht nga emërtime dialektore të ndryshme, bëhej fjalë për dëmin që i shkaktohej shëndetit dhe moralit.

Në përgatitjen dhe themelimin e Kodit të Ri Civil, duke tejkuluar përkthimet e dobëta, u konsumuan nocione të tepërta dhe u lejuan mangësi, që herë pas herë e bëjnë të paqartë dhe të pazbatueshëm rregullimin e dëmit jo pasuror, kuptimin dhe zbatimin e këtij instituti.

E reja që solli Kodi Civil në krahasim me atë paraardhës, ishte pranimi i shpërblimit në para i dëmit civil. Në këtë mënyrë u hodh poshtë mendimi që kishte ekzistuar për shumë kohë, sipas të cilit mund të shpërblehej vetëm dëmi pasuror. Ligji ynë ka pranuar sistemin, sipas të cilit do të shpërblehen vetëm dëmet morale të parashikuara në të. Aktualisht mund të shpërblehen në të holla vetëm dëmet morale të parashikuara nga Kodi Civil, neni 625. Në të ardhmen, legjislacioni duhet ta zgjerojë sferën e përfshirjes edhe për dëme të tjera morale. Kjo sepse përveç mbrojtjes së nderit dhe shëndetit të personit, ka edhe shumë të drejta të tjera, ndoshta po aq të rëndësishme që meritojnë një mbrojtje të tillë për shembull, e drejta e personit kundër cenimit të jetës private.

Kodi Civil ka parashikuar për herë të parë se kur një dëm do të quhet i paligjshëm (neni 608). Po ashtu lidhur me lidhjen shkakësore në nenin 609, është parashikuar së dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit a mosveprimit të paligjshëm. Megjithatë mendoj se si teoria, ashtu edhe praktika duhet ta zhvillojnë këtë koncept për të përcaktuar qartë se kur një dëm do të konsiderohet i tillë. Kjo sepse akoma ekzistojnë mendime të ndryshme lidhur me konceptin e lidhjes shkakësore, mendime të cilat u paraqitën kur u trajtua kjo çështje.

Forma e shfaqjes së dëmit jo pasuror. Karakteristika të anës materiale

Në analizën e posaçme të elementëve përbërës të dëmit jo pasuror, forma e dëmit jo pasuror është shfaqja e parë, rrjedhojë e konsumimit të elementëve të përgjegjësive civile.

Neni 625 i Kodit Civil rregullon përgjegjësinë për dëmin jo pasuror në këtë mënyrë:

“Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur:

- a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cenuar në nderin e personalitetit të tij;*
- b) është fyer kujtimi i një të vdekuri....”*

Opinionimi dhe vlerësimi im është që dëmi jo pasuror, i përcaktuar në dispozitën e përmendur nuk është i plotë, për më tepër është i pasaktë, sidomos kur, dëmtimin e shëndetit e trajton vetëm si dëm jo pasuror ose kur cenimin e nderit dhe personalitetit e kufizon vetëm në dëm jo pasuror

Sipas doktrinës civile, përgjegjësia për dëmin kundër shëndetit shpreh detyrimin e sistemit juridik në mbrojtje të personit, që sigurohet jo vetëm në profilin e paprekshmërisë fizike, por edhe të paprekshmërisë morale. Mbrojtja e posaçme që realizohet me rregullimin e përgjegjësisë së dëmit kundër shëndetit, synon jo vetëm mbrojtjen fizike të njeriut, por edhe të të drejtave të tij në lidhje me etiken, personalitetin etj. Në këtë këndvështrim, dëmi kundër shëndetit është quajtur nga doktrina bashkëkohore edhe “Dëmi biologjik” (që nënkupton dhe përfshin mbrojtjen e tërësisë fizike e psikike të personit).

Një pjesë e jurisprudencës bashkëkohore e ndan, në koncept dhe vlerësim, dëmin biologjik nga dëmi moral, duke e karakterizuar dëmin biologjik si “..shqetësim psikologjik të lidhur me vuajtjen fizike dhe dhimbjen morale..” ndërsa në dëmin moral, atë që përbën dëmin biologjik, e identifikon me shkakun e dëmit moral, shkak “..i cili përcakton efektivisht ndryshimet në psikikën e njeriut të cilat ndikojnë negativisht në normalitetin e jetës së personit..”

Kuptimi i karakterit material të dëmit jo pasuror merr rëndësi të veçantë. Mënyra e llogaritjes së tij është një nga elementët më të diskutueshëm në doktrinën dhe praktikën gjyqësore.

Zhvillimi i teorisë dhe praktikës që ka pasur për objekt konceptin e dëmit kundër shëndetit, që gjen rregullim në nenin 625/1 të Kodit Civil, rrjedhë e drejtpërdrejtë e rregullimit kushtetues, ende nuk është unifikuar plotësisht në ligj.

Sidoqoftë është në diskutim një kontradiktë pikëpamjesh dhe mundësish, të cilën në duhet ta shpërfillim dhe të pranojmë ekzistencën e të dy mënyrave të shpërblimit të dëmit të shëndetit,

kjo, duke i qëndruar opinionit që dëmtimi i shëndetit, pranohet më së fundi, që shfaqet në forma të ndryshme të dëmit, pasuror dhe jo pasuror.

Shpërblimi në natyrë ose rivendosja e të dëmtuarit në gjendjen e mëparshme (*status quo ante*) apo *shpërblimi ekuivalent* që konsiston në pagimin e një shumë të hollash në favor të të dëmtuarit, e përberë nga humbja dhe fitimi i munguar, janë mundësitë kryesore që lejohen në shpërblimin e dëmit, të zbatueshme nga natyra e dëmit dhe mundësitë për riparimin e zhdëmtimin e tij.

Faji, në format e tij të shfaqjes, si element kryesor i përgjegjësisë civile, ishte në vëmendje të posaçme gjatë këtij studimi.

Faji, si kusht i përgjegjësisë civile, përbën bazën e saj. Kodi Civil ka pranuar jo vetëm kaq, por ka vendosur parimin e prezumimit të fajësisë së autorit të dëmit.

Kështu ai që ka shkaktuar një dëm do të prezumohet se e ka shkaktuar me faj, përderisa nuk provon së dëmi ka ardhur nga rrethana të pavarura nga ai dhe që nuk mund t'i ndalonte. Krahas parimit të fajësisë, është pranuar si përjashtim edhe përgjegjësia pa faj. Përveç përgjegjësisë që rrjedh nga një veprimtari e rrezikshme, në Kodin aktual janë shtuar rastet e përgjegjësisë pa faj. Mund të përmend këtu përgjegjësinë e prodhuesit për dëmin e shkaktuar nga të metat e sendit. Por edhe raste të tjera të cilat nuk shprehen direkt për një përgjegjësi pa faj, mund të interpretohen nga praktika si të tilla, si përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga ndërtimet apo nga kafshët.

Format më të përhapura të dëmit jo pasuror

- *Dëmi moral në formën e cenimit të nderit,*

- *Dëmtimi i shëndetit* ose shkaktimi i një dëmi i cili cenon integritetin fizik të një personi, përkufizohet ndryshe me termin *Pretium doloris* (çmimi i dhimbjes),

- *Dëmi ndaj kënaqësive të ofruara nga jeta* ose privimin nga gëzimi i kënaqësive të ekzistencës,

- *Dëmi estetik* - Në këto raste dëmi duhet shpërblyer në kuadrin e një dëmi pasuror ose si dëm moral, ose të dyja së bashku.

- *Dëmi në sferën afektive* (*pretium affectionis*) ose vuajtja e provokuar nga vdekja e një të afërmi. Në këtë rast nuk është viktimja që kërkon shpërblimin e dëmit moral, por të tretet, të afërmit.

- *Fyerja e kujtimit të një të vdekuri* - E drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit i takon bashkëshortit me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes ose të afërmeve të të vdekurit deri në shkallë të dytë.

- *Cenimi i jetës private dhe i korrespondencës*, cenimi i të drejtave morale të autorit, cenimi i të drejtave jo pasurore familjare e të tjera.

Shpërblimi dëmit në rastin e shkakimit të vdekjes - Dëmtimi më i rëndësishëm kundër personit.

Në studim janë trajtuar raste të veçanta të shkakimit të dëmit, gjithmonë në lidhje me dëmin jo pasuror..

Shpërblimi dëmit. Ligji pranon lidhur me shpërblimin e dëmit pasuror, parimin e shpërblimit të plotë të dëmit. Personi përgjegjës do të shpërblejë si humbjen e pësuar, ashtu edhe fitimin e munguar. Për sa i përket çështjes Nëse dëmi do të shpërblehet në natyrë apo në të holla, praktika ka preferuar pothuajse gjithmonë shpërblimin në para të dëmeve të shkaktuara, pavarësisht nëse ka qenë apo jo e mundur të bëhej shpërblimi në natyrë. Ky i fundit do të ishte plotësisht i mundshëm, në rastet kur dëmi ka të bëjë me sende të përcaktuara në gjini, të cilat mund të zëvendësohen me sende të ngjashme. Përveç dëmit pasuror u trajtua edhe shpërblimi në rastin e dëmtimit të shëndetit, apo shkakimit të vdekjes së një personi. Në këto raste kemi të bëjmë me një dëm të veçantë, i cili sjell si pasojë edhe dëme pasurore, edhe dëme jopasurore. Për sa i përket dëmit pasuror ai do të përbëhet nga humbja ose pakësimi i aftësisë për punë dhe shpenzimet mjekësore në rastin e dëmtimit të shëndetit.

Në procedurën për shpërblimin e dëmit u trajtua si çështje e veçantë edhe pozita e sigurimeve shoqërore dhe shoqërive të sigurimit. Sigurimet shoqërore gjithmonë kanë të drejtën të kërkojnë nga personi që ka shkaktuar dëmin t'u kthejë atë çfarë kanë paguar në favor të të dëmtuarit, kur ky përfiton nga sigurimet shoqërore.

Ndërsa shoqëritë e sigurimit dhe pozita e tyre në shpërblimin e dëmit rregullohet si nga dispozitat e Kodit Civil, ashtu edhe me ligje të veçanta për sigurimet e detyrueshme. Kodi Civil parashikon të drejtën e sigurvearit për të kërkuar kthimin e shumës së paguar nga personi përgjegjës, për rastet e sigurimit të dëmeve. Në rastet e sigurimit të jetës dhe shëndetit, nuk parashikohet një e drejtë e tillë.

Parashkrimi i padisë së shpërblimit të dëmit jo pasuror, u trajtua në frymën bashkëkohore të rregullimit ligjor dhe nga praktika gjyqësore.

Bibliografi

Dëmi jo pasuror është i njohur qartësisht dhe nga doktrina bashkëkohore. Përfaqje më e afërt e trajtimeve shkencore me objektin e këtij punimi, është gjetur në studimet dhe punimet shkencore:

1. Gaqo Floqi, Mbi Përgjegjësinë e shpërblimit të dëmit nga një veprim I paligjshëm në të drejtën civile, Drejtësia Popullore, viti 1951, nr. 5.
2. Prof. Dr. Mehdi J. Hetemi, Detyrimet dhe kontratat, Tiranë 1998.
3. Manuel DROIT CIVIL, personnes – famille – incapacite – biens – obligation – suretes, Pierre Voirin; Tomë i 26 EDITION par Gilles Goubeaux.
4. W. Brondolo, A. Marigliano: “E drejta dhe dëmi psikik”, 1996,
5. Rustem Gjata, Revista Drejtësia, viti 1972, nr. 1.
6. Francesco Galgano, E drejta private
7. Thimio Kondi, Disa probleme të detyrimeve që lindin nga shkaktimi i dëmeve jashtëkontraktore, Drejtësia Popullore, viti 1989, nr. 3.
8. Dr. Marjana Semini, E drejta e detyrimeve dhe e kontratave, pjesa e përgjithshme, Tiranë 1998.
9. Andon Sallabanda, E Drejta E Detyrimeve, pjesa e përgjithshme, Tiranë 1962.
10. Droit Civil, La responsabilite civil et obligations, faqe 340 (biblioteka e Sh.M.)
11. P. Szollosy "Vlerësimi i dëmit rrjedhojë e moskuptimeve në vende të ndryshme evropiane", Zurich, 2007.
12. Giovanni Battista Petti: “ Shpërblimi i dëmit biologjik, e drejta aktuale”, UTET.
13. G. Giannini e M. Pogliani, Giuffrè: “ Dëmi dhe paligjshmëria civile”, 1997.
14. Ugo dal Lago, Edvige Bressan dhe Alessandra Casarotto: “ Shpërblimi i dëmit në rastet e shpifjeve” 2008
15. Anderea Nathanaili “Disa probleme të parashkrimit”

Objektivi i kësaj përpjekje studimore është ndikimi në doktrinën e institutit të përgjegjësive nga shkaktimi i dëmit jo pasuror, duke u konsideruar si ndihmesë e përkushtuar, për konkretizimin e karakteristikave të dëmit jo pasuror, por edhe në identifikimin e elementëve të tjerë, të cilët përbëjnë përgjegjësinë civile nga shkaktimi i dëmit jo pasuror. Elementë të tillë si subjektet, ana objektive, ana subjektive, lidhja shkakësore, të domosdoshëm për verifikimin e dëmit jo pasuror, ndikojnë në mënyrë thelbësore në arritjen e përcaktimit të dëmit.

Karakteristikat e dëmit jo pasuror, rrjedhë e kundërligjshmërisë së sjelljes në shoqëri, ndaj të tretëve, janë trajtuar jo vetëm nën vështrimin e përgjithshëm mbi formën dhe përmbajtjen e dëmit jo pasuror, por me vëmendjen e duhur mbi kushtet e përgjithshme në lidhje me praninë e elementëve përbërës të përgjegjësive së rrjedhur nga shkaktimi i dëmit jo pasuror.

Në legjislacionin e deritanishëm hapësirat për të ndërhyrë janë të shumta, në veçanti në lidhje me procedurat e gjyqimit, materializmin e parimeve në një proces ligjor edhe në elementë të tillë si barra e provës, përmbushja e detyrimit etj.

Në punim vlerësohet si domosdoshmëri një përqasje, edhe në rrugë institucionale, e praktikave dhe legjislacionit vendas, me mentalitetin dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. Jurisprudenca e GJEDNJ-së nuk duhet të përbëjë shkak vetëm për rishikimin e vendimit gjyqësor civil. Ajo duhet të zërë vend në mentalitetin tonë gjyqësor dhe në infrastrukturën ligjore, si burim ligji.

The objective of this research effort is the impact on the doctrine of the institution of the non-pecuniary damage, being considered as dedicated contribution to the concretization of the characteristics of non-pecuniary damage, but also to identify other elements, which constitute the civil responsibilities of non-pecuniary damage. Elements such as entities, the objective, subjective, causal connection, necessary for the verification of non-pecuniary damage, affect essential in reaching the determination of injury.

Characteristics of non-pecuniary damage, due to the lawlessness of social behavior, to third parties, are treated not only under general views about the form and content of non-pecuniary damage, but with proper attention on the general conditions relating to the presence of elements liability component derived from the infliction of non-pecuniary damage.

The premises to intervene in the current legislation are numerous, especially in connection with court proceedings, materialization of the principles in a legal process, in elements such as the burden of proof, fulfillment of the obligation etc..

In this study-work considered a necessity approach, institutional ways, practices and legislation, with the mentality and the jurisprudence of the ECHR. Jurisprudence of the ECHR should not be due solely to civilian judicial review of the decision. It should take place in our judicial mentality and legal infrastructure, as a source of law.